



BASHKIA SHKODER



PLANI STRATEGJIK

për ZHVILLIMIN EKONOMIK

2005 - 2015




# BASHKIA E SHKODRËS

Plani Strategjik për Zhvillimin Ekonomik

2005 – 2015

---





Ky plan strategjik është hartuar nga grupe të gjera të interesuara, nga Bashkia e Shkodrës nën drejtimin dhe këshillimin e Grupit të Bankës Botërore, Institutit të Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG. Grupi i Bankës Botërore, Instituti i Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG nuk mbajnë përgjegjësi për saktësinë ose përmbajtjen e strategjisë; megjithatë ato përgëzojnë Bashkinë për cilësinë e punës së bërë.



*Kopertina Kilica Graphics  
Redaktorë: Artan Rroji dhe Dr. Iain Wilson  
Përktheu Marsela Dhimitri  
Shtypur në Maluka shpk*

E drejta e autorit © 2006 Bashkia e Shkodrës

<b>Përmbajtja e Lëndës .....</b>	<b>faqe</b>
<b>Shkurtime .....</b>	<b>5</b>
<b>I. Parathënie.....</b>	<b>6</b>
<b>II. Hyrje .....</b>	<b>7</b>
<b>III. Rëndësia e PSZhEV për komunitetin tonë .....</b>	<b>8</b>
<b>IV. Planit Strategjik .....</b>	<b>9</b>
Filozofia që qëndron pas Planit Strategjik .....	10
<b>V. Zhvillimi i Planit Strategjik .....</b>	<b>11</b>
Parimet orientuese.....	11
Metodologjia .....	11
Procesi i planifikimit .....	12
Qasja organizative për hartimin e Planit Strategjik.....	13
Forumi DELTA i Kryetarëve të Bashkisë.....	13
Pjesëmarrja dhe konsultimi.....	15
Përmbledhje mbi vlerësimin e ekonomisë vendore .....	18
Perceptimet e bizneseve .....	20
Vizioni dhe Qëllimet .....	21
Përfitimet e pritshme .....	22
Zbatimi .....	24
Qasja organizative për zbatimin e Planit.....	24
Financimi i Planit Strategjik .....	25
<b>VI. Vështrim i përgjithshëm mbi komunitetin e Shkodrës .....</b>	<b>26</b>
Gjeografia dhe topografia.....	26
Demografia.....	26
Qeveria bashkiake .....	29
<b>VII. Profil ekonomik i Shkodrës .....</b>	<b>33</b>
Burimet natyrore të rrethit Shkodër .....	33



Turizmi .....	35
Fuqia punëtore.....	36
Bizneset private në Shkodër .....	38
Shërbimet dhe infrastruktura.....	45
<b>VIII. Dokumentacioni përbërës i Planit Strategjik .....</b>	<b>49</b>
a. SWOT, analiza e konsoliduar .....	50
b. Matrica e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit.....	52
c. Matrica e zbatimit të Planit Strategjik .....	59
d. Matrica e prioriteteve të projekteve.....	72
e. Fishat e projekteve.....	79
<b>Aneksi 1: Shkurtime të përdorura në Matricën e Zbatimit.....</b>	<b>167</b>
<b>Aneksi 2: Raporti mbi “Anketimin e mjedisit vendor në të cilin kryhet biznesi” .....</b>	<b>169</b>
<b>Aneksi 3: Metodologjia e përdorur në prioritarizimin e projekteve.....</b>	<b>173</b>
<b>Aneksi 4: Grup projektësh.....</b>	<b>176</b>

## Shkurtime

DELTA	Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave
KZhEB	Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë
DZhEB	Departamenti i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë
FLAG	Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
LGI	Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (pjesë e Institutit Shoqëria e Hapur e Fondacionit Soros)
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PSZhEV	Plani Strategjik i Zhvillimit Ekonomik Vendor
SWOT	Analiza e Pikave të Forta, Pikave të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve
BB	Banka Botërore



## I. Parathënie

Në kuadër të programit Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave (DELTA) është hartuar një strategji për Zhvillimin Ekonomik Vendor (ZhEV) të bashkive të ndryshme në Shqipëri. Programi u zbatua në Shqipëri gjatë periudhës 2004–2005 dhe u mbështet financiarisht e tekniki-sht nga Banka Botërore (BB; Departamenti i Zhvillimit Ekonomik Vendor) dhe Instituti për Shoqëri të Hapur (SOROS), nëpërmjet Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (LGI), Hungari. Në bashkëpunim me organizatën shqiptare Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG) u përgatit një strategji për, dhe në bashkëpunim me secilën nga bashkitë e Beratit, Durrësit, Korçës, Lezhës dhe Shkodrës. Qëllimi i këtij programi ishte dhe vazhdon të jetë të zhvillojë plane strategjike të veprimit që do ndikojnë në reformimin e politikave të zhvillimit ekonomik vendor në nivel bashkiak, veçanërisht të sektorit privat.

Metodologjia e zbatuar nga DELTA promovon përmirësimin e mjedisit që mbështet dhe lehtëson zhvillimin e biznesit, si dhe forcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendore me grupet e komunitetit në përgjithësi dhe atij të bizneseve vendore në veçanti, në krijimin e vizionit të përbashkët dhe hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik Vendor (PSZhEV).

Plani Strategjik, hartuar nga secila bashki, do t'i shërbejë institucionalizimit të bashkëpunimeve private-publike dhe zhvillimit të programeve e projekteve vendore, që do të çojnë në përgatitjen e axhendës për një zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë. Nëpërmjet forcimit të institucioneve, infrastrukturës dhe politikave që mbështetin ndërmarrjet private, projektet e përvijuara në PSZhEV do të ndihmojnë në zhvillimin dhe fuqizimin e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (NVM), rritjen e mundësive vendase për punësim në të njëjtën kohë edhe rritjen e të ardhurave për buxhetin bashkiak.

Korniza e DELTA-s i dha mundësinë kapaciteteve lokale të zhvillohen nëpërmjet rishikimit periodik të procesit të planifikimit ZhEV në mënyrë që të ketë një institucionalizim të qëndrueshëm të këtij procesi pranë qeverive bashkiake.



## II. Hyrje

Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri, transformimi i ekonomisë vendase nga shumë e centralizuar në një variant të tregut të lirë, si dhe hapja e tregjeve dhe burimeve shqiptare ndaj atyre botërore e veçanërisht atyre evropiane, komunitetet, e veçanërisht ai i biznesit, dhe qeveritë vendore u gjetën para sfidës së ndërtimit të një ekonomie të re vendore dhe një strukture biznesi të aftë për t'ju përshtatur tregut dhe konkurrencës botërore.

Gjatë periudhës së tranzicionit të Shqipërisë, struktura e biznesit ndryshoi dhe vazhdon të ndryshojë si në nivel kombëtar dhe atë vendor. Para periudhës së tranzicionit, ndërmarrjet e mëdha publike dominuan tregun, ndërsa tani ai dominohet nga NVM. Fillimi i procesit të decentralizimit, duke lejuar qeveritë vendore të kenë një influencë më të madhe në klimën e biznesit, në mënyrë të natyrshme afruan interesat e këtyre bizneseve me politikat e qeverisë bashkiake. Çdo ditë e më shumë përgjegjësitë kryesore për ofrimin e shërbimeve dhe krijimin e rregullave lidhur me mjedisin e biznesit po transferohen nga qeveria qendrore në atë lokale.

Ky transformim i ekonomisë ka sjellë në tavolinën e punës së Bashkisë një rol të ri: të udhëheqë procesin e stimulimit të rigjenerimit dhe rritjes ekonomike, duke siguruar përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetës së komunitetit nëpërmjet përmirësimit të mjedisit të biznesit vendas nga pikëpamja ekonomike dhe konkurruese.

Duke marrë parasysh këtë situatë, komunitetit po i bëhet gjithnjë e më e qartë nevoja për të bërë përpjekje më të madhe për të përcaktuar drejtimet më të rëndësishme të zhvillimit dhe të marketingut të suksesshëm të burimeve tona në mënyrë që të krijohen avantazhe konkurruese që do mbështesin bizneset ekzistuese dhe do të tërheqin biznese të reja. Kjo është e vetmja mënyrë që komuniteti ynë të mund të përdorë në mënyrë inteligjente burimet e tij me qëllim që ta bëjë sistemin e tij ekonomik të suksesshëm dhe të qëndrueshëm.

Me rëndësi në zhvillimin e tërë këtij procesi ka qenë përfshirja e drejtpërdrejtë e bashkisë në planifikimin e ZhEV në të cilin ajo ka luajtur një rol drejtues, koordinativ dhe nxitës. Procesi u mbështet më tej nga institucionet publike të qytetit, komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe partnerët e tjerë nëpërmjet një punë të përbashkët e cila mundësoi krijimin e një vizioni të përbashkët dhe drejtimet më të rëndësishme të përcaktuara për garantimin e një mjedisi të përshtatshëm për ZhEV dhe që përkrah bizneset dhe shton punësimin.



### III. Rëndësia e PSZhEV për komunitetin tonë

Iniciativa që mori bashkia jonë për hartimin e PSZhEV është në kuadër të përpjekjeve për ushtrimin e funksionit të saj ligjor përkrahëse dhe mbështetëse e zhvillimit ekonomik brenda juridiksionit të territorit të saj duke synuar përdorimin në mënyrë sa më efektive dhe efçente të burimeve njerëzore, natyrore, sociale, institucionale, financiare dhe fizike me qëllim krijimin e një mjedisi miqësor për banorët, bizneset e vizitorët.

Procesi i tranzicionit kërkon ndryshime rrënjësore që duhen bërë për të përshtatur qytetin ndaj tendencave dhe kërkesave të një ZhEV të suksesshëm. Ndërkohë shumëllojshmëria e ekonomisë vendase për t'ju përshtatur kërkesave të tregut të lirë dhe dinamikat e zhvillimit të saj kërkojnë përshtatjen dhe rivlerësimin e marrëdhënieve ekzistuese mes bashkisë dhe komunitetit për të krijuar sisteme pune dhe struktura bashkëpunimi të cilat do t'i shërbejnë rehabilitimit gradual dhe konsolidimit të vazhdueshëm të një ekonomie të shëndetshme dhe të qëndrueshme në qytetin tonë.

Në këtë situatë të re ku bashkia jonë është e hapur ndaj konkurrencës kombëtare dhe ndërkombëtare për tërheqjen e bizneseve dhe krijimin e vendeve të punës, bëhet e domosdoshme përpjekja për të përcaktuar drejtimit që duhen ndjekur në të ardhmen duke u fokusuar dhe përdorur mirë burimet ekzistuese.

Qeveria vendore ka bërë edhe më parë përpjekje për të gjetur dhe bindur investues që të vinë në komunitetin tonë, por ato kanë qenë shpesh sporadike dhe të pakoordinuara mirë me faktorët e tjerë vendas apo ndonjëherë edhe ato më të largët. Përveç kësaj, përmirësimi i mjedisit vendor nga pikëpamja fizike, e cilësisë së shërbimeve, dhe stimuluesve financiarë që kërkohen për të siguruar që bizneset ekzistuese të vazhdojnë të operojnë dhe bizneset e reja që kërkojnë të operojnë ka qenë i papërshtatshëm për shkak të autoritetit të kufizuar ligjor dhe të kapaciteteve financiare të kufizuara të bashkisë.

Pavarësisht nga këto vështirësi, roli që ajo po luan ka ardhur gjithnjë duke u fuqizuar fillimisht si një vëzhgues i zhvillimeve ekonomike dhe ecurisë së biznesit në një aktor të përfshirë aktivisht në krijimin e hapësirave dhe lehtësirave në mbështetjen direkte të biznesit dhe si gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike dhe punësimit. Eksperienca në zhvillimin e Planit Strategjik tregoi se vetëm qeveria vendore, si autoriteti ku kulmojnë interesat politike dhe jopolitike të grupeve të ndryshme të shoqërisë, mund ta luajnë këtë rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit ekonomik duke përvetësuar një mentalitet dhe praktika pune të reja, si dhe me anë të ruajtjes së marrëdhënieve me aktorët dhe organizatat që veprojnë në komunitetin e vet.

Komuniteti ynë ka nevojë për një qeverisje vendore të zgjuar, partneritete që funksionojnë dhe një krenari civile dhe ne besojmë se strategjia aktuale ka hedhur themelet për këtë.

## IV. Plani Strategjik

Ky është i pari Plan Strategjik për ZhEV që është hartuar për bashkinë tonë dhe ai përfaqëson një përpjekje për të sjellë një ndryshim në mënyrën dhe cilësinë e qeverisjes, si dhe në procesin e vendimmarrjes.

Shfrytëzimi efektiv i avantazheve ekonomike që zotëron komuniteti ynë, si dhe nxitja e tërheqja e investuesve privatë varet shumë edhe nga cilësia e qeverisjes, shërbimeve që ofrohen, si edhe nga cilësia e politikave vendore që zhvillohen dhe zbatohen. Ato ndikojnë në infrastrukturën e shërbimeve të disponueshme për biznesin si: furnizimi me energji elektrike dhe me ujë, transport, telekomunikacion, menaxhimi i mbetjeve dhe planifikimi urban. Fakti që pjesa më e madhe e bizneseve që operojnë në bashkinë tonë janë mikro, të vogla dhe të mesme, që varen shumë nga cilësia e shërbimeve të ofruara nga qeveria vendore, e bën rolin e mëtejshëm të bashkisë edhe më të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi miqësor që përkrah zhvillimin e biznesit.

Ky Plan Strategjik synon të korrigjojë faktorët që kanë pasur deri tani një ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të bashkisë dhe në cilësinë e qeverisjes vendore, dhe kështu për të reduktuar pengesat dhe uljen e rreziqeve të të bërit biznes këtu. Procesi i planifikimit ndihmoi në vlerësimin e këtyre faktorëve dhe nëpërmjet kësaj procedure u realizua rishikimi aktiv i bazës ekonomike dhe faktorëve të zhvillimit të bashkisë për të krijuar një kuptim më i mirë mbi mundësitë dhe pengesat për rritjen ekonomike dhe tërheqjen e investuesve. Gjatë këtij procesi, partnerët tanë vlerësuan pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), faktorët kyç që nevojiten të adresohen me qëllim që të koordinohet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.

Në formulimin e Planit Strategjik, Komisioni i Planifikimit ka rishikuar burimet njerëzore dhe natyrore të disponueshme, gjendjen ekonomike të qytetit dhe zonës përreth saj, trashëgiminë kulturore dhe historike, avantazhet krahasuese, si dhe atë që komuniteti dëshiron dhe i nevojitet.

Ligji “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverive Lokale”, Nr 8652, datë 31.07.2000, Neni 10/III, thotë se “... bashkitë do të marrin përgjegjësitë për funksionet e mëposhtme ekskluzive të Zhvillimit Ekonomik Vendor ... atë të përgatitjes së programeve për zhvillimin ekonomik lokal” duke e bërë zhvillimin e një plani strategjik një detyrim ligjor të bashkisë.

Plani aktual u përgatit për një periudhë 16 mujore. Ne e kuptojmë se ndryshimet dhe përmirësimet e dëshiruara nuk mund të bëhen brenda një kohe të shkurtër. Megjithatë, drejtuesit e bashkisë, së bashku me aktorët publik dhe privatë, do të përkushtohen në zbatimin e këtij plani afatmesëm dhe duke siguruar burimet e mjaftueshme, që ai të realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse ky plan ka shumë të ngjarë të ketë sukses në arritjen e qëllimeve të tij.

Plani Strategjik u miratua nga Këshilli bashkiak me anë të Aktit Nr. 60 të datës 7 Korrik 2005.



## Filozofia që qëndron pas Planit Strategjik

PSZhEV i bashkisë tonë synon të ka si qëllim të nxjerrë në pah vizionin dhe qëllimet strategjike për zhvillimin e qytetit, të orientojë dhe konsolidojë përpjekjet e bashkisë dhe komunitetit që të zhvillojë një mjedis mbështetës dhe favorizues për zhvillimin e biznesit në vend.

PSZhEV ynë është krijuar për të adresuar si nevojat e drejtuesve tanë ashtu dhe ato të komunitetit tonë që të përmirësojë cilësinë dhe larmi e punëve që janë të disponueshme, të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët tanë dhe të mjedisit për zhvillimin e biznesit.

Bashkia dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e zhvillimit filloi të zbatonte vizionin duke u përqendruar në qëllimet parësore filozofike që shtrihen pas zhvillimit të PSZhEV-it tonë:

- T'i sigurojë komunitetit dhe qeverisë vendore një dokument orientues në përcaktimin e drejtimeve të ardhshme të rritjes ekonomike;
- Të krijojë një shembull të një procesi strategjik vendimmarrës që përfshin bashkëpunimin mes politikanëve vendas dhe komunitetit të biznesit;
- Të lehtësojë përpjekjet për bashkëpunim mes partnerëve publikë dhe privat për një zhvillim të koordinuar të bashkisë;
- Të krijojë një kornizë vendimmarrëse për çështje të tilla si shërbimet publike, infrastruktura, bashkëpunimi me biznesin;
- Të krijojë një eksperiencë të re dhe vendosjen e një kulture të planifikimit të zhvillimit ekonomik;
- Të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese, sepse ne besojmë se në një komunitet ku bizneset ekzistuese nuk janë të kënaqura, ka pak shanse që të mund të krijohen biznese të reja;
- Të ndikojë në politikat e financimit dhe mbështetjes teknike të qeverisë qendrore dhe agjencie donatorë;
- T'i japë bashkisë sonë autoritetin e duhur drejtues që kërkohet në planifikimin e zhvillimit ekonomik;
- Të mundësojë një qeverisje vendore transparente, efektive dhe që i përgjigjet me profesionalizëm nevojave dhe kërkesave pritshmërive të banorëve dhe vizitorëve.

## V. Zhvillimi i Planit Strategjik

Zhvillimi i Planit Strategjik u përfundua sipas metodologjisë së përdorur nga Banka Botërore. Kur përdoret procesi gjithëpërfshirës i planifikimit strategjik është e rëndësishme të arrihet një marrëveshje përfshirëse ku të ekuilibrohen nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore.

### Parimet orientuese

Parimet që orientuan bashkinë dhe Komisionin e Planifikimit në formulimin e Planit Strategjik përfshijnë si më poshtë:

- Suksesi ekonomik balancohet me cilësinë e jetës;
- Rritja ekonomike balancohet me kërkesat sociale dhe mjedisore;
- Bashkia është një faktor kyç në përmirësimin e klimës vendore për investime;
- Bashkëpunimi midis qeverisë bashkiake, bizneseve dhe shoqërisë civile është një element kyç në progresin e qëndrueshëm ekonomik;
- Planifikim strategjik është një proces gjithëpërfshirës, i integruar dhe i institucionalizuar në bashki;
- PSZhEV përcakton drejtimet kryesore për zhvillimin ekonomik, por nuk e kontrollon atë;
- Synohet përmirësimi i të gjithë mjedisit të biznesit, dhe jo thjeshtë mbështetja e bizneseve individuale;
- Ruajtja dhe mbështetja e bizneseve ekzistuese është po aq e rëndësishme sa tërheqja e bizneseve të reja, sepse ata sillen si një mjet shumë i mirë marketingu për të përkrahur klimën e biznesit;
- Zhvillimi i punësimit duke përdorur burimet e brendshme është më i rëndësishëm se krijimi i punësimit duke përdorur faktorët e jashtëm;
- Është e rëndësishme vendosja e partneriteteve publike–private në vendimmarrje dhe në përmirësimin e ekonomisë vendore;
- Sektorit privat është gjeneruesi kryesor i zhvillimit ekonomik.

### Metodologjia

Qeveria jonë bashkiake e konsideron PSZhEV si metoda më e mirë dhe sistematike e dobishme për të menaxhuar ndryshimin, për të siguruar konsensusin e komunitetit dhe për të krijuar një vizion të përbashkët për një të ardhme ekonomike më të mirë. Procesi i planifikimit strategjik mundësoi kombinimin e përpjekjeve dhe burimet që do të çojnë në përmirësimin e situatës ekonomike dhe



si rezultat, në krijimin e një kornize që synon krijimin e një mjedisi të shëndetshëm, të balancuar mirë për ekonominë dhe një cilësi të përmirësuar të jetës për qytetarët. Edhe pse përvijuar këtu kaq thjeshtë, kjo metodologji rezultoi të ishte shumë komplekse duke pasur parasysh sasinë e përpjekjeve dhe vendimmarrjen e kërkuar.

Procesi i planifikimit strategjik u shoqërua me aktivitete të ngritjes së kapaciteteve dhe të lehtësimit të procesit. Në funksion të ngritjes së kapaciteteve, DELTA organizoi një udhëtim studimor në Hungari ku u mbajtën tre seminare të shkurtra mbi çështjet e mëposhtme:

- Etapat dhe teknikat për zhvillimin e PSZhEV;
- Strukturat institucionale për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e PSZhEV në partneritet me komunitetin;
- Njohja me praktikat më të mira rajonale në PSZhEV;
- Metodologjia e zhvillimit dhe prioritarizimit të projekteve.

## **Procesi i planifikimit**

Baza e një procesi efektiv të planifikimit strategjik qëndron në të kuptuarit e çështjeve më të rëndësishme me të cilat përballohet komuniteti. Çështja e zhvillimit ekonomik duhet të paraqitet si një nga problemet për t'u zgjidhur, një nga nevojat për t'u adresuar dhe një nga mundësitë për t'u përdorur. Procesi që u aplikua këtu mundësoi njësimin e opinioneve dhe zgjedhjeve të qeverisë vendore me ato të biznesit dhe agjencive të tjera përfaqësuese.

Procesi i planifikimit u strukturua të kryhej në 5 faza:

1. Organizimi i përpjekjeve;
2. Vlerësimi i konkurrencës së ekonomisë vendore;
3. Zhvillimi i strategjisë;
4. Zbatimi i strategjisë;
5. Rishqyrtimi i strategjisë.

Gjatë periudhës së procesit të planifikimit ishin konsideruar një numër konsultimesh, vlerësimesh dhe vendimmarrjesh të përbashkëta lidhur me prezantimin dhe prioritetin e çështjeve kyçe për zhvillimin ekonomik.

Kur po shkruhej ky material, bashkia kishte përfunduar tre fazat e para dhe kishte hyrë në fazën e katërt.

## **Qasja organizative për hartimin e Planit Strategjik**

Qasja organizative që u aplikua ishte e tillë që lejoi në procesin vendimmarrës pjesëmarrjen direkte dhe të institucionalizuar të një grupi të gjerë personash që përfaqësonin komunitetin bashkë me kryetarin e bashkisë, anëtarë të këshillit bashkiak dhe stafin e qeverisë bashkiake.

Pjesë marrja u institucionalizua dhe strukturua nëpërmjet Komisionit të Planifikimit të ZhEV i ngritur dhe kryesuar nga kryetari i bashkisë. Roli i komisionit ishte të hartonte e të rishikonte Planin Strategjik, dhe kjo përgjegjësi vazhdon me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të planit. Struktura e Komisionit u ndërtua e tillë që mundësoi grupimin e anëtarësisë sipas fushave të zhvillimit dhe të interesit.


Element thelbësor në këtë strukturë ishte dhe mbetet Ekipi Kryesor i kryesuar nga Departamenti i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (DZhEB) dhe ku komuniteti i biznesit kishte një përfaqësues. Ekipi Kryesor luajti një rol kyç në koordinimin e punës midis anëtarëve të komisionit me partnerët e DELTA dhe me agjencitë dhe organizatat vendore e qendrore, të interesuara dhe të angazhuara në zhvillimin e bashkisë.

Secili nga katër anëtarët e Grupit Kryesor, kryesonte një skuadër të krijuar për të marrë të dhëna direkt nga komuniteti në procesin e planifikimit të ZhEV. Grupi përbëhej nga:

- Ekipi i Shoqërisë Civile, i kryesuar nga Z. Ridvan Sokoli
- Ekipi i Biznesit, i kryesuar nga Z. Simon Prendi
- Ekipi i Agjencive Publike, i kryesuar nga Z. Ahmet Omi
- Ekipi i Komunitetit, i kryesuar nga Z. Frederik Shiroka

## **Forumi DELTA i Kryetarëve të Bashkisë**

Gjatë zbatimit të programit DELTA, krijimi dhe funksionimi i Forumit DELTA i Kryetarëve të Bashkive ka shërbyer si katalizator në procesin e zbatimit të programit dhe si një forum ku kryetarët e bashkive dhe drejtuesit e grupit të Zhvillimit Ekonomik Vendor (ZhEV) mund të shkëmbenin eksperiencat dhe të hartonin planet e punës. Pesë forume u mbajtën gjatë procesit të planifikimit të ZhEV. Me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit, kryetarët e bashkive ranë dakord se një mjet shumë i rëndësishëm do të ishte krijimi dhe mirëmbajtja e një faqeje interneti për secilën nga pesë bashkitë e përfshira në programin DELTA.





## Pjesëmarrja dhe konsultimi

Formulimi i dokumentit të Planit Strategjik ishte synimi kryesor i bashkisë, por ajo pati si qëllim të përfshinte në procesin e planifikimit aktorë të tjerë të cilët do të kishin një rol vendimtar në zhvillimin e strategjisë. Do të ishte e pamundur për qeverinë tonë vendore të realizonte procesin e vetme. Kështu që, ishte e nevojshme që të përfshihej edhe ekspertiza e njerëzve të tjerë nga komuniteti që mund t'i sillnin procesit një gamë të gjerë eksperiencash duke siguruar që individëve më të aftë në komunitet t'u ofrohej mundësia për të paraqitur opinionet dhe preferencat e tyre për të adresuar çështjet më kritike që kanë të bëjnë me rritjen dhe zhvillimin ekonomik vendor.

Gjithsej, rreth 143 njerëz nga komuniteti morën pjesë në procesin e planifikimit përfshirë përfaqësues të qeverisë vendore, komuniteti i biznesit, bankat, institucionet arsimore, përfshirë universitetet, ndërmarrjet publike, OJF-të si dhe individë të tjerë të njohur në komunitet për nivelin e tyre të ekspertizës dhe kontributin në shoqëri.

Bashkia bëri një përpjekje të madhe për të mbajtur të angazhuar dhe të fokusuar këtë grup të gjerë aktorësh gjatë gjithë procesit të cilët vullnetarisht dhanë ndihmë të paçmuar në formulimin e draft Planit Strategjik.

Si rezultati i kësaj përfshirjeje, pjesëmarrja direkte e njerëzve jashtë qeverisë vendore të cilët kontribuan në proces, i dha Planit Strategjik një pronësi të plotë vendore.

Sigurimi i mbështetjes politike është prioriteti i punës sonë. Për këtë qëllim, ne kontaktuam Kryetarin e Këshillit Bashkiak dhe Komisionin e Këshillit për Zhvillimin Ekonomik dhe i informuam për projektin, mbështetjen që kërkohej dhe përjasjen e punës për zbatimin e projektit.

Gjatë zbatimit të projektit grupet e punës përgatitën informacione të zgjeruara të cilat u paraqitën në anëtarëve të këshillit me informacione mbi hapat dhe progresin e hartimit të planit strategjik.

Kualifikimi, përgatitja dhe trajnimi profesional i të gjithë njerëzve të përfshirë në proces u realizuan nëpërmjet formave të ndryshme dhe nën drejtimin kompetent të ekspertëve të fushave. Për këtë qëllim, tre seminare kryesore, mbledhje të ndryshme në disa zona dhe një udhëtim në Hungari u zhvilluan dhe këtij synimi i sherbeu edhe Forumi DELTA i Kryetarëve të Bashkive.

Në takimet e KPZHEV morrën pjesë përfaqësues nga biznesi, arsimi, kultura, bujqësia, tregtia, ndërtimi, transporti dhe shoqëria civile të cilat shërbyen për të mbledhur mendimet, propozime, sugjerime të cilat më pas u reflektuan në formulimet e Planit Strategjik.



Grupi Kryesor punoi në mënyrë efikase edhe me median si atë televizive dhe të shkruar. Media u konsiderua si një mjet i rëndësishëm mbështetës për progresin e PSZhEV. Disa nga takimet e e KPZHE u transmetuan në televizionin lokal të Durrësit.

Si rezultati i kësaj përfshirjeje, pjesëmarrja direkte e njerëzve jashtë qeverisë bashkiake të cilët kontribuuan në proces i dha Planit Strategjik një pronësi të plotë vendore.

### **Lista e pjesëmarrësve:**

#### **Ekipi i Agjencive Publike**

Ferid Hoti, Deputet

Astrit Bushati, Deputet

Mahir Hoti, Rektor i Universitetit të Shkodrës

Tonin Gjuraj, Këshilli Bashkiak

Myzafer Kraja, Drejtorja e Bujqësisë dhe Ushqimit

Astrit Beci, Drejtorja e Shëndetit Publik

Maxhid Cungu, Muzeu Historik i Qytetit

Elnar Dervishi, Bashkia

Teuta Haxhi, Bashkia

Vehbi Gruda, Bashkia

Afrida Damnori, Këshilli i Qarkut

Bardh Shllaku, Prefektura

Merita Kazazi, Këshilli i Qarkut

Fatmir Tepelia, Këshilli i Qarkut

Engjëll Gjondrekaj, Ndërmarrja e Ujësjetës të Qytetit

Arben Haveri, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë

Agron Ramadani, Ndërmarrja e Rrugë-Kanalizimeve

Ismet Hoxha, Klubi i Futbollit “Loro Boriçi”

Gëzim Mema, Klubi Shumë-sportesh

Sadetin Taipi, Biblioteka “Marin Barleti”

Mensur Bushati, Zyra e Shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike

Agron Dizdari, Teatri “Migjeni”

Surri Rregjimi, Albtelekom

Lindita Shiroka, Zyra e Postës

Gjokë Miri, Drejtorja e Taksave dhe Tatimeve

Fiqiret Bushati, Drejtorja Shërbimit Parësor

Osman Dashi, Drejtorja Rajonale e Rrugëve dhe Transportit Publik

Violeta Staka, Drejtorja e Sigurimeve Shoqërore Publike

Bujar Golemi, KESH

Viktor Jubani, Qendra Rajonale e Mjedisit, Shkodra

Eqerem Dushi, Drejtorja e Bujqësisë dhe Ushqimit

Munire Mandia, Drejtorja e Bujqësisë dhe Ushqimit

Engjëll Çeka, Dogana, Dega Shkodër

Sokol Haliti, Drejtorja Rajonale e Punësimit

Suela Mema, Zyra Regjistrimit të Pronave

Nathan Borgford-Parnel, PCV-USA

Florian Borshi, Ndërmarrja e Pastrimit

Xhelal Smajli, Bashkia

Marije Duoda, Bashkia

Elena Zorba, Bashkia

Nexhat Grezda, Bashkia

Alfred Luleta, Bashkia

Kujtim Domnori, Bashkia

Valbona Qehaja, Bashkia

Ludovik Vuka, Bashkia  
Alket Kadrija, Bashkia  
Eva Poja, Bashkia  
Andi Cungeli, Bashkia  
Behar Fejza, Bashkia  
Ledja Dushi, Bashkia  
Ymer Vizi, Bashkia  
Bepin Kurti, Bashkia  
Nazmi Berhani, Albtelekom  
Skënder Halili, Ndërmarrja e Gjellbërimit  
Agron Shima, Radio “Shkodra”  
Berti Stoja, Ndërmarrja e Ujësjetësitet Qytet  
Kujtim Alia, Qendra Kulturore e Fëmijëve  
Besim Dyca, Bashkia  
Gjon Nika, Bashkia  
Hare Bilal, Bashkia  
Tahir Sadiku, Drejtoria Shërbimit Parësor  
Osman Deltina, Ndërmarrja e Ujësjetësitet të Qytetit  
Reshat Zaganjori, Qendra Kulturore e Fëmijëve  
Zija Vukaj, Shkolla “Shejnaze Juka”  
Xhemal Shqau, Ndërmarrja e Pastrimit

#### **Grupi i Biznesit**

Sabri Bushati, Këshilli Bashkiak  
Musa Heta, Këshilli Bashkiak  
Edlira Tukaj, Universiteti i Shkodrës  
Olsi Kabashi, Bashkia  
Pjeter Kakia, Dafinor  
Shkelqim Koplaku, Progres-Metal G.  
Gjovalin Guli, G&S  
Fehmi Golemi, Green Shoe  
Petrit Stefa, Parku Auto  
Agron Çuliqi, U. Televa

Fatmir Lishi, Kompania e Sigurimeve “Sigal”  
Zef Gjini, “Gjini”  
Ilir Shurdha, “Ilira”  
Sokol Hoxha, Inform Shkodra Travel  
Tish Martini, Western Union  
Hedi Teli, “Casual”  
Mehdi Shabani, Kompani ndërtimi  
Senida Kruja, Banka Pro-Credit  
Lirije Vorfa, Raiffeisen Bank  
Artur Luka, Tirana Bank  
Qemal Sylja, Banka Shqipërisë  
Anton Leka, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë  
Sadije Bushati, Universiteti i Shkodrës  
Arjeta Troshani, Universiteti i Shkodrës  
Emirjeta Bejleri, Universiteti i Shkodrës  
Brilanda Bushati, Universiteti i Shkodrës  
Julinda Sokoli, Universiteti i Shkodrës  
Drita Kruja, Universiteti i Shkodrës  
Adem Bekteshi, Universiteti i Shkodrës  
Ylber Berhani, Banka Tregtare

#### **Grupi i Shoqërisë Civile**

Ardita Boriçi, Universiteti i Shkodrës  
Blerta Spahia, Universiteti i Shkodrës  
Zemaida Mozali, Bashkia  
Angelina Shllaku, Bashkia  
Shpëtim Quku, GTZ  
Gjon Shllaku, Shoqata “Preng Jakova”  
Filip Guraziu, MESH BUSH  
Gjenarin Shantoja, Agjencia Rajonale e Zhvillimit  
Terezina Hila, OXFAM  
Anila Trebicka, Gruaja në Zhvillim  
Ridvan Troshani, TEULEDA



Alma Kurti, ASDI

Luigj Mila, Paqe dhe Drejtësi

Kastriot Faci, The Door

Rikard Malaj, The Door

Rasim Suma, Shoqata për Mbrojtjen e Buri-  
meve të Peshkimit në Shkodër

Merzuk Hoxha, Shoqata e Higjenistëve Shko-  
dranë

Filip Vila, European Children's Trust

Zenepe Dibra, Gruaja Intelektuale Shkodrane

Diana Bejko, Qendra Rajonale e Mjedisit,  
Shkodër

Andi Cekaj, Kryqi i Kuq Shqiptar, Shkodër

Antoneta Pero, Qendra për Handikapatet

Ferid Lluja, Shoqëria Riza Pasha

Aldo Ferreti, COOP

Vildan Tufi, Sportet për të Gjithë

Aleks Dushi, AFFD

Maranaj Marku, MALTESER

Xhabir Mehmeti, Shoqata e Gjuetarëve

Shaqir Ramadani, Shoqata e Gjuetarëve

Migena Pengili, Qendra Rajonale e Mjedisit,  
Shkodër

### **Grupi i Komunitetit**

Ahmet Bushati, Ish kryetar, Këshilli Bashkiak

Vili Kamzi, Historian

Sherafet Kruja, Ekonomist

Agustin Jubani, Ekonomist

Karlo Kamsi, Specialist Ujërash

Isa Alibali, Specialist i Kulturës

Fatos Gjyrezi, Këshilli Bashkiak

Eduard Grishaj, Këshilli Bashkiak

Qamil Gjyrezi, Këshilli Bashkiak

Dashmir Dini, Këshilli Bashkiak

Anton Gurakuqi, Këshilli Bashkiak

Merita Dibra, Bashkia

Anol Dedja, Bashkia

Artan Kolnikaj, Jurist

## **Përmbledhje mbi vlerësimin e ekonomisë vendore**

Kushtet aktuale të ekonomisë vendore në Shkodër ishin subjekti i një analize SWOT (pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet), e cila shqyrtoi të dhënat bazë ekonomike dhe sociale, si dhe pikëpamjet vendore të shprehura në një sondazh biznesi dhe ato të shprehura nga Komisioni i Planifikimit.

Të dhënat e mbledhura përfshinin statistikën dhe informacionet në lidhje me burimet vendore, natyrore, njerëzore dhe financiare, strukturën e ekonomisë dhe të biznesit, nivelin dhe strukturën e punësimit dhe arsimit, si dhe kualifikimet e fuqisë së aftë për punë.

Gjatë zhvillimit të analizës SWOT, Komisioni i Planifikimit përfshiu një analizë sektoriale të zhvilluar nga ekipet e punës. Analiza SWOT u përdor si një platformë për të zhvilluar Planin Strategjik. Analiza e situatës vendore u vazhduar nga anëtarët e Komisionit të Planifikimit të cilët identifikuan avantazhet dhe sfidat kryesore me të cilat përballlet komuniteti në ecurinë e rritjes ekonomike.

Baza e të dhënave për këtë informacion u strukturua në pesë seksione si më poshtë vijon: demografi, biznes, kulturë dhe sporte, infrastrukturë dhe mjedisi:

<b>DEMOGRAFI</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Popullsia</li> <li>• Arsimi</li> <li>• Punësimi</li> <li>• Kujdesi social</li> <li>• Strehimi</li> <li>• Kujdesi shëndetsor</li> </ul>	<b>BIZNES</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizë biznesi</li> <li>• Bankat</li> <li>• Importe</li> <li>• Turizmi</li> <li>• Projekte trajnimi për biznesin</li> </ul>	<b>INFRASTRUKTURË</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrugët urbane</li> <li>• Furnizimi me ujë</li> <li>• Lejet e ndërtimit</li> <li>• Studimet urbane</li> <li>• Energji elektrike</li> <li>• Telekomunikacion</li> </ul>
<b>KULTURË DHE SPORTE</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucionet e kulturës dhe sporteve</li> <li>• Infrastruktura e institucioneve</li> <li>• Aktivitetet</li> <li>• Projektet</li> </ul>		<b>MJEDISI</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilësia e ajrit</li> <li>• Ujërat sipërfaqësor</li> <li>• Kushtet mjedisore</li> <li>• Liqeni i Shkodrës</li> <li>• Gjelbërimi i qytetit</li> <li>• Pastrimi i qytetit</li> </ul>

Në Maj 2004 u organizuan pesë takime në lidhje me analizën SWOT, një për secilin seksion të përmendur më sipër, ndërsa një takim tjetër shtesë u organizua në vijim për të kryer një analizë SWOT gjithëpërfshirëse.

Gjetjet kryesore të analizës ishin si më poshtë:

*Avantazhet kryesore*

- Pozicioni gjeografik: qendra kryesore administrative dhe e biznesit për Shqipërinë e Veriut dhe shumë afër me kufirin kombëtar;
- Akses i lehtësuar në rrjetin e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Ekzistence e burimeve natyrore unike dhe burimeve të mëdha ujore;
- Rritje e vazhdueshme demografike dhe force pune me moshe të re;
- Hapësirë për zhvillimin e parqeve të biznesit.

*Sfidat kryesore*

- Mungesë e një klime dhe imazhi të favorshëm për të tërhequr biznesin;
- Nivel i ulët i jetesës;



- Mungese e një ekonomie të larmishme dhe ekzistenca e një teknologjie të vjetruar;
- Lidhjet e kufizuara të bizneseve lokale me tregje kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Infrastrukturë e varfër urbane dhe shërbime publike me cilësi shumë të dobët;
- Ekonomi që ofron cilësi dhe larmi mallrash apo shërbimesh të pamjaftueshme.

## Perceptimet e bizneseve

Qeveritë vendore kanë mandatin e promovimit të zhvillimit të NVM vendase. Megjithatë, ky mandat konsiderohet nga sektori privat si i kufizuar ligjërisht sidomos përsa i përket sigurimit të burimeve për ndërmarrjen e aktiviteteve të biznesit.

Për të hyrë pak më thellë në këtë çështje dhe për të kuptuar shqetësimet e biznesit vendas më në detaje, në qytet u krye një sondazh. Qëllimi i sondazhit ishte mbledhja e informacionit dhe e pikëpamjeve të komunitetit të biznesit mbi situatën ekonomike në vend, perspektivën e të bërit biznes këtu, kushtet dhe rregullat që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve vendase, politikat dhe praktikatat që pengojnë zhvillimin e bizneseve ekzistuese, si dhe kërkesat e nevojat e komunitetit për përmirësimin e klimës së biznesit. Studimi mbi Klimën e Biznesit u zhvillua në mars–prill 2004 dhe në të morën pjesë **79 biznese** nga kategori të ndryshme.

Perceptimi kryesor i bizneseve është se qeveritë vendore nuk kanë mjetet e duhura ose autoritetin e duhur për të ndihmuar zhvillimin e NVM. Ky perceptim del në pah nga mungesa e komunikimit dhe dialogu i varfër midis qeverisë vendore dhe biznesit.

Biznesmenët e Shkodrës e shohin me sy më pak kritik këtë çështje sesa biznesmenët e diku tjetër në Shqipëri. Megjithatë ata mendojnë se diskutimet me autoritetet vendore kanë qenë shpesh më shumë teorike dhe jo të ndjekura nga veprime konkrete (OECD 2003: Albania – Enterprise Policy Performance Assessment).

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesit e biznesit shprehën dëshirën që të viheshin në dispozicion më shumë burime financiare për autoritetet lokale, që të rritej kapaciteti dhe mundësitë e tyre për të përkrahur zhvillimin ekonomik në Shkodër.

Përfshirja e opinioneve të biznesit në formulimin e Planit Strategjik ishte një hap i rëndësishëm në hapjen e procesit të vendimmarrjes. Nëpërmjet këtij hapi, u shqyrtuan opinionet e një grupi njerëzish që kanë influencën më të madhe mbi zhvillimin ekonomik të bashkisë.

## Vizioni dhe Qëllimet

### Vizioni

Qëllimi i përcaktimit të vizionit për zhvillimin tonë ekonomik vendor ishte që t'i mundësonte komunitetit tonë të artikulojë se ku ai dëshiron të jetë në të ardhmen, dhe çfarë rruge do të ndjekë për të arritur atje. Vizioni do t'u japë qytetarëve dhe qeverisë vendore një ide të qartë se çfarë duhet bërë dhe ku duhen përqendruar energjitë dhe burimet e tyre.

Vizioni u zhvillua nga Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (KZhEB) pas konsultimeve me segmente të ndryshme të komunitetit dhe pasi u prezantua publikisht nëpërmjet mediave lokale. Synimi ishte të krijohet një vizion i cili të mund të zhvillohet dhe të pranohet nga sa më shumë aktorë dhe grupe interesi të mundshëm dhe që do të sigurojë një përshkrim të hollësishëm të ardhmes së preferuar ekonomike të qytetit tonë.

Një vizion në këtë kontekst, është një ideal i cili i ka rrënjët në realitetin natyror, gjeografik, ekonomik, historik e kulturor të rajonit. Ai synon të përmbushë pritshmëritë dhe aspiratat e komunitetit dhe të përcaktojë një drejtim të qartë për zhvillimin e qytetit. Ne besojmë se në rastin tonë ai përmbledh në mënyrë realiste dëshirat dhe kapacitetet e komunitetit tonë. Ne synojmë që këtë vizion ta ndajmë në vazhdimësi me grupe të komunitetit tonë në mënyrë që ai të njihet dhe të pranohet më gjerë dhe kështu, të kthehet në një udhërrëfyes për ta bërë realitet këtë ideal.

Vizioni ynë do të rivlerësohet nga komuniteti, duke përfshirë vendimmarrësit në qeverinë vendore për të reflektuar ndonjë ndryshim të nevojshëm në të ardhmen.

### Qëllimet

Përcaktimi i qëllimeve të ZhEV na ndihmon të marrim vendime lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ndryshimet që nevojiten. Megjithëse disa nga qëllimet dhe veprimet për arritjen e tyre nuk lidhen direkt me krijimin e vendeve të punës dhe me zhvillimin dhe tërheqjen e bizneseve, e ardhmja e komunitetit tonë bazohet mbi themele të shëndosha si niveli i arsimimit dhe cilësia e jetës, infrastruktura dhe shërbimet bashkiake. Në konceptin tonë, bizneset nuk zhvillohen, nuk lulëzojnë dhe nuk mund të tërhiqen në komunitete, kur nuk ofrohen nivele dhe cilësi të përshtatshme të infrastrukturës dhe shërbimeve që kërkon një mjedis i mirë për zhvillimin e biznesit.

Për të arritur qëllimet e ZhEV, qyteti ynë është përqendruar në përdorimin e burimeve të veta natyrore dhe njerëzore. Për zhvillimin e qëllimeve, Komisioni i Planifikimit mori parasysh mundësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet bashkia, historinë e vet të zhvillimit ekonomik dhe të rajonit.



Qëllimet e ZhEV shprehin drejtimet kryesore që do të ndjekë zhvillimi i bashkisë. Këto janë renditur në faqen tjetër sipas rëndësisë për ZhEV dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm. Ato janë zhvilluar me anën e një analize logjike të kujdesshme të vizionit dhe trajtojnë çështje thelbësore për zhvillimin e qytetit.

## **Përfitimet e pritshme**

Përfitimet që priten si rezultat i zbatimit të Planit tonë Strategjik janë të shumëfishta, por më kryesoret janë si më poshtë:

- Orientimi i këshillit bashkiak dhe administratës së bashkisë në procesin e buxhetimit vjetor dhe afatmesëm duke u fokusuar në zbatimin e projekteve të përfshirë në PSZhEV;
- Fokusimi tek burimet njerëzore dhe financiare në fushat e identifikuara duke rritur maksimalisht përfitimet dhe mundësuar arritjen e qëllimeve dhe objektivave të PSZhEV;
- Fuqizimi i partneritetit të qëndrueshëm në vendimmarrje me bashkëfinancim të qeverisë vendore dhe komunitetit të biznesit;
- Rritja e kapaciteteve të administratës së bashkisë dhe veçanërisht të DZhEB;
- Koordinimin e aktiviteteve të organizatave dhe institucioneve të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e pjesëve të ndryshme të PSZhEV;
- Përcaktimi i një kalendari realist për zbatimin e PSZhEV;
- Identifikimi i rezultateve të pritshme;
- Zhvillimin e një sistemi eficient komunikimi mes bashkisë dhe partnerëve të saj;
- Lehtësimin e marketingut të potencialeve dhe të mundësive që të bëhet biznes në qytet;
- Krijimin e një sistemi monitorues në bashkëpunim me komunitetin, me qëllim ndjekjen e aktiviteteve dhe vlerësimin e rezultateve të parashikuara nga PSZhEV;
- Përmirësimin e sistemit të menaxhimit në bashki në funksion të zbatimit të programeve të përfshira në matricën e Planit;
- Orientimin e grupimit dhe të negocimit me aktorët vendorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë që janë të interesuar ose që janë përfshirë në projekte në PSZhEV;
- Orientimin e qeverisë vendore dhe donatorëve në dhënien e fondeve dhe në përqendrimin tek burimet ekzistuese të disponueshme.



## VIZIONI

Shkodra do të jete nje qender e rendesishme ekonomike, universitare dhe shkembimesh rajonale, ku do të harmonizohen mrekullia e natyres me historine, kulturen e njerezit, nje vend terheqes për të jetuar, punuar e pritur miq

### Qëllimi 1:

Shkodra me një ekonomi vendore tërheqëse dhe me një biznes dinamik ku nxitet dhe mbështetet zhvillimi i bizneseve prodhuese, të tregëtisë dhe shërbimeve të cilat operojnë sukseshëm në tregun rajonal

### Qëllimi 4:

Një qytet me një infrastrukturë dhe shërbime publike cilësore dhe të standarteve bashkëkohore që nxisin dhe mbështesin zhvillimin e ekonomisë vendore dhe që janë në harmoni me zhvillimet e qëndrueshme dhe ambientin

### Qëllimi 2:

Ruajtja dhe zhvillimi i traditës kulturore, artistike dhe historike të Shkodrës dhe promovimi i këtyre vlerave në funksion të zhvillimit të turizmit

### Qëllimi 3:

Qyteti një qendër arsimore e nivelit të lartë për të gjithë Shqipërinë e Veriut, me Universitetin si faktor i kyc për rritjen dhe përmisimin e nivelit arsimor dhe profesional

### Qëllimi 5:

Arrija e një cilësie jete të avancuar, duke krijuar aksesin e të gjithë banorëve tek shërbimet jetësore bazë si dhe duke zhvilluar hapsira e ambiente shërbimi dhe argëtimi ku nevojat e banorëve dhe vizitorëve plotësohen



## Zbatimi

Një PSZhEV është plani zyrtar për administrimin e qeverisë vendore, institucioneve dhe ndërmarrjeve që ka nën kontroll dhe si i tillë, është një plan që zhvillohet vazhdimisht. PSZhEV për qytetin tonë ka filluar dhe do të ndjekë katër faza:

1. Aktivizimi i burimeve të financimit dhe dhënia e fondeve;
2. Realizimi i partneriteteve publiko-private;
3. Monitorimi dhe vlerësimi i Planit;
4. Rivlerësimi dhe përmirësimi i Planit.

Duke qenë se afati i zbatimit të PSZhEV është më i gjatë se mandati politik, suksesi i zbatimit të strategjisë do të varet shumë nga angazhimi i vazhdueshëm i qeverisë vendore dhe shoqërisë civile në arritjen e objektivave dhe zbatimin e projekteve të përvijuara.

Këshilli bashkiak, si faktori kyç në mbështetjen e PSZhEV, do të garantojë dhënien e fondeve për financimin e projekteve. Përveç kësaj, ai do të ofrojë këshilla efektive për miratimin e përmirësimeve që do të sugjerohen nga Komisioni i Planifikimit dhe autoriteti ekzekutiv i qeverisë bashkiake.

Kryetari i bashkisë dhe Shefi i DZhEB do të koordinojnë programet, projektet dhe financimet e qeverisë qendrore, donatorëve dhe organizatat vendase dhe të huaja në mënyrë që ato të ndjekin dhe mbështesin PSZhEV. Përveç kësaj, ata do të iniciojnë dhe do të realizojnë përmirësimet e mjaftueshme në menaxhimin e procesit dhe do të ristrukturojnë stafin në funksion të zbatimit të PSZhEV. Suksesi i zbatimit të Planit do të varet më së shumti nga mënyra se si organizatat dhe agjencitë e përfshira në Planin Strategjik do të menaxhojnë elementët veçantë për të cilat ata janë përgjegjës.

Ndërkohë që komuniteti do të njohë progres me zbatimin e PSZhEV, vetë plani do të ketë nevojë të rishikohet, vlerësohet dhe përmirësohet për të adresuar situatat dhe kushtet e reja. Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (KZhEB) do të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e Planit duke mbajtur në mendje faktin se edhe komuniteti duhet të marrë pjesë në procesin e monitorimit.

## Qasja organizative për zbatimin e Planit

Bashkia caktoi KZhEB si institucionin kryesor që do të rishikojë dhe vlerësojë procesin e zbatimit të Planit Strategjik. Çdo katër muaj KZhEB do të mbledhet për të diskutuar ecurinë e zbatimit të Planit bazuar në raportet e përgatitura nga DZhEB. Ai, çdo vit në muajin gusht, do të diskutojë dhe miratojë

gjetjet, vlerësimet dhe do të shtojë sugjerimet për përmirësime të cilat do t'i paraqiten kryetarit të bashkisë e më pas Këshillit të Bashkisë për diskutim e miratim.

Përbërja e komisionit mund të ndryshoje. Megjithatë, funksionet e tij do të mbesin të njëjta: mbështetje, monitorim dhe rishikim i zbatimit të Planit. Ndërkohë, kryetari i bashkisë në konsultim me KZhEB, mund të emërojë grupe pune për të ndihmuar këtë të fundit në zbatimin e pjesëve të veçanta.

KZhEB do të zhvillojë dhe miratojë një plan pune vjetor për rishikimin e Planit Strategjik. Fondet për veprimtarinë e saj do të miratohen nga këshilli bashkiak mbi bazën e kërkesës së kryetarit të bashkisë.

DZhEB është struktura direkt përgjegjëse për të ndjekur procesin e zbatimit të planit, dhe kryesisht:

- do të sigurojë logjistikën e nevojshme administrative për aktivitetin e Komisionit të Planifikimit;
- do të koordinojë aktivitetet e aktorëve të identifikuar në Plan dhe të atyre që do të përfshihen më vonë;
- do të sigurojë personel për grupet e punës që do të punojnë pranë Komisionit të Planifikimit;
- do të përgatisë dhe paraqesë para kryetarit të bashkisë dhe Komisionit të Planifikimit raportet mbi përmbushjen e procesit të zbatimit të planit;
- do të sigurojë të dhëna dhe informacione që kërkohen nga kryetari i bashkisë dhe Komisioni i Planifikimit.

## **Financimi i Planit Strategjik**

Financimi i zbatimit të Planit Strategjik përbën një përpjekje të madhe për bashkinë po aq sa edhe hartimi i tij. Matrica e Zbatimit të Planit (Kapitulli VIIIc) identifikon kostot e përlogaritura dhe paraqet partnerët aktualë potencialë. Kostoja e përafërt e zbatimit të Planit llogaritet në 7,599,776,896 Lekë, ekuivalente me 60,798,215 Euro.

Bashkia do të financojë Planin Strategjik nga buxheti i saj dhe ky ka filluar tashmë në vitin 2005. Këshilli bashkiak do të vazhdojë të përfshijë zbatimin e programeve dhe projekteve të Planit në buxhetet vjetore dhe afatmesme të Bashkisë.

Plani Strategjik do të bashkëfinancohet nga qeveria qendrore, komuniteti i biznesit dhe grupe të tjera të komunitetit, donatorë e organizata vendase dhe të huaja. Angazhimi me investime direkte të komunitetit të biznesit ofron një garanci financiare më shumë në zbatimin dhe suksesin e tij.



## VI. Vështrim i përgjithshëm mbi komunitetin e Shkodrës

### Gjeografia dhe topografia

Qyteti i Shkodrës ndodhet në veri-perëndim të Shqipërisë. Koordinatat gjeografike janë: Gjerësi  $19^{\circ}30'42''$ , gjatësi  $45^{\circ}03'05''$ . Qyteti është i vendosur kryesisht në rrafshinë. Në drejtimin jug-perëndim veri-lindje ka kuotat nga 9.5 m deri në 24 m mbi nivelin e detit.

Gjeologjikisht qyteti ndodhet në rajonin e një fundosje tektonike të periudhës së pliocenit. Në truallin e qytetit gjinden depozitimet e lumenjve përreth. Klima është mesdhetare me një përzierje kontinentale dhe detare.

Në veriperëndim të tij ndodhet Liqeni i Shkodrës. Nga liqeni buron Lumi i Bunës (44 km) që derdhet në detin Adriatik. Rrjedhja e poshtme e lumit Buna ndan kufirin me Malin e Zi. Lumi Bunës bashkohet me lumin Drin rreth 2 km në jug-perëndim të qytetit. Nga ana lindore qyteti kufizohet nga Lumi i Kirit që buron nga Malësitë e Veriut dhe është 43 km i gjatë. Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore.

Pjesa kryesore fushore e qytetit sot ka një shtrirje prej 1,150 ha, ndërsa pjesa kodrinore ka një shtrirje prej 350 ha. Në qytet përfshihen dhe tre lagje periferike: Bahçalleku në jug, Shiroka dhe Zogaj në perëndim, të cilat zënë gjithsej një sipërfaqe prej 180 ha.

Shkodra nga ana lindore dhe jugore rrethohet nga një varg kodrash deri në 110 m lartësi, kodrat e Rrencit në lindje dhe të Tepes në jug. Në jugperëndim gjendet kodra shkëmbore e kalasë së Rozafës me lartësi 130 m dhe sipërfaqe 3.6 ha.

Nga veriu dhe veri-perëndimi shtrihet Fusha e Mbishkodrës përtej të cilës fillojnë Alpet e Shqipërisë. Rreth 30 km në juglindje ndodhet bregdeti Adriatik me Plazhin e Velipojës.


Siç shihet brenda një rreze prej 30 km, me qendër Qytetin e Shkodrës, ekziston një tërësi bukurish natyrore, nga malet e larta Shqiptare deri tek bregdeti mesdhetar i Adriatikut, nga brigjet e liqenit më të madh në Ballkan tek kodra shkëmbore e kështjellës së Rozafës, e cila qëndron madhërisht mbi një qytet i cili para 100 vjetësh kishte një lum të lundrueshëm duke sjellë anije tregtare dhe pasagjere në gjirin e saj.

### Demografia

Popullsia e qytetit Shkodër përbën rreth 32 % të popullsisë së Qarkut Shkodër dhe rreth 45 % të

popullsisë së Rrethit Shkodër. Si rezultat i ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhur në vend gjatë një dekade e gjysëm, popullsia e qytetit është rritur përafërsisht me 1/3, pavarësisht nga emigrimi si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. Rritja është paraqitur në tabelën e më poshtme dhe është ilustruar qartë në figurën shoqëruese:

Viti	Nr. i banorëve	Viti	Nr. i banorëve
1991	83,086	1998	101,257
1992	85,436	1999	102,937
1993	87,941	2000	104,667
1994	89,587	2001	106,415
1995	92,181	2002	107,924
1996	93,674	2003	108,995
1997	98,979	2004	109,632




Burimi: Bashkia e Shkodrës

Analiza e numrit të lindjeve dhe vdekjeve tregon që rritja e madhe e popullsisë ka ardhur si rezultat i migrimit nga jashtë qytetit (shih tabelën dhe figurën më poshtë). Të dhënat për ndryshimin mekanik paraqesin një shifër të përgjithshme që përfshin një numër të panjohur të emigranteve dhe të imigrantëve.

Viti	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
<b>Lindjet</b>	1,524	1,535	1,494	1,650	1,582	1,618	1,644	1,520	1,306	1,438	1,449	1,279	1,348	1,445
<b>Vdekjet</b>	587	612	596	627	615	584	662	726	656	583	621	601	598	702
<b>Ndryshimet mekanike</b>	1,413	1,598	748	1,571	526	2,822	1,382	886	1,080	894	661	393	-113	-194
<b>Ndryshimi total</b>	2,350	2,521	1,646	2,594	1,493	3,856	2,364	1,680	1,730	1,749	1,489	1,071	637	549

Burimi: Bashkia Shkodër



Burimi: Bashkia e Shkodrës

Rritja natyrore e popullsisë në Shkodrës është një numër pozitiv, d.m.th. numri i lindjeve është më i madh së numri i vdekjeve.

- Koeficienti i përgjithshëm i vdekshmërisë (numri i vdekjeve: numri i banorëve) ka ndryshuar shumë pak gjatë një dekade e gjysmë: nga 7 vdekje për 1,000 banorë në 1991, në 6 vdekje për 1,000 banorë në 2003.
- Saldot migruese rezultojnë mjaft pozitive nga viti 1991 e në vazhdim. Për vitet 2003 dhe 2004 saldoja migruese është negative.

Arsyet për shifrat e fundit mund të jenë të shumta. Për shembull, numri i emigranteve që janë larguar jashtë shtetit ose në Tiranë mund të ketë qenë rastësisht konstant, ndërsa numri i imigrantëve që kanë hyrë në qytet ka ardhur gradualisht duke u ulur.

Struktura e popullsisë sipas grupmoshës për vitin 2004 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:


Grupmosha (vitet)	< 1	1-4	5-9	10-14	15-19	20-34	35-54	55-64	> 64	Totali
Numri	1,500	8,675	9,150	9,443	9,377	28,688	25,300	8,022	10,027	110,182
Përqindja	1.36	7.87	8.31	8.57	8.51	26.04	22.96	7.28	9.10	100

Burimi: Bashkia Shkodër

Mosha mesatare e popullsisë së qytetit të Shkodrës është 27 vjeç (popullsi e re). Koeficienti i plakjes është 8 për qind (të rinj), ndërsa raporti i lindjeve meshkuj:femra ishte në favor të meshkujve gjatë viteve 1991-2003, raporti varionte midis 103 dhe 118 meshkuj kundrejt 100 femrave.

## Qeveria bashkiake

Bashkia e Shkodrës është pjese e Qarkut Shkodër. Në zgjedhjet lokale të Tetor 2004, kryetari i bashkisë së qytetit u zgjodh bashkë me 45 anëtarë të Këshillit Bashkiak, të cilët ishin përfaqësues të disa partive politike. Këshilli bashkiak miratoi strukturën organizative të administratës së bashkisë e cila është paraqitur në diagramën e mëposhtme:





### Të ardhurat dhe shpenzimet nga viti 2001 deri 2004

Të ardhurat (000 lek) dhe shpenzimet e Bashkisë së Shkodrës për vitet 2001 deri 2004 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Të ardhurat	2001	2002	2003	2004
<b>Të ardhurat lokale totale:</b>	<b>46,112</b>	<b>87,693</b>	<b>204,178</b>	<b>233,155</b>
nga taksat lokale	17,056	44,428	169,922	178,050
nga tarifata lokale	19,393	26,710	11,069	38,850
nga burime të tjera	9,663	16,555	23,187	16,255
<b>Të ardhurat totale nga Burimet Kombëtare:</b>	<b>1,082,547</b>	<b>1,102,883</b>	<b>1,345,117</b>	<b>1,146,340</b>
transferta të përgjithshme	140,154	252,891	156,940	127,769
transferta me destinacion	942,393	849,992	1,188,177	1,018,571
<b>Totali (000 Lekë)</b>	<b>1,128,659</b>	<b>1,190,576</b>	<b>1,549,295</b>	<b>1,379,495</b>
<b>Totali (në %)</b>	100	100	100	100
<b>Të ardhurat lokale në total:</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>13</b>	<b>17</b>
nga taksat lokale	2	4	11	13
nga tarifata lokale	1	2	1	3
nga burime të tjera	1	1	1	1
<b>Të ardhurat totale nga Burimet Kombëtare:</b>	<b>96</b>	<b>93</b>	<b>87</b>	<b>83</b>
transferta të përgjithshme	12	21	10	9
transferta me destinacion	84	72	77	74
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
<b>Shpenzimet</b>				
Investime nga burimet e veta	1	4	3	3
Investime nga burimet kombëtare	9	8	4	3
Shpenzime operacionale	90	88	93	94
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

*Burimi: Departamenti i Financës së qytetit*

Buxheti i bashkisë përbëhet nga dy linja kryesore:


- Buxheti i kushtëzuar
- Buxheti i pavarur

Buxheti i kushtëzuar përbëhet nga fonde specifike të alokuara nga qeveria qendrore për funksionet e deleguara dhe të përbashkëta, të cilat supervizohen nga ministritë e linjës. Buxheti i pavarur përbëhet nga të ardhurat e veta, të cilat janë të ardhura të realizuara nëpërmjet taksave lokale dhe tarifave për shërbime të ndryshme që bashkia ofron, nga shitja e asetëve të ndryshme të saj, si dhe që nga viti 1999 nga transfertat e pakushtëzuar.

Deri tani të ardhurat fiskale, pavarësisht reformave të ndërmarra në drejtim të decentralizimit, rezultojnë mjaft të centralizuara. Kjo gjë vërehet më së miri edhe nga grafiku.



Për Bashkinë Shkodër, nëse i referohemi raportit buxhet i kushtëzuar / buxhet i pa kushtëzuar vërejmë se buxheti i kushtëzuar zë 74 % të totalit në 2004, ndërsa në vitin 2001 ishte 84%.



*Burimi: Departamenti i Financës së qytetit*

Aftësitë politikbërëse të bashkisë, sidomos në drejtim të investimeve kapitale, funksioneve të përbashkëta, janë mjaft të centralizuara sepse pothuajse totalisht burimi i financimit është qeveria qendrore nëpërmjet ministrive të linjave.

Për sa i përket buxhetit të kushtëzuar, i cili përben dhe pjesën më të madhe të buxhetit të bashkisë, mungojnë mekanizmat dhe kriteret të qarta dhe transparente për përcaktimin e tij nga ana qeverisë qendrore. Kjo gjë reflektohet dhe në nivelin e ulët të investimeve të realizuar nga ana e bashkisë, megjithëse nevojat për investime kapitale dhe aftësitë absorbuese për fonde janë mjaft të mëdha.

Një tjetër burim i rëndësishëm për bashkinë janë dhe donatorët. Bashkia Shkodër ka raste pozitive në këtë drejtim ku mund të përmendim financimin e Kancelarisë Austriake në projektin e rehabilitimit të ujësjellësit dhe kanalizimeve qytet, rikonstruktimin e dy rrugëve urbane nga USAID etj.

Por në përgjithësi, pavarësisht takimeve direkte të bashkisë me donatore të ndryshëm, këta të fundit, për programet e asistencës, sidomos për rastin e financimeve të projekteve për investime kapitale, në shumicën e rasteve më përpara negociojnë me qeverinë qendrore (me ministrinë e linjës) dhe sipas politikave dhe preferencave të tyre drejtohen në qeveritë vendore.



## Arsimi

Në vitin 2001, niveli i arsimimit i popullsisë së rritur në qytetin e Shkodrës ishte si më poshtë:

<b>Niveli i arsimimit</b>	<b>Për qind</b>
Të paarsimuar	1
Dinë vetëm të shkruajnë dhe të lexojnë	12
Kanë ndjekur arsimin fillor	15
Kanë ndjekur arsimin e mesëm & profesional	31
Kanë ndjekur shkollën e mesme	32
Kanë ndjekur arsimin universitar	9

*Burimi: INSTAT*

## VII. Profil ekonomik i Shkodrës

Në periudhën 1945–1992, Shqipëria zbatoi të kundërtën e ekonomisë së tregut: prona private ndalohej dhe i gjithë aktiviteti ekonomik kontrollohej nga shteti. Vendi u be unik lidhur me izolimin dhe centralizimin ekonomik.

Aktivitetet kryesore të industrisë përpunuese në Shkodër ishte përpunimi i duhanit dhe prodhimi i cigareve, prodhimi i ushqimeve të konservuara, ushqime me baze sheqeri, pije të lehta dhe alkoolike, makarona, bukë, oriz dhe vaj vegjetal. Aktivitetet kryesore në industrinë e tekstileve ishin përqendruar në prodhimin e veshmbathjeve dhe produkteve të mëndafshit. Qyteti gjithashtu kishte një fabrike të përpunimit të drurit dhe të letrës. Industritë mekanike më të rëndësishme përfshinin prodhimin e kabll-ove, prodhimin e ashensorëve, linjave të autobusëve dhe fabrikën Drini. Dy ndërmarrje të rëndësishme artizanale kanë qenë Ndërmarrja Artistike dhe Ndërmarrja e Punimeve Xukthe Kashte.

Gjatë kësaj periudhe Shkodra ka pasur një nga pesë ekonomitë më të mëdha në Shqipëri. Sidoqoftë, në 1992, qeveria shqiptare ndërmori një sërë reformash dhe miratoi një sërë ligjesh që mbulonin pronësinë private, aktivitetin privat, falimentimin, investimet e huaja, mbrojtjen e konsumatorit, privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), dhe shumë elemente të tjerë të përfshirë në tregtinë moderne.

Si rezultat i këtyre reformave, ndryshime të mëdha ndodhen në strukturën ekonomike të Shkodrës kështu që 90 për qind e ndërmarrjeve të dikurshme shtetërore në qytet, u privatizuan. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e këtyre bizneseve të privatizuara nuk i vazhduan linjat e tyre origjinale të prodhimit, veçanërisht në industrinë e inxhinierisë mekanike, e cila ka qenë unike në vend dhe që ka pasur një treg kombëtar të garantuar.

Përpunimi ushqimor, përpunimi i drurit dhe industria e prodhimit artizanal, të cilat kanë qenë ndër prodhuesit më të mëdhenj në atë kohë, u shkrinë në një numër të madh NVM.

Ndërkohe, industria e përpunimit të duhanit dhe prodhimit të cigareve u shkatërruan komplet: paaftësia për të investuar në përmirësimin e teknologjisë dhe konkurrenca nga produktet e importuara shkaktoi falimentimin e saj.

### Burimet natyrore të rrethit Shkodër

Qarku i Shkodrës kufizohet në veri me rrethin e Malësisë së Madhe, në perëndim me Republikën e Serbisë dhe të Malit të Zi dhe detin Adriatik, në jug me rrethin e Lezhës dhe në lindje me rrethin e Pukës. Qarku i Shkodrës ka një sipërfaqe prej 2,049 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 243,000 banorësh.



Territori përfshin tre liqene. Liqeni i Shkodrës, liqeni më i madh në Ballkan, ka një sipërfaqe prej 369 km<sup>2</sup> nga të cilat 149 km<sup>2</sup> shtrihet në territorin shqiptar, kurse pjesa tjetër shtrihet në Malin e Zi. Thellësia mesatare është 10 m, temperatura mesatare e ujit është 16.5°C, e cila e bën më të butë klimën e qytetit. Liqeni është shumë i pasur me peshk, me një rendiment vjetor 50 kg/ha. Vija e bregut të liqenit ka një gjatësi prej 14.5 km nga e cila rreth 10 km është shkëmbore dhe 4.5 km fushore, më shumë e kufizuar me fusha.

Dy liqenet e tjera në rrethin e Shkodrës janë artificiale: liqeni artificial i Vaut të Dejës, 20 km në lindje të Shkodrës me një sipërfaqe prej 27 km<sup>2</sup>. Ndërsa liqeni i Komanit 40 km në lindje të Shkodrës ka një sipërfaqe prej 17 km<sup>2</sup>. Të dy këta liqene janë vendosur mbi lumin Drin dhe janë krijuar për të siguruar furnizimin e dy hidrocentraleve: Vau i Dejës, me një fuqi të instaluar prej 250 MW ndërsa ai i Komanit me një fuqi të instaluar prej 600 MW.

Në veri të Shkodrës, në malësitë e saj ekzistojnë burime të tjera ujore. Pellgjet ujëmbledhës malore kanë një lartësi mesatare 800 m mbi nivelin e detit dhe kanë rezerva potenciale energjie të shfrytëzueshme prej 400 MW/orë, duke lejuar ndërtimin e hidrocentraleve të vogla.

Burimet minerale më të rëndësishme në zonë gjenden në minierën e bakrit në Palaj Karme, 45 km larg qytetit. Kjo miniere u aktivizua në vitin 1981 dhe përlllogaritja e rezervave të saj rezultoi të jetë më shumë se 1 milion ton me 2.5 për qind xeheror bakri. Burime të tjera të bakrit të papërpunuara gjenden në Turec, 40 km larg nga Shkodra. Për më tepër, ekzistojnë boksitë (xeheror alumini) të ndodhura në Villgar, 13 km larg nga Shkodra.

Mineralet jometalore gjenden në vendet e mëposhtme:

- Kaolin (argjilë e bardhe e përdorur për të prodhuar porcelanin dhe disa barna mjekësore) në Domen-Postribe (13 km) dhe në Vig (45 km);
- Burim silici në Vilze (21 km);
- Burime dolomiti (gur gëlqeror) në Rrasek (11 km);
- Burime Rrioliti në Gur të Zi (6 km).

Në periferi të qytetit të Shkodrës ka rezerva të mëdha lëndë e papërpunuar për prodhimin e materialeve të ndërtimit, si çimento, gëlqere, tulla, tjegulla, qeramikë, mermerë, gurë dekorative, etj.

Sipas relievit toka përreth Shkodrës përbëhet afërsisht 19,220 ha ose 64 për qind fushë, 7,450 ha (25%) kodër dhe 3,590 (11%) male. Toka dhe pjesa më e madhe e kodrave janë të punuara në një mënyre ose në një tjetër.

Sipas studimeve të fundit agrokimike më shumë se 75 për qind e sipërfaqes është shumë e pasur ose pjesërisht e pasur me elementet azot, fosfor dhe kalium. Tokat në fushe janë me taban të thelle. Tipet dominuese të tokës janë kullota neutrale dhe aluvionale.

Në përputhje me regjistrin e tokave qarku Shkodër disponon 151,427 ha toke gjithsej, prej së cilëve 30,243 ha toke bujqësore, 54,510 ha pyje, 10,454 ha livadhe dhe kullota dhe 56,220 ha të llojeve të tjera. Nga toka bujqësore 29,289 ha tokë janë fusha, 184 ha pemishte, 561 ha ullishte dhe 208 ha vreshta. Sipas Drejtorisë Bujqësisë së Rrethit kulturat bujqësore dominante janë si më poshtë:

- foragjere, 10,321 ha;
- drithëra buke 6,076 (grurë 2,544 dhe misër 3,532) ha;
- perime gjithsej 2,755 ha;
- fasule 597 ha;
- patate 231 ha;
- duhan 213 ha.

## **Turizmi**

Turizmi në rajonin e Shkodrës ka patur tradite qysh në kohëra të hershme. Produktin turistik që ka ofruar ky rajon e ka konsumuar dhe pëlqyer shumë si turisti dhe vizitori i huaj por edhe vetë vendasit e sidomos shkodranët. Ky ka qenë i zhvilluar si në drejtimin e ardhjeve të turistëve të huaj ashtu edhe në konsumin në pjesën më të madhe të produktit turistik nga vendasit.

Rajoni i Shkodrës, duke u konceptuar jo e veçuar Shkodra nga Malësia e Madhe, ka një pozitë gjeografike që i favorizon më tepër nga çdo rajoni tjetër në Shqipëri zhvillimin e disa llojeve kryesore të turizmit. Ato janë katër:

- Turizmi qytetar i përfaqësuar nga qyteti i Shkodrës me objektet e saj të kultit (me ekzistencën e tre besimeve fetare në qytet) monumentet e kulturës, Kështjellën Rozafat dhe 40 shtëpiat karakteristike;



- Turizmi malor i përfaqësuar nga zona Razem–Bogë–Theth vetëm 45 km nga qyteti;
- Turizmi bregdetar i përfaqësuar nga Velipoja, vetëm 30 km nga qyteti;
- Turizmi liqenor i përfaqësuar nga zona e Shirokës dhe Zogaj.

Duhet theksuar se pozita gjeografike e rajonit të Shkodrës përbën në mënyre të padiskutueshme premisën kryesore për zhvillimin e turizmit në këtë Rajon. Përveç kësaj është e rëndësishme të shtohen këtu vlerat kulturore, historike e njerëzore që ka qyteti i Shkodrës dhe që përbejnë një mundësi më tepër drejt këtij zhvillimi.

## Fuqia punëtore


### 1. Punësimi

Punësimi në sektorin privat prej vitit 1994 deri në 2004 është paraqitur në tabelën më poshtë.

Viti	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Numri i punonjësve	7,391	8,483	8,190	4,141	4,034	3,802	4,972	5,223	5,496	5,611	6,529

Burimi: Zyra Rajonale e Punësimit në Shkodër

Luhatja e numrit të të punësuarve në sektorin privat tregohet qartë në grafikun e mëposhtëm prej të cilit mund të shihet se niveli i punësimit ka shënuar një rritje gjatë gjashtë viteve të kaluara duke arritur nivelet e një dekade më parë. Rënia e numrit të njerëzve të punësuar në sektorin privat gjatë viteve 1996 dhe 1997 koïncidon me falimentimin e skemave piramidale në Shqipëri në ato vite.



Detajimi i mëtejshëm i shifrave të punësimit sipas sektorëve dhe aktivitetit ekonomik për vitin 2004, tregohet në tabelën në faqen vijuese.

Lloji i aktivitetit	Sektori privat		Sektori publik		Totali		Të punësuar (%)
	Nr. i subjekteve	Nr. i punonjësve	Nr. i subjekteve	Nr. i punonjësve	Nr. i subjekteve	Nr. i punonjësve	
	Bujqësi, gjueti, silvikulture			3	167	3	
Industri minierash			2	12	2	12	0.08
Prodhimi:							
Industria ushqimore	76	267					
Tekstile dhe veshje	21	1,059					
Lëkurë dhe këpucë	4	718					
Të tjera	64	313					
Prodhimi gjithsej	165	2,357	2	55	167	2,412	16.00
Prodhimi dhe përdorimi i energjisë, ujit, etj.	1	2	10	985	11	987	7.00
Ndërtim	103	970			103	970	6.30
Tregtia, riparimi automjeteve dhe artikujve shtëpiake	747	1,690			747	1,690	11.10
Hotele dhe restorante	140	262			140	262	2.00
Transporti dhe telekomunikacioni	109	167	6	437	115	443	3.00
Aktivitete financiare	4	31	3	57	7	88	0.60
Administrimi publik	13	168	58	2,913	71	3,081	20.24
Arsimi	19	243	13	2,407	32	2,650	17.41
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	53	70	4	1,287	57	1,357	8.92
Shërbime sociale kolektive dhe personale	278	565	12	371	290	936	6.20
Institucione ndërkombëtare	1	4			1	4	0.03
<b>Totali</b>	<b>1,633</b>	<b>6,529</b>	<b>113</b>	<b>8,691</b>	<b>1,746</b>	<b>15,220</b>	<b>100.0</b>

Burimi: Zyra Rajonale e Punësimit në Shkodër

Është e dukshme që sektori publik është punëdhënësi më i madh në Shkodër me 57 për qind të fuqisë totale punëtore. Administrata publike është punëdhënësi i vetëm më i madh me 20 për qind të totalit. Punëdhënësi tjetër më i madh janë sektori i arsimit (17%), industria prodhuese (16%), tregtia (11%), sektori i aktiviteteve shëndetësore dhe sociale (9%), prodhimi, shpërndarja dhe furnizimi me energji elektrike dhe ujë (7%) dhe ndërtimi (6%).

## 2. Papunësia


Papunësia në Shkodër prej viteve 1996 deri në 2004 paraqitet në tabelën më poshtë.

Viti	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
<b>Nr. i të papunëve</b>	13,177	17,596	21,585	22,026	21,309	18,922	18,263	18,263	17,097

Burimi: Zyra Rajonale e Punësimit në Shkodër



Nuk është për t'u habitur, shifrat luhaten në mënyrë të kundërt në lidhje me shifrat e punësimit të raportuara më sipër. Kështu, në vitin 1996, numri i të papunëve u rrit rreth një herë e gjysëm, ndërsa në 2004 ky raport ishte dy herë e gjysëm. Niveli më i lartë i papunësisë u regjistrua ndërmjet viteve 1998 dhe 2000 siç tregohet qartë në grafikun e mëposhtëm.



Midis punëkërkuesve të papunë aktivë në vitin 2004 janë regjistruar më shumë meshkuj sesa femra të papunë, dhe përqindja më e lartë e papunësisë është regjistruar në grupmoshat e reja rreth të njëzetave. Niveli i papunësisë bie me rritjen e nivelit të arsimimit siç tregohet edhe në tabelën më poshtë.

Totali	Femrat	Kryefamiljari	Sipas grupmoshave				Arsimi i mesëm	Sipas nivelit të arsimimit		
			15–19	20–24	25–34	>34		Gjimnazet	Profesional	Universitet
17,097	6,907	7,601	2,919	7,360	1,488	5,330	7,989	6,187	2,408	513
%	40	44	17	43	9	31	47	36	14	3

*Burimi: Zyra Rajonale e Punësimit në Shkodër*


Nga i njëjti burim informacioni si më sipër, raporti i përqindjes së popullsisë aktive me popullsinë totale është 29 për qind, ndërsa niveli i papunësisë në vetvete është 54 për qind ndër më të lartat në vend.

### Bizneset private në Shkodër

Shkodra llogaritet të ketë 3 për qind të gjithë bizneseve aktive në Shqipëri. Tirana ka numrin më të madh të ndërmarrjeve me 39 për qind, ndërsa më shumë se 60 për qind e gjithë aktivitetit ekonomik ndodhet në korridorin Tiranë–Durrës–Fier. Duke bërë një krahasim, e gjithë gjysma veriore e Shqipërisë që përfshin rajonet e Shkodrës, Lezhës, Kukësit dhe Dibrës është vetëm 7 për qind të bizneseve siç raportohet edhe në tabelën dhe shifrat e mëposhtme.




Qarku	Nr. i ndërmarrjeve	Përqindja
Tirana	20,152	39
Durres	6,308	12
Fier	5,376	10
Korça	4,683	9
Vlora	3,730	7
Elbasan	3,499	7
Berat	2,440	5
Gjirokastra	2,140	4
Shkodra	1,579	3
Lezha	975	2
Dibra	684	1
Kukës	379	1



Burimi: INSTAT Regjistri i Bizneseve (2003)

Tabela e mëposhtme tregon numrin e bizneseve në prefekturën e Shkodrës për periudhën 1994–2004. Numri më i madh i bizneseve regjistrohet në periudhën 1994 dhe 1995, rezultat i reformave ekonomike dhe privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore të cilat u shndërruan në NVM. Kjo u pasua me një rënie drastike të numrit të bizneseve mes viteve 1996 dhe 1999 siç tregohet edhe në tabelën shoqëruese.

Viti	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Nr. i bizneseve	2,310	2,594	1,792	987	1,037	944	1,431	1,582	1,654	1,652	1,633




Burimi: INSTAT Regjistri i Bizneseve (2003)

Gjatë periudhës 1997 deri 1999 rezultoi një rënie e pjesshme si pasoje e mbylljes së kufirit me ish-Jugosllavinë (Mali i Zi), e cila reduktoi ndjeshëm shkëmbimin ekonomik midis dy vendeve e për rrjedhojë edhe aktivitetin në anën tjetër të kufirit. Përveç kësaj, Shqipëria po kalonte krizën e vitit 1997 të sipërpërmendur gjatë së cilës bizneset e Shkodrës u dëmtuan rëndë duke u detyruar të mbyllin ose të reduktojnë aktivitetin e tyre. Për më tej, që prej asaj kohe situata në lidhje me furnizimin me energji elektrike (me një mesatare prej 6 ose 7 orësh në ditë) dhe infrastruktura e qytetit kanë qenë kritike. Megjithatë, gjatë vitit 2000, ka pasur një rritje në numrin e bizneseve me rreth 487 krahasuar me vitin e kaluar, dhe numri është rritur pak që prej asaj kohe duke arritur në 1,600.


Tabela e mëposhtme dhe diagrama tregojnë strukturën dhe përmasën e tipeve të bizneseve aktive në Shkodër dhe rreth saj gjatë vitit 2003. Ndërmarrje shumë të vogla, të vogla dhe të mesme përbëjnë afërsisht 99 për qind të bizneseve me vetëm 1 për qind të bizneseve si ndërmarrje të mëdha.

Aktiviteti ekonomik	Mikro	Të vogla	Të mesme	Të mëdha	Totali
Bujqësia	19	2	7	2	30
Industria	197	33	22	15	267
Ndërtimi	151	31	12	1	195
Transporti	95	6	2		103
Tregti	760	19	4		783
Shërbime	175	17	6	3	201
<b>Totali</b>	<b>1,397</b>	<b>108</b>	<b>53</b>	<b>21</b>	<b>1,579</b>

Burimi: Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve



Situata në lidhje me aktivitetin ekonomik sipas numrit të bizneseve tregohet në diagramën e mëposhtme. Tregtia është në vend të parë me 54 për qind, industria në vend të dytë me 14 për qind, shërbimet me 13 për qind, ndërtimi me 11 për qind, transporti me 7 për qind, dhe bujqësia me vetëm 1 për qind.



Burimi: Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve

Shumica e bizneseve në qarkun e Shkodrës realizojnë një xhiro vjetore më pak se 800,000 Lekë (8,000 USD). Detajimi sipas aktivitetit të bizneseve aktive në bashki për vitin 2004 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Aktiviteti ekonomik	Numri	Përqindja
Tregtia, riparimet	783	58
Përpunimi	146	11
Transporti dhe telekomunikacionet	105	7.5
Aktiviteti i kujdesit shëndetësor dhe social	91	7
Ndërtimi	85	6
Shërbimet sociale në grup dhe personale	69	5
Hotele, restorantet	24	2
Financat	11	1
Arsimi	6	0.5
Të tjera	32	2
<b>Totali</b>	<b>1,352</b>	<b>100</b>


Burimi: Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve



Tregtia zë përafërsisht 2/3 e këtyre bizneseve, me përpunimin si sektori tjetër më i madh, dhe të tjerat secila më pak se 1/10.

Për bizneset në Shkodër më të ardhura më të mëdha se 800,000 Lekë të quajtura biznese të mëdha, kemi strukturën e mëposhtme:


Aktiviteti ekonomik	Numri	Përqindja
Tregtia	162	45
Ndërtimi	85	24
Prodhimi	80	23
Transporti	9	3
Shërbimi telefonik	2	1
Të tjera	14	4
<b>Totali</b>	<b>352</b>	<b>100</b>



*Burimi: Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve*

Tregtia ende zë afërsisht gjysmën e bizneseve të mëdha, i ndjekur nga sektori i ndërtimit. Në sektorin e përpunimit ka një numër specialitetesh siç janë veshmbathjet, përpunimi i ushqimit, i drurit, regjja e (lëkurës dhe e këpucëve) dhe të tjera. Detajimi në lidhje me numrin e bizneseve sipas aktivitetit ekonomik është dhënë në tabelën dhe diagramën e mëposhtme.

Aktiviteti ekonomik	Numri	Përqindja
Veshmbathjet	20	25
Përpunimi i ushqimit	19	24
Përpunimi i drurit	11	14
Lëkurë dhe këpucë	7	9
Të tjera	23	28
<b>Totali</b>	<b>80</b>	<b>100</b>




Burimi: Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve

#### Të ardhurat e bizneseve të mëdha në Shkodër

Aktiviteti	Të ardhura (Lekë)	Përqindja
Tregtia	294,214,633	30
Ndërtimi	242,282,001	25
Karburante	223,499,438	23
Materiale ndërtimi	48,485,826	5
Këpuce	40,352,908	4
Produkte druri	31,851,330	3
Veshmbathje	26,715,010	3
Prodhime ushqimore	19,872,517	2
Transport	12,123,565	1
Cigare	8,239,850	1
Të tjera	33,185,872	3
<b>Totali</b>	<b>980,822,955</b>	<b>100</b>

Burimi: Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve


Nga tabela e mësipërme është e qarte se të ardhurat totale nga bizneset e mëdha në qytetin e Shkodrës kanë një shumë prej 981 milion Lekësh (rreth 9.8 milion dollar). Detajimi i të ardhurave prej këtyre aktiviteteve të ndryshme ekonomike tregohet në figurën e mëposhtme. Tregtia zë përafërsisht 1/3 e të ardhurave, me ndërtimin dhe tregtinë e karburanteve, ku secila prej tyre zë rreth 1/4 e të ardhurave. Bizneset e tjera ndryshojnë me 22 për qind.



Burimi: Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve

Në kundërshti me këtë, të ardhurat nga bizneset e vogla, jo çuditërisht, janë shumë më të vogla sesa ato të bizneseve të mëdha siç tregohet edhe në tabelën e mëposhtme (në mijë Lekë). Ajo që tregohet në këto shifra është rritja e jashtëzakonshme eksponenciale nga të ardhurat e bizneseve të vogla nga viti 2000 deri 2003, ndoshta si rrjedhojë e zvogëlimit të tregut informal.

Aktiviteti ekonomik	2000	2001	2002	2003
Tregtia	8,344	16,303	32,161	57,265
Shërbimet	4,910	7,922	16,658	33,698
Transporti	5,004	9,478	11,230	8,629
Prodhimi	1,025	2,117	5,829	8,180
Artizanati	1,792	4,414	3,802	3,205
<b>Totali</b>	<b>26,381</b>	<b>50,888</b>	<b>81,591</b>	<b>110,977</b>



Burimi: Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve

## Shërbimet dhe infrastruktura

### 1. Furnizimi me ujë

Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm administrohet nga ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve.

Rrjeti i furnizimit me ujë të qytetit të Shkodrës është ndërtuar dhe funksionon që nga viti 1964. Sistemi përbehet nga stacionet pompave të ujit në Dobraq, rezervuarët e ujit në kodrat Tepe dhe rrjeti shpërndarës Në total, janë instaluar 200 km tubacione të lidhura me një rezervuar me kapacitet 8,000 m<sup>3</sup> dhe një stacion pompe uji me kapacitet 1,000 l/sek.

Burimi i ujit të pijshëm të qytetit vjen nëpërmjet 11 puseve, të ndodhura në zonën e Dobraqit me një kapaciteti prodhues 1,200 l/sek. Shpërndarja e ujit në qytetit kryhet direkt nga rrjeti i ujësjellësit dhe nga rezervuarët e kodrave të Tepes.

### 2. Kanalizimet e ujerave të zeza

Rrjeti i kanalizimeve të ujerave të zeza është nën administrimin e Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Qytet sh.a. Sistemi është ndërtuar dhe funksionon që nga viti 1978. Përbëhet nga një rrjet kryesor (kolektor) me gjatësi 10.5 km dhe rrjeti sekondar 138 km. Ka në përbërje rreth 6,000 puseta dhe një stacion pompimi për largimin e ujerave të zeza me kapacitete 650 lit./s.

Në këtë sistem janë të lidhur rreth 70% e kontraktorëve. Pjesa tjetër funksionon me gropa septike. Ujerat industriale derdhen në lumin Kir.

I gjithë sistemi i KUZ punon me vetërrjedhje duke shfrytëzuar pjerrësinë e qytetit dhe nëpërmjet kolektorëve kryesorë prurjet e ujerave të zeza përfundojnë në stacionin e pompimit që ndodhet në Lagjen “Liria”. Derdhja e ujerave të zeza nëpërmjet stacionit të pompimit bëhet në lumin Drin, pranë urës së Bahçallekut. Sasia e përgjithshme e largimit të ujerave të zeza është afërsisht 9.6 milion m<sup>3</sup> në vit. Sistemi aktual i ujerave të zeza nuk ka trajtimi përfundimtar të tyre. Në rastin kur stacioni i pompimit nuk funksionon ujerat e zeza derdhen në liqenin e Shkodrës duke shkaktuar probleme serioze mjedisore.

### 3. Mbrojtja nga përmytja

Kuotave të ulëta të terrenit, niveleve të larta të ujerave nëntokësore, reshjeve me intensitet të larte i korrespondojnë pika shkarkimi (derdhjeje) të ujerave të bardha të cilat influencohen dhe nga tërësia ujore e Shkodrës, Liqeni–Buna–Drini–Kiri, me nivel maksimal të vërtetuar në qytet të ujerave të liqenit me kuotën 9.7 m.

Në këtë tërësi të ujerave qyteti ka pasur rrjetin e kanaleve që ka qene kryesisht i hapur dhe në ndonjë rast me kanale të mbyllur të cilat derdheshin në të ashtuquajturat “katër vijat e mullinjve” që ishin ndërtuar në pjesët më të ulëta të qytetit.



Ndërtimet e bëra pas viteve ‘50 në qytetin e Shkodrës u ndërthuren me infrastrukturën ekzistuese ku në asnjë rast nuk është studiuar zhvillimi i kanalizimeve të ujerave të bardha ose ruajtja e plote e atyre ekzistuese. Për rrjedhojë janë nxjerre jashtë përdorimit pjesa më e madhe e kanaleve të mëdhenj përmes të cilave realizohej mbledhja dhe shkarkimi i ujerave të bardha.

Qe nga ajo kohe nuk është ndërtuar asnjë kanal kryesor i ujerave të bardha (magjstral) edhe në kohën kur janë projektuar dhe ndërtuar sistemet e Ujësjellësit të Qytetit dhe të ujerave të zeza (1970–1978). E gjitha kjo nën argumentin se projektimi dhe zbatimi i sistemit KUB do të realizohej mbasi të ndërtoheshin veprat hidroenergjetike mbi lumin Drin dhe pasi të sistemohej lumi Buna, çka do të sillte uljen e nivelit të liqenit.

Mbas viteve ‘90, si rezultat i lëvizjes të pakontrolluar nga zonat rurale, nga ndërtimet pa kriter, gjendja e rrjetit u përkeqësua më shumë, duke u zënë dhe bllokuar sistemi ekzistues dhe kanalet anësore të rrugëve urbane.

Në vitin 1997, në kuadër të projektit “*Ujësjellës kanalizime të qytetit*”, u bë studimi i fizibilitetit të sistemit të ujerave të shiut, nga pala austriake. Ky studim i jep zgjidhje ndërtimit të rrjetit të kanalizimeve të ujerave të bardha në rrugët e qytetit në mbështetje të planit rregullues. Skema përbehet nga 8 kanale kryesore që derdhen në liqenin e Shkodrës, në lumin Buna dhe në Kirë. Po kështu i jep zgjidhje edhe rrjetit të kanalizimeve në rrugët dytësore. Parashikohen të ndërtohen rreth 30 km kanale. Vlera totale e zbatimit kap shifrën rreth 10 milion Euro

#### **4. Furnizimi me Energji Elektrike**

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare është e vetmja kompani që ka aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes së energjisë elektrike tek konsumatorët.

Ka 11 HEC-e dhe 9 TEC-e me një fuqi prej 1,684 MW të instaluar për gjenerimin e energjisë elektrike Shkodra aktualisht furnizohet nëpërmjet katër nënstacioneve prej të cilëve dy janë 110/35/6 kV dhe dy të tjerë 35/6 kV të emërtuar Sh1, Sh2, Sh3, dhe Sh4 (Dobrac).

Nga të katër nënstacionet dalin 33 fidra 6 kV dhe 20 kV (ajror dhe kabllor) të cilët furnizojnë rreth 160 kabina transformacioni me tension hyrës 6 kV dhe 20 kV dhe tension në dalje (tensionin me të cilin furnizohen konsumatorët) 0.4 kV. Për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike nga ana e KESh-it, për qytetin e Shkodrës janë parashikuar këto investime:

- Investime në rrjetin 20 kV;
- Rikonstrukcion të kabinave transformacionit 20/0.4 kV;



- Ndërtim të kabinave të reja të transformacionit 20/0.4 kV;
- Rikonstruksion në rrjetin e TU;
- Instalimi i sistemit të matjes për të gjithë konsumatorët e qytetit.

<b>Investimet</b>	<b>Ekzistuese</b>	<b>Të planifikuara</b>
Rrjeti 20 kV (000 Lekë)	105,000	518,000
Gjatësia e rrjetit kabllor (km)	8.2	39
Kabinat e rikonstruara	25	66
Kabinat e reja	2	30
Rrjeti kabllor i tensionit të ulet (km)	3.5	39
Matësa (000 Lekë)	182,000	265,000
numri	18,000	26,000
Matësa në grup	112,000	230,000
numri	250	593

*Burimi: Drejtoria Rajonale e KESh*

Kufizimet e furnizimit me energji elektrike të qytetit janë në funksion të kuotave të planifikuara nga Divizioni i Shpërndarjes së KESh-it.

## **5. Telekomunikacioni**

Në fillim të vitit 1999, ka përfunduar centrali i ri telefonik me kapacitet 30,000 abonentë. Ky central administrohet nga Filiali i Telekomit Shqiptar, ndërmarrja publike shqiptare e linjës fikse të telekomunikacionit. Aktualisht numri i abonentëve është 9,600. Që prej vitit 2003, kompania ofron gjithashtu shërbimin internetit me dial-up. Për vitin 2005 është parashikuar një rritje e rrjetit urban prej 3,600 numrash si dhe është planifikuar të ofrohet shërbimi ADSL.

## **6. Infrastruktura rrugore**

Qyteti i Shkodrës ka burime të shkëlqyera për transportin me rrugët, hekurudhat dhe daljen në det dhe parashikohet të jetë hyrja veri–jug për trafikun ndërkombëtar, duke u përfshirë në një korridor paralel me bregdetin Adriatik–Jon.

Fatkeqësisht, rrjeti rrugor në qytet, aktualisht është në kushte shumë të vështira dhe me shpejtësi po shkon drejt një shkatërrimi të mëtejshëm. Faktorët që kanë shkaktuar këtë situatë janë mungesa e mirëmbajtjes, rritja e menjëhershme në volumin e trafikut dhe papërshtatshmëria e sistemit të kullimit të ujërave të rrjetit rrugor të qytetit. Për më tepër, në shumë pjesë të rrugëve të qytetit ka ndërhyrje (janë hapur kanale dhe nuk janë mbushur në mënyrën e duhur) dhe më pas janë riparuar me një shtresë të papërshtatshme asfalti, që pas një kohe të shkurtër pësojnë çarje.



Rrugët në qytetin e Shkodrës janë klasifikuar në tre kategori, si më poshtë:

*Rrugët parësore*

Këto janë rrugë kryesore me kapacitetit të lartë ose rrugë ekspresi urbane, që përballojnë një ngarkesë të trafikut në shkallë të mesme dhe të lartë, me funksionet si më poshtë:

- Lidhin qendrën e qytetit me zonat rurale përreth Shkodrës dhe qyteteve të tjera;
- Anashkalojnë qendrën e qytetit;
- Lidhin direkt vende të ndryshme institucionale, tregtare dhe kulturore të qytetit.

*Rrugët dytësore*

Këto janë rrugë urbane të kapacitetit të mesëm e të lartë, që kanë funksionet e mëposhtme:

- Mbledhin dhe shpërndajnë trafikun ndërmjet rrugëve parësore dhe atyre me kapacitet të ulët të rrjetit;
- Lidhin vende të rëndësishme të qytetit.

*Rrugët tretësore*

Këto janë rrugë me kapacitet të ulët të projektuara për lëvizje në zonat lokale brenda në qytet.

Aktualisht, rrjeti përbëhet si më poshtë:

Rrugë parësore, gjatësia totale, 13.8 km (22%);

Rrugë dytësore, gjatësia totale, 13.4 km (21%);

Rrugë tretësore, gjatësia totale, 35.8 km (57%).

Kështu, rrjeti rrugor i përgjithshëm përfshin 63 km të cilat zënë një sipërfaqe siç paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme.

Lloji	Gjatësia (m)	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Numri i rrugëve
Rruge të asfaltuara	30,708	271,470	57
Rruge të pa asfaltuara	32,312	191,175	73
Sheshe, rrugica		97,000	
<b>Totali</b>	<b>63,020</b>	<b>559,645</b>	<b>130</b>

*Burimi: Ndërmarrja e Rrugëve dhe Kanalizimeve në Bashkia*

Nga e gjithë sipërfaqja e rrugëve të asfaltuara, vetëm 30 për qind e tyre plotëson kërkesat e rrugëve të kategorisë së pare.

## VIII. Dokumentacioni përbërës i Planit Strategjik

Plani Strategjik përfshin dokumentet e mëposhtme:

- a. SWOT, analiza e konsoliduar
- b. Matricat e qëllimeve të Planit, objektivave, programeve dhe projekteve
- c. Matricat e zbatimit të Planit
- d. Matricat e prioritarizimit të projekteve
- e. Projekt fishat



a. SWOT, analiza e konsoliduar

	Të brendshëm	Të jashtëm
<b>Pozitive</b>	<p><b><u>Pika të forta</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Pozita gjeografike e Shkodrës (deti, liqeni, malet, rruga hekurudhore dhe rrugët lidhëse me ish Jugosllavinë)</li><li>2. Ekzistenca e burimeve të mëdha natyrore ujore</li><li>3. Ekzistenca e potencialit turistik dhe tradita e mikpritjes</li><li>4. Burime të favorshme për zhvillimin e agrobiznesit dhe turizmit</li><li>5. Traditat e punimit artizanal dhe tregtisë</li><li>6. Burime njerëzore të kualifikuara dhe kosto të ulëta pune</li><li>7. Popullsia me moshë mesatare të re</li><li>8. Prania e Universitetit “L. Gurakuqi”</li><li>9. Tradita në zhvillimin e arsimit, sportit dhe kulturës</li><li>10. Prania e qendrave profesionale të edukimit</li><li>11. Prania e institucioneve të kujdesit social dhe shëndetësor</li><li>12. Prania e një densiteti të forte social dhe familjar</li><li>13. Prania e një komuniteti të adaptueshëm dhe fleksibël</li></ol>	<p><b><u>Mundësitë</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Procesi i decentralizimit të qeverise</li><li>2. Përpilimi i strategjisë DELTA për ZhEV</li><li>3. Strategjitë kombëtare që mbështesin NVM</li><li>4. Liberalizimi i sistemit bankar; financimi i NVM-ve</li><li>5. Hapja e degëve lokale të bankave</li><li>6. Nisja e projekteve me organizata dhe fondacione të huaja (p.sh. BB, GTZ, SOROS, USAID, PNUD, REC, UNOPS, COOPERAZIONE ITALIANA, COOP, etj.)</li><li>7. Prania e projektit për ndërtimin e korridorit Veri–Jug përgjatë vijës bregdetare të Adriatikut dhe Jonit</li><li>8. Prania e investimeve të huaja për përmirësimin e sistemeve të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të zeza si dhe perspektiva e zgjerimit të tyre</li><li>9. Prania e projektit të Bankës Evropiane të Investimit për instalimin e linjave elektrike 20 kV</li><li>10. Implementimi i projektit për zgjerimin e rrjetit të linjave fikse telefonike (shtimi i 2,600 numrave telefonik në qytet)</li><li>11. Miratimi i legjislacionit për shërbimet sociale</li></ol>

	<b><u>Dobësitë</u></b>	<b><u>Kërcënimet</u></b>
<b>Negative</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mungesa klimës së përshtatshme për bizneset</li> <li>2. Mundësi të pakta punësimi</li> <li>3. Mospërputhja e kërkesës për kualifikimet profesionale dhe disponueshmëria e trajnimeve lokale</li> <li>4. Mungesa e zbatimit të legjislacionit të urbanistikës dhe akteve nënligjore të Këshillit të Rregullim Territorit</li> <li>5. Mungesa e një plani rregullues dhe projektet e përkatëse</li> <li>6. Keqadministrimi dhe mungesa e regjistrimit të pronës publike</li> <li>7. Mungesa e zyrës së kadastrës për mbajtjen në rregull të dokumentacionit.</li> <li>8. Ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e rrjetit ujësjellës kanalizime dhe të furnizimit me energji elektrike.</li> <li>9. Nivel i ulët në zbatimin dhe kontrollin e projekteve</li> <li>10. Mungesa e kontrollit të territorit nga administrata e bashkisë</li> <li>11. Ndërhyrje të paligjshme në rrjetet e furnizimit me ujë dhe energji elektrike</li> <li>12. Niveli i ulët i të ardhurave lokale</li> <li>13. Mungesa e transparencës</li> <li>14. Mungesa e regjistrimit civil dhe të dhënave statistikore të kompjuterizuara</li> <li>15. Frekuentim i ulët i institucioneve para shkollore dhe numër i madh i shkollave për arsimin e detyrueshëm</li> <li>16. Infrastrukturë e dobët dhe mbështetje financiare e pakët në kulturë, arsim, formim profesional dhe institucione sportive</li> <li>17. Mungesa e strategjisë për mbrojtjen e mjedisit</li> <li>18. Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndikimi negativ i politikave qendrore</li> <li>2. Mungesa e investimeve kapitale nga autoritetet qendrore</li> <li>3. Mungesa e sigurisë publike, ligjit dhe rendit</li> <li>4. Prania e tregtisë informale, evazioni fiskal dhe krijimi i monopoleve</li> <li>5. Dobësitë në legjislacionin fiskal</li> <li>6. Mungesa e stimuljeve për prodhuesit vendas</li> <li>7. Politika ekonomike jo të favorshme në nivel qendror</li> <li>8. Prania e korrupsionit</li> <li>9. Migrimet nga zonat rurale dhe rrjedhja e detyruar trurit si rezultat i emigracionit</li> <li>10. Hapa të ngadaltë të procesit të decentralizimit</li> <li>11. Ndikimi i faktorëve jo të qëndrueshëm ekonomikë (inflacioni, interesi i lartë i kredive, pengesat administrative, sistem i dobët i të drejtave të pronësisë)</li> <li>12. Strategjitë kombëtare jo të favorshme për strehimin</li> <li>13. Ndryshimet në regjimin e ujërave të liqenit dhe lumenjve Buna, Kir dhe Drin</li> <li>14. Mungesa e ofrimit të ndihmës sociale për të gjithë grupet në nevojë (fëmijë që nuk ndjekin shkollën, familje me probleme, etj.)</li> </ol>



**b. Matrica e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit**

<b>VIZIONI:</b>				
Qëllimet	Objektivat	Programet	Projektet	
			Nr	
<p><b>Qëllimi 1:</b> Shkodra me një ekonomi vendore tërheqëse dhe me një biznes dinamik ku nxitet dhe mbështetet zhvillimi i bizneseve prodhuese, të tregtisë dhe shërbimeve të cilat operojnë suksesshëm në tregun rajonal</p>	<p><b>Q1:O1:</b> Rritja me 20% e numrit të përgjithshëm të bizneseve që operojnë në Zonën Industriale deri në vitin 2008</p>	<p><b>Q1:O1:PG1:</b> Sigurimi cilësor i shërbimeve dhe infrastrukturës publike në Zonën Industriale në bashkëpunim me komunitetin e biznesit</p>	<p><b>Q1:O1:PG1:p1:</b> Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike në Zonën Industriale</p>	<b>1</b>
			<p><b>Q1:O1:PG1:p2:</b> Përmirësimi i ndriçimit rrugor në Zonën Industriale</p>	<b>2</b>
			<p><b>Q1:O1:PG1:p3:</b> Rehabilitimi i sistem kanalizimeve të ujërave sipërfaqësorë dhe të ujërave të zeza në Zonën Industriale</p>	<b>3</b>
			<p><b>Q1:O1:PG1:p4:</b> Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në Zonën Industriale</p>	<b>4</b>
			<p><b>Q1:O1:PG1:p5:</b> Instalimi i linjave të reja telefonike dhe rinovimi i rrjetit ekzistues në Zonën Industriale</p>	<b>5</b>
			<p><b>Q1:O1:PG1:p6:</b> Përmirësimi dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta në Zonën Industriale</p>	<b>6</b>
			<p><b>Q1:O1:PG2:p1:</b> Përpilimi i hartës së bizneseve që veprojnë në Zonën Industriale</p>	<b>7</b>
			<p><b>Q1:O1:PG2:p2:</b> Publikimi i materialeve promovionale për bizneset që veprojnë në Zonën Industriale</p>	<b>8</b>
			<p><b>Q1:O2:PG1:p1:</b> Ngritja e zyrës me “Një Ndalesë” (One-Stop-Shop) në Bashkinë e Shkodrës</p>	<b>9</b>
			<p><b>Q1:O2:PG1:p2:</b> Hartimi i profileve të bizneseve më të suksesshme të qytetit</p>	<b>10</b>
			<p><b>Q1:O2:PG1:p3:</b> Ngritja e një qendre për shërbimet ndaj biznesit</p>	<b>11</b>
			<p><b>Q1:O2:PG1:p4:</b> Anketimi dhe analiza e nevojave të NVM që veprojnë në qytet</p>	<b>12</b>
			<p><b>Q1:O2:PG1:p5:</b> Kryerja e studimit mbi sigurimin e fuqisë punëtore dhe të kurseve të trajnimit për biznesin</p>	<b>13</b>

Qëllimet	Objektivat	Programet	Projektet	Nr	
<b>Qëllimi 1:</b> Shkodra me një ekonomi vendore tërheqëse dhe me një biznes dinamik ku nxitet dhe mbështetet zhvillimi i bizneseve prodhuese, të tregtisë dhe shërbimeve të cilat operojnë suksesshëm në tregun rajonal	<b>Q1:O3:</b> Rritja nga 4 në 6 e aktiviteteve bashkëpunuese ndërkufitare deri në 2010	<b>Q1:O3:PG1:</b> Ngritja e strukturave për inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërkufitare	<b>Q1:O3:PG1:p1:</b> Ngritja e një bordi për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit të qyteteve ndërkufitare <b>Q1:O3:PG1:p2:</b> Përgatitja e një pakete informuese për investuesit e huaj në lidhje me potencialet e tregut dhe investuese në Shkodër <b>Q1:O3:PG1:p3:</b> Ngritja e qendrës rajonale të trajnimit të biznesit <b>Q1:O3:PG1:p4:</b> Ndërtimi i qendrës së panairëve të biznesit <b>Q1:O3:PG1:p5:</b> Ngritja e një sistemi për menaxhimin e integruar të ekosistemit të Liqenit të Shkodrës <b>Q1:O3:PG1:p6:</b> Vënia në punë e shërbimit të transportit liqenor Shkodër–Virpazar, Mal i Zi	<b>14</b>  <b>15</b>  <b>16</b>  <b>17</b>  <b>18</b>  <b>19</b>	
	<b>Q1:O4:</b> Rritja nga 7 në 10 e numrit të tregjeve publike ushqimore që operojnë në qytet deri në vitin 2010	<b>Q1:O4:PG1:</b> Forcimi i sistemit të tregjeve publike ekzistuese shitjes me shumicë dhe pakicë	<b>Q1:O4:PG1:p1:</b> Ndërtimi i tregut të shitjes me shumicë të fruta perimeve	<b>Q1:O4:PG1:p2:</b> Ndërtimi në qytet i tregjeve të reja për shitjen me pakicë të frutave, perimeve, peshkut dhe mishit <b>Q1:O5:PG1:p1:</b> Zhvillimi i strategjisë të turizmit për qytetin e Shkodrës <b>Q1:O5:PG1:p2:</b> Hapja pranë bashkisë së Shkodrës e Zyrës për Mbështetjen e Turizmit <b>Q1:O5:PG1:p3:</b> Krijimi i një rrjeti hotelesh dhe restorantesh në qytet që të përmirësohen standardet e tyre dhe të bëjnë të larmishëm shërbimet e tyre <b>Q1:O5:PG1:p4:</b> Hapja e një qendre tregtare të artizanatit <b>Q1:O5:PG1:p5:</b> Organizimi periodik i trajnimeve për ngritje kapacitetesh të agjensive turistike dhe bizneseve <b>Q1:O5:PG1:p6:</b> Nxitja e turizmit familjar dhe agro-turizmit në Shirokë dhe Zogaj <b>Q1:O5:PG1:p7:</b> Hartimi i strategjisë së marketingut të turizmit në qytetin e Shkodrës <b>Q1:O5:PG1:p8:</b> Prodhim i broshurës informative për ambientet çlodhëse e argëtuese, dhe shërbimet duke përfshirë hotelet, shërbimet e transportit, restorantet, etj. <b>Q1:O5:PG1:p9:</b> Botimi i revistës periodike “Turizmi në Shkodër”	<b>20</b>  <b>21</b>  <b>22</b>  <b>23</b>  <b>24</b>  <b>25</b>  <b>26</b>  <b>27</b>  <b>28</b>  <b>29</b>  <b>30</b>
	<b>Q1:O5:</b> Rritja e numrit vjetor të vizitorëve në qytet nga 10,000 në 25,000 deri në vitin 2008	<b>Q1:O5:PG1:</b> Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së turizmit			



Qëllimet	Objektivat	Programet	Projektet	Nr
<p><b>Qëllimi 2:</b>  <b>Ruajtja dhe zhvillimi i traditës kulturore, artistike dhe historike të Shkodrës dhe promovimi i këtyre vlerave në funksion të zhvillimit të turizmit</b></p>	<p><b>Q2:O1:</b>  Rritja nga 50/vit në 70/vit e numrit të aktiviteteve kulturore dhe artistike të kryera në Shkodër deri në vitin 2010</p>	<p><b>Q2:O1:PG1:</b>  Miradministrimi dhe ekspozimi i trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës</p>	<p><b>Q2:O1:PG1:p1:</b> Ruajtja, restaurimi dhe zhvillimi i muzeut të qytetit dhe koleksionit të tij, si dhe i elementëve të tjerë historike kulturore në qytet</p>	31
			<p><b>Q2:O1:PG1:p2:</b> Ngritja e sistemit për identifikimin, vlerësimin dhe blerjen e objekteve muzeale</p>	32
			<p><b>Q2:O1:PG1:p3:</b> Rehabilitimi dhe ekspozimi periodik i arkivit të sektorit historik të muzeut</p>	33
			<p><b>Q2:O1:PG1:p4:</b> Hapja e ekspozitës periodike numizmatike “Qarkullimi monetar në rajonin e Shkodrës”</p>	34
			<p><b>Q2:O1:PG1:p5:</b> Zgjerimi i eksponateve të Muzeut Arkeologjik</p>	35
			<p><b>Q2:O1:PG1:p6:</b> Përmirësimi i mjedisve të punës në Teatrin “Migjeni”</p>	36
			<p><b>Q2:O1:PG1:p7:</b> Rehabilitimi i qendrës kulturore të qytetit</p>	37
			<p><b>Q2:O1:PG1:p8:</b> Promovimi i koleksionit fotografik të Muzeut “Marubi”</p>	38
			<p><b>Q2:O1:PG1:p9:</b> Restaurimi i shtëpive tradicionale në qytet</p>	39
			<p><b>Q2:O1:PG2:p1:</b> Ngritja e Komisionit për Artin dhe Kulturën</p>	40
			<p><b>Q2:O1:PG2:p2:</b> Krijimi i filharmonisë së qytetit</p>	41
			<p><b>Q2:O1:PG2:p3:</b> Zhvillimi i festës “Dita e Verës” në Shkodër</p>	42
			<p><b>Q2:O1:PG2:p4:</b> Festa e Karnavaleve në Shkodër</p>	43
			<p><b>Q2:O1:PG2:p5:</b> Organizimi vjetor i festivalit “Kënga qytetare Shkodrane” të traditës</p>	44
			<p><b>Q2:O1:PG2:p6:</b> Hartimi dhe botimi i materialeve promociionale lidhur me trashëgiminë kulturore të qytetit</p>	45
			<p><b>Q2:O1:PG2:p7:</b> Përgatitja dhe botimi i kalendarit të aktiviteteve kulturore vjetore që do të mbahen në Shkodër</p>	46



Qëllimet	Objektivat	Programet	Projektet	Nr
<b>Qëllimi 3:</b> <b>Qyteti një qendër</b> <b>arsimor e nivelit të lartë</b> <b>për të gjithë Shqipërinë e</b> <b>Veriut, me Universitetin</b> <b>si faktor i kyç për rritjen</b> <b>dhe përmirësimin e</b> <b>nivelit arsimor dhe</b> <b>profesional</b>	<b>Q3:O1:</b> Rritja nga 4,500 në 7,500 e numrit të të diplomuarve nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” deri në vitin 2012, duke përmirësuar në mënyrë cilësore mjediset dhe standarde mësimdhënëse të universitetit	<b>Q3:O1:PG1:</b> Përmirësimi i infrastrukturës për akomodimin, mësimdhënien dhe shërbimet e tjera për studentët në universitet	<b>Q3:O1:PG1:p1:</b> Rehabilitimi i mjediseve ekzistuese dhe ndërtimi i mjediseve të reja për mësimdhënie në universitetin “Luigj Gurakuqi”	47
			<b>Q3:O1:PG1:p2:</b> Ndërtimi i kampusit studentor në universitetin “Luigj Gurakuqi”	48
			<b>Q3:O1:PG1:p3:</b> Ndërtimi i bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi”	49
			<b>Q3:O1:PG2:p1:</b> Krijimi i Akademisë së Arteve pranë universitetit “Luigj Gurakuqi”	50
			<b>Q3:O1:PG2:p2:</b> Ngrija e kurikulës për degën e Turizmit në Fakultetin Ekonomik, Fakultetin Juridik dhe trajnimi i administratës publike në Universitetin “Luigj Gurakuqi”	51
			<b>Q3:O1:PG2:p3:</b> Zbatimi i projektit të edukimit në distancë në universitetin “Luigj Gurakuqi”	52
			<b>Q3:O1:PG3:p1:</b> Hartimi dhe zbatimi i një programi shkëmbimesh për njohuritë shkencore dhe teknike mes universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe universiteteve të rajonit dhe më gjerë	53
			<b>Q3:O1:PG3:p2:</b> Krijimi i një sistemi fondesh pranë universitetit “Luigj Gurakuqi” që të mbështetë dhe të rritë kapacitetet kërkimore dhe të sigurojë transferimin e njohurive në fushën e zhvillimit ekonomik rajonal	54
			<b>Q3:O1:PG3:p3:</b> Rekrutimi dhe zhvillimi i personelit të kualifikuar akademik të universitetit “Luigj Gurakuqi” në nivele që ofrojnë mësimdhënie cilësore dhe në përputhje me standartet e Deklaratës së Bolonjës	55
			<b>Q3:O2:PG1:p1:</b> Rehabilitimi i shkollës së mesme “Preng Jakova”	56
			<b>Q3:O2:PG1:p2:</b> Rehabilitimi i shkollës 9-vjeçare “Skënderbeg”	57
			<b>Q3:O2:PG1:p3:</b> Rehabilitimi i Kopshit “Guerrile”	58



Qëllimet	Objektivat	Programet	Projektet	Nr
<p><b>Qëllimi 4:</b> Një qytet me një infrastrukturë dhe shërbime publike cilësore dhe të standardeve bashkëkohore që nxisin dhe mbështesin zhvillimin e ekonomisë vendore dhe që janë në harmoni me zhvillimet e qëndrueshme dhe ambientin</p>	<p><b>Q4:O1:</b> Zhvillimi i mjeteve ligjore dhe teknike të nevojshme për planifikimin urban dhe menaxhimin cilësor të territorit të qytetit deri në vitin 2010</p>	<p><b>Q4:O1:PG1:</b> Përmirësimi dhe rritja e instrumenteve planifikues për zhvillimin dhe menaxhimin urban të qytetit</p>	<p><b>Q4:O1:PG1:pl:</b> Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë</p> <p><b>Q4:O1:PG1:p2:</b> Zhvillimi i planit të pjesëshëm urban për zonën Shirokë–Zogaj</p> <p><b>Q4:O1:PG1:p3:</b> Zhvillimi planeve të pjesëshme urbane për zonat Mark Lulaj, Hardhijat e Egra dhe Zooteknikë</p> <p><b>Q4:O1:PG1:p4:</b> Hartimi i planit të veprimit për detajimin e Planit Rregullues të Qytetit</p>	<p><b>59</b></p>
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rritja e kapacitetit të transportit të biznesit Krijimi i një mjedisi të shëndoshë për zhvillimin e bizneseve të reja Përmirësimi i transportit të qytetit	<b>Grupet e synuara</b> Bizneset e mëdha që operojnë jashtë ZI Komunitetet informale që jetojnë në ZI Gjithë trafiku hyrës ose dalës i qytetit nga veriu	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Bizneset vendase MTRrT PNUD Drejtoria Rajonale e Policisë	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Bizneset vendase Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit PNUD	
<b>Para kushtet</b> Zhvillimi i projekteve teknike	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e financimit	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> Rruga ZI1 Rruga ZI2 Rruge lidhëse ZI1 me ZI2 <b>Totali</b>	 137,835,477 Lekë 137,835,477 Lekë 27,567,095 Lekë <b>303,238,049 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Dy vjet	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	

<b>Nr 5</b>	<b>Projekti Q1:O1:PG1:p5:</b> Instalimi i linjave të reja telefonike dhe rinovimi i rrjetit ekzistues në Zonën Industriale	<b>Tipi i programit Q1:O1:PG1:</b> Sigurimi cilësor i shërbimeve dhe infrastrukturës publike në Zonën Industriale në bashkëpunim me komunitetin e biznesit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Rritja e parashikueshme në aktivitetin e biznesit vendas, veçanërisht në Zonën Industriale bën të domosdoshëm përmirësimet e infrastrukturës së linjës telefonike të kësaj zonë. Ky projekt do të bëjë të mundur që ZI të pajiset me një sistem telefonik modern tërësisht funksional.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Sigurimi i lehtësirave të shërbimit dhe aktiviteti normal për bizneset e vendosura ose që do vendosen në ZI Dyfishimi i numrave telefonike nga 150 në 300		<b>Grupet e synuara</b> Bizneset e ZI Komuniteti i zonës
<b>Aktorët e mundshëm</b> Albtelekom		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Albtelekom, dega Shkodër
<b>Para kushtet</b> Disponueshmëria e projektit teknik Disponueshmëria e aparaturave dhe pajisjeve të tjera		<b>Faktorë rrezikues</b> Vonesa në procesin e privatizimit
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>30,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Drejtori i Albtelekomit, Dega Shkodër		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit



<b>Nr 6</b>	<b>Projekti Q1:O1:PG1:p6:</b> Përmirësimi dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta në Zonën Industriale	<b>Tipi i programit Q1:O1:PG1:</b> Sigurimi cilësor i shërbimeve dhe infrastrukturës publike në Zonën Industriale në bashkëpunim me komunitetin e biznesit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Lulishtja e Zonës Industriale aktualisht është e dëmtuar dhe e zhveshur nga gjelbërimi. Projekti ka të beje me përmirësimin e gjendjes aktuale për ta bere atë më të gjallëruar dhe më rekreative për punonjësit dhe banoret e zonës. Aktualisht zona përfshin një sipërfaqe prej 3,150 m <sup>2</sup> . Projekti i rehabilitimit përfshin mbjelljen e drurëve dekorative (gështenjë cope 226), rimbjellje bari 2,100 m <sup>2</sup> , mbjellje gardhe të gjelbërta 200 m, si dhe ndërtime bordure betoni 110 m.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i hapësirave argëtuese të ZI Reduktimi i ndotjeve të mjedisit të zonës		<b>Grupet e synuara</b> Komuniteti i Zonës Industriale Qeveria vendore
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveria vendore Komuniteti Donatorët		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Komuniteti
<b>Para kushtet</b> Miratimi i Këshillit Bashkiak për hapësirat e gjelbërta të ZI si investim parësor Identifikimi i donatorëve Interesi i qeverisë vendore dhe komunitetit në mbështetjen e projektit		<b>Faktorë rrezikues</b> Buxheti i kufizuar
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>		<b>2,100,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit

<b>Nr 7</b>	<b>Projekti Q1:O1:PG2:p1:</b> Përpilimi i hartës së bizneseve që veprojnë në Zonën Industriale	<b>Tipi i programit Q1:O1:PG2:</b> Promovimi e Zonës Industriale
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Lehtësia e marrjes dhe shkëmbimit të informacionit është një kërkesë paraprake për zhvillimin e ekonomik. Në rastin e këtij projekti identifikimi dhe gjetja e bizneseve nga publiku dhe bizneset e tjera do të jetë një zhvillim i rëndësishëm për ZhEV në Shkodër. Për këtë është parashikuar që do të jetë në dispozicion informacioni i mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i bazës së plotë të të dhënave për bizneset që veprojnë në ZI;</li> <li>Identifikimi i adresave të bizneseve;</li> <li>Përgatitja e një harte që tregon vendndodhjen e bizneseve;</li> <li>Përshkrimi i kapaciteteve akomoduese (toka të lira të disponueshme për ndërtime) të shfrytëzuara dhe të pashfrytëzuara;</li> <li>Publikimi i hartës.</li> </ul>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Informacion i dobishëm rreth bizneseve që veprojnë në territorin e bashkisë Udhëzues në dobi të investuesve aktualë dhe potencialë</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Bizneset Bashkia</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Qendra për Zhvillim Ekonomik Bizneset Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Bashkia Qarku i Shkodrës</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Qendra për Zhvillim Ekonomik Bizneset Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Bashkia Qarku i Shkodrës Studentet e Fakultetit Ekonomik Donatorët</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Disponueshmëria e informacionit ekzistues nga bashkia, Dhoma e Tregtisë dhe Dega e Tatim Taksave Informacion mbi pronësinë i disponueshëm në zyrat e regjistrimit të pasurive në Shkodër</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Mungese e burimeve financiare për mobilizimin e burimeve njerëzore</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>1,000,000 Lekë</b></span></p>		
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Nexhat Grezda, Drejtor i Sektorit të të Ardhurave</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Një vit</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Një vit (duhet të pasqyrohet çdo vit)</p>



<b>Nr 8</b>	<b>Projekti Q1:O1:PG2:p2:</b> Publikimi i materialeve promovionale për bizneset që veprojnë në Zonën Industriale	<b>Tipi i programit Q1:O1:PG2:</b> Promovimi e Zonës Industriale
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Grumbullimi i informacioneve rreth bizneseve për: formën e biznesit; kohen e zhvillimit të aktivitetit; produktet që ofrojnë; tregjet aktuale dhe të synuara; kapacitetet e përfshira në biznes; niveli teknologjik, etj. Fotografimi i aneve të ndryshme të aktivitetit të biznesit, ndërtesa, produkte, etj. Sistemimi dhe hedhja e materialeve në forma guide promovionale të përcaktuara. Publikimi i tyre. Paraqitja dhe promovimi në një ekspozite të bizneseve kombëtare dhe ndër-rajonale.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i marketingut të bizneseve Zgjerimi i numrit të produkteve dhe tregjeve	<b>Grupet e synuara</b> Bizneset	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qendra e Zhvillimit Ekonomik Bizneset Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Bashkia Qarku i Shkodrës	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Qendra e Zhvillimit Ekonomik Bizneset Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Bashkia Qarku i Shkodrës Studentët e Fakultetit Ekonomik Donatorët	
<b>Para kushtet</b> Të dhënat ekzistuese, harta e bizneseve, informacionet e reja nga zyrat përkatëse	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e burimeve financiare Tregje informale, biznese të paregjistruar	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>	<b>400,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Ridvan Sokoli, Drejtori i Sektorit të Planifikimit, Koordinimit dhe Informimit Publik		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas një vit	



<b>Nr 9</b>	<b>Projekti Q1:O2:PG1:p1:</b> Ngrija e zyrës me “Një Ndalesë” (One–Stop–Shop) në Bashkinë e Shkodrës	<b>Tipi i programit Q1:O2:PG1:</b> Hartimi dhe krijimi i sistemeve, aktiviteteve dhe materialeve promocionale për nxitjen e krijimit të NVM të reja
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për biznes me anë të hapjes së një zyre në bashkinë e Shkodrës që do të jetë një pikë reference për sipërmarrësit. Zyra do të ketë si detyrë të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi procedurat administrative që kanë të bëjnë me bizneset. Nëpërmjet kësaj zyre sipërmarrësit dhe sipërmarrëset do të jenë në gjendje që, në të njëjtin vend, të bëj kërkesën për licencën dhe të ketë në dispozicion të gjithë informacionin që nevojitet në lidhje me taksat dhe tarifatat, infrastrukturën, stimulues për investime dhe vende për vendosjen e biznesit të tyre, etj.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Thjeshtimi i proceseve administrative Disponueshmëria e procedurave të biznesit në një vend të vetëm Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve Rritja e transparencës Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve Reduktim i burokracisë Reduktimi i korrupsionit		<b>Grupet e synuara</b> Komuniteti Bizneset Bashkia
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Donatorë të mundshëm
<b>Para kushtet</b> Miratimi nga këshilli bashkiak i qytetit i programit për reduktimin e pengesave administrative për bizneset dhe qytetarët		<b>Faktorë rrezikues</b> Asnjë
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>2,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Ridvan Sokoli, Drejtor i Sektorit të Planifikimit, Koordinimit dhe Informimit të Publikut		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit



<b>Nr 10</b>	<b>Projekti Q1:O2:PG1:p2:</b> Hartimi i profileve të bizneseve më të suksesshme të qytetit	<b>Tipi i programit Q1:O2:PG1:</b> Hartimi dhe krijimi i sistemeve, aktiviteteve dhe materialeve promocionale për nxitjen e krijimit të NVM të reja
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Qëllimi i projektit është prezantimi tek bizneset e tjera i eksperiencave pozitive të bizneseve tashmë funksionuese me anë të analizimit të sfidave, vështirësive dhe përmbushjeve. Botimi do të jetë një përmbledhje e intervistave me drejtues dhe institucionet që i kanë mbështetur, dhe do të ilustron me fotografi, grafikë dhe analiza.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i praktikave të biznesit vendas Nxitja e bizneseve të reja Përmirësimi i imazhit të biznesit në Shkodër		<b>Grupet e synuara</b> Bizneset Publiku
<b>Aktorët e mundshëm</b> Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë TEULEDA Qeveria vendore		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë TEULEDA Qeveria vendore
<b>Para kushtet</b> Disponueshmëria e informacionit të biznesit Dëshira bizneseve të suksesshme për të ndihmuar në përgatitjen e një prezantimi më të mirë të mundshëm		<b>Faktorë rrezikues</b> Buxhet i papërshtatshëm Firmat mund të kundërshtojnë publikimin e rezultateve të tyre
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>500,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Anton Leka, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Shkodër Tel: 00355 224 2460; cel: 00355 69 2072150		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2005–2006		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas një vit

<b>Nr 11</b>	<b>Projekti Q1:O2:PG1:p3:</b> Ngritja e një qendre për shërbimet ndaj biznesit	<b>Tipi i programit Q1:O2:PG1:</b> Hartimi dhe krijimi i sistemeve, aktiviteteve dhe materialeve promocionale për nxitjen e krijimit të NVM të reja
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<p>Stafi i Bashkisë në përgatitjen e projekteve të ndryshme për zhvillimin ekonomik vendor, bashkëpunon me përfaqësues të grupeve të ndryshme të komunitetit. Procesi i aplikimit dhe i monitorimit të tyre është po aq i rëndësishëm sa edhe sa edhe ai i përcaktimit të problemit dhe i hartimit të projektit. Shume prej projekt-ideve janë të gjera dhe përfshijnë interesa të ndryshme të komunitetit, institucioneve, organizatave, biznesit etj. Në raste të veçanta bën lidhjen mes partnereve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për biznes, si dhe ofron lehtësira në emër të pushtetit vendor.</p> <p>Bashkëpunimet midis Bashkisë, biznesit dhe institucioneve të tjera, mendojmë se do të ishin me sukses. Kjo qendër do të identifikojë problemet e ndryshme, koordinimin e punës se të gjithë aktoreve për të përcaktuar projekt-idetë dhe më pas do të hartojë projekt-propozimet për të aplikuar më pas tek donatorët e mundshëm për sigurimin e fondeve të nevojshme duke monitoruar implementimin e projekteve.</p> <p>Do të behet një qendër edhe për studime të ndryshme të cilat u paraprijnë hartimit të strategjive, apo planeve të veçanta, projekteve konkrete etj. Ngritja e kësaj qendre do të ndihmojë gjithashtu në konkretizimin e një bashkëpunimi të pushtetit lokal, biznesit dhe komunitetit në interes të të gjithëve.</p>		
<b>Rezultatet e pritshme</b>	Identifikimi i nevojave reale të zhvillimit ekonomik Hartimi i projekt-propozimeve në mënyrë profesionale Gjetja e mbështetjes financiare për zbatim Sigurimi i lidhjeve me partnerë potencialë ndërkombëtarë	<b>Grupet e synuara</b> Biznesi Komuniteti Institucionet vendore
<b>Aktorët e mundshëm</b>	Qeveria vendore Biznesi vendas Institucionet shtetërore Donatorët Ekspertët	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Qeveria vendore Biznesi vendas Donatorë
<b>Para kushtet</b>	Interesi i pushtetit lokal, biznesit dhe institucioneve Miratimi nga këshilli bashkiak Identifikimi i palëve të interesuara Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë vendore, bizneseve dhe institucioneve	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare Mungesa e interesit të aktorëve përkatës për të bashkëpunuar
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>	Kostoja fillestare (e fillimit) Kostoja operacionale <b>Totali</b>	1,875,000 Lekë 3,750,000 Lekë në vit <b>5,625,000 Lekë (viti i parë)</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b>		
Anton Leka, Kryetar i Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Shkodër		
<b>Periudha e zbatimit</b>	2005	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> 2005 në vazhdim



<b>Nr 12</b>	<b>Projekti Q1:O2:PG1:p4:</b> Anketimi dhe analiza e nevojave të NVM që veprojnë në qytet	<b>Tipi i programit Q1:O2:PG1:</b> Hartimi dhe krijimi i sistemeve, aktiviteteve dhe materialeve promovionale për nxitjen e krijimit të NVM të reja
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Synimi i këtij projekti është të rritë sensibilizimin mes komunitetit, por veçanërisht në bashki, institucionet e qytetit dhe vetë bizneseve, mbi problemet reale me të cilat përballet komuniteti i biznesit në Shkodër. Duke vepruar kështu, komuniteti do të përfshihet në programet e bashkisë që synojnë të zgjidhin këto probleme në një proces të vazhdueshëm. Si fillim, ky projekt do të ndërmarrë një studim për të identifikuar problemet e ndryshme të bizneseve dhe këndvështrimet e ndryshme mbi zhvillimin e ardhshëm të qytetit.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rritja e sensibilizimit dhe zgjidhja e problemeve të biznesit Përcaktimi i mundësive për zhvillim		<b>Grupet e synuara</b> Biznesi i qytetit Bashkia
<b>Aktorët e mundshëm</b> Komuniteti i biznesit Bashkia Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë TEULEDA		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia
<b>Para kushtet</b> Hartimi i Strategjisë për ZhEV		<b>Faktorë rrezikues</b> Asnjë
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>150,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Anton Leka, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Shkodër		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2005		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas një vit

<b>Nr 13</b>	<b>Projekti Q1:O2:PG1:p5:</b> Kryerja e studimit mbi sigurimin e fuqisë punëtore dhe të kurseve të trajnimit për biznesin	<b>Tipi i programit Q1:O2:PG1:</b> Hartimi dhe krijimi i sistemeve, aktiviteteve dhe materialeve promovionale për nxitjen e krijimit të NVM të reja
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Qëllimi i këtij projekti është rritja e cilësisë profesionale të fuqisë punëtore sipas kërkesës së tregut të punës. Objektivat specifike të projektit janë evidentimi i kërkesës së biznesit të qytetit për fuqi punëtore të kualifikuar sipas profileve. Organizimi i moduleve të trainimit sipas analizës së kërkesës së biznesit për fuqi punëtore. Aktivitetet e parashikuara: Anketim i biznesit të qytetit në lidhje me kërkesën e tyre për fuqi punëtore të kualifikuar sipas profileve; Hartimi i moduleve të trainimit; Zhvillimi i moduleve të trainimit.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Forcë pune e kualifikuar Kënaqja e nevojave të biznesit me forcë pune Rritja e punësimit		<b>Grupet e synuara</b> Bizneset Të papunët Punonjësit
<b>Aktorët e mundshëm</b> Shkollat e mesme profesionale të qytetit Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Drejtoria Rajonale e Punësimit TEULEDA		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Drejtoria Rajonale e Punësimit
<b>Para kushtet</b> Ekspertë të fushave të ndryshme Ekzistenca e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, TEULEDA, Universiteti		<b>Faktorë rrezikues</b> Të pa identifikuar
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>500,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Anton Leka, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Shkodër		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2005–2006		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Sipas nevojave



<b>Nr 14</b>	<b>Projekti Q1:O3:PG1:p1:</b> Ngritja e një bordi për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit të qyteteve ndërkufitare	<b>Tipi i programit Q1:O3:PG1:</b> Ngritja e strukturave për inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërkufitare
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Krahas hartimit të Strategjive dhe programeve të ndryshme në nivel kombëtar dhe lokal për zhvillim të komuniteteve tona një mekanizëm shume i rëndësishëm në këtë drejtim është dhe bashkëpunimi rajonal me vendet kufitare. Ekzistojnë disa marrëdhënie ndërkufitare si në nivelin kombëtar ashtu dhe në nivelin lokal, të cilat shërbejnë si baze për intensifikimin e këtyre marrëdhënieve në mes të qyteteve kufitare të Shqipërisë së veriut me qytetet kufitare të Malit të Zi dhe Kosovës. Programet dhe strategjitë e zhvillimit me vendet kufitare janë bere mekanizma shume popullor për drejtimin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale në rajonet kufitare në të gjithë Evropën. Institucionalizimi i këtyre marrëdhënieve sipas standarteve dhe parametrave të Bashkimit Evropian do të shërbeje si një mjet shume i rëndësishëm për të përmirësuar qëndrimin e periferik dhe të margjinalizuar të qyteteve tona kufitare në më kompetitive duke rritur bashkëpunimin në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe në hartimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta në drejtim të rritjes së ekonomisë të qyteteve tona respektive. Aktivitetet e parashikuara: Kryetaret e Bashkive Shkodër, Ulqin dhe Ferizaj do të marrin kontakt me bashkitë e qyteteve të vendeve përkatëse për sensibilizimin e tyre për të qene pjese e këtij projekti. GTZ të siguroje asistence teknike për këtë bashkëpunim që lidhet me aspektet juridike dhe modele projektesh ndër kufitare Hartimi i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Aktivitete të ndryshme të organizuara në Shkodër me Komunat e Ulqinit, Tivarit, Podgoricës, Ferizajt, Gjakovës, etj. Zhvillimi ekonomik i qyteteve, qytezave dhe fshatrave kufitare Përmirësimi i marrëdhënieve ndërkufitare	<b>Grupet e synuara</b> Qytetet dhe fshatrat ndërkufitare të rajonit Bashkia	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkitë e Shkodrës, Ulqinit dhe Ferizajt Komunat kufitare GTZ	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> GTZ	
<b>Para kushtet</b> Marrëveshjet ndërkufitare midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës Mbështetja e qeverive për projektin Interesi i bashkive të tjera ndërkufitare Takimi i kryetarëve të bashkive përkatëse	<b>Faktorë rrezikues</b> Marrëdhëniet politike midis tre vendeve	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b> <b>200,000 Lekë</b>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Znj. Zemaida Kastrati, Eksperte në Marrëdhëniet me Jashtë		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2005–2006	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas një vit	

<b>Nr 15</b>	<b>Projekti Q1:O3:PG1:p2:</b> Përgatitja e një pakete informuese për investuesit e huaj në lidhje me potencialet e tregtuese dhe investuese në Shkodër	<b>Tipi i programit Q1:O3:PG1:</b> Ngritja e strukturave për inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërkufitare
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Projekti konsiston në përgatitjen e një paketë informuese për tërheqjet që ofron treva e Shkodrës për të nisur këtu biznese dhe për të tërhequr investues të huaj.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Krijimi i një imazhi të ri për rajonin Ndërtimi i një sistemi komunikimi të hapur për sipërmarrësit, institucionet lokale dhe partnerët potencialë Konsolidimi i bashkëpunimit ndërmjet kundrapalëve rajonalë dhe ndërkombëtarë		<b>Grupet e synuara</b> Industrialistë, shoqata, dhoma të tregtisë, institucione ndërkombëtare të ndryshme etj., të interesuara për të investuar në Shqipëri
<b>Aktorët e mundshëm</b> TEULEDA Bashkia Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë BBSH		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Bashkia
<b>Para kushtet</b> Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e shpërblimeve për bizneset e reja
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
Postera		400,000 Lekë
Broshura informuese		700,000 Lekë
CD promocionalë		200,000 Lekë
Kartolina promocionale		100,000 Lekë
Fletëpalosje		200,000 Lekë
<b>Totali</b>		<b>1,600,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Ridvan Troshani, Drejtor i Agjencisë TEULEDA		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2005		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> 2006 dhe në vazhdim



<b>Nr 16</b>	<b>Projekti Q1:O3:PG1:p3:</b> Ngritja e qendrës rajonale të trajnimit të biznesit	<b>Tipi i programit Q1:O3:PG1:</b> Ngritja e strukturave për inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërkufitare
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Ky projekt synon ndërtimin e një qendre trajnimi për menaxherët e bizneseve që veprojnë në Shkodër. Duke u trajnuar sipas nevojave specifike në fushat e veçanta menaxherët do të jenë në gjendje të merren më profesionalisht me aktivitetin e tyre në mënyrë që bizneset e tyre të bëhen më konkurruese në treg dhe më të përgatitura për t'u përballur me sfidat gjithnjë në rritje rajonale dhe globale.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Performancë më e mirë e biznesit Mbulimi i nevojave të biznesit për trajnim dhe konsultim Përmirësimi i shërbimeve të informimit publik	<b>Grupet e synuara</b> Bizneset vendase dhe rajonale të veriut të Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi Institucionet dhe organizatat publike Publiku	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë të rajonit Organizatrat vendase dhe ndërkombëtare të biznesit Qeveritë vendore dhe qendrore	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë së rajonit Bashkia Ministria e Ekonomisë Donatorët	
<b>Para kushtet</b> Tendencat drejt integritimit rajonal Rritja e vazhdueshme e konkurrencës si rezultat i hapjes gjithnjë e më të madhe të ekonomisë shqiptare	<b>Faktorë rrezikues</b> Buxheti i vogël krahasuar me vlerën e kërkuar për investim Interesim i pakët i aktorëve	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> Kosto e ndërtimit Mobilimi dhe pajisje të tjera zyre Kosto fillestare (e fillimit) <b>Totali</b>	75,000,000 Lekë 12,500,000 Lekë 1,250,000 Lekë <b>88,750,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Anton Leka, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Shkodër		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2005–2007	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas dy vjetësh	



<b>Nr 17</b>	<b>Projekti Q1:O3:PG1:p4:</b> Ndërtimi i qendrës së panairëve të biznesit	<b>Tipi i programit Q1:O3:PG1:</b> Ngritja e strukturave për inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërkufitare
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Ndërtimi i një qendre panairesh e cila të promovojë bizneset lokale dhe të shërbejë si promotore e biznesit në rajonin e Shkodrës. Qendra do të ofrojë mundësi të reja biznesi dhe shërbimi për shume organizatore të panairëve, do të jete një burim i rëndësishëm të ardhurash dhe punësimi gjithashtu një qendër e rëndësishme marketingu.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rritja e numrit të ngjarjeve promovuese të biznesit Përmirësim i imazhit të biznesit në Shkodër Ofrimi i shërbimeve profesionale për bizneset		<b>Grupet e synuara</b> Bizneset rajonale Publiku
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveritë vendore dhe qendrore Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë së rajonit Organizatat vendase dhe ndërkombëtare të biznesit		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë së rajonit Bashkia Ministria e Ekonomisë Donatorët
<b>Para kushtet</b> Angazhim i përbashkët i aktorëve lokalë Disponueshmëria e truallit shtetëror të lirë Përmirësimi i tokës dhe shërbimeve		<b>Faktorë rrezikues</b> Buxheti i vogël Interesim i ulët nga organizatat dhe institucionet
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
Përmirësim i sipërfaqes, kanalizime; asfaltimi i rrugëve		50,000,000 Lekë
Energjia, ujë, lidhjet telefonike		7,500,000 Lekë
Ndërtimi i godinave		27,500,000 Lekë
<b>Totali</b>		<b>85,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Anton Leka, Kryetar i Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Shkodra		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2006–2008		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas dy vjetësh



<b>Nr 18</b>	<b>Projekti Q1:O3:PG1:p5:</b> Ngritja e një sistemi për menaxhimin e integruar të ekosistemit të Liqenit të Shkodrës	<b>Tipi i programit Q1:O3:PG1:</b> Ngritja e strukturave për inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërkufitare
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> <b>Objektivi i përgjithshëm</b> do të jete për të asistuar shtetet e Shqipërisë dhe të Malit të Zi për të arritur një përdorim më të qëndrueshëm të burimeve natyrore të liqenit të Shkodrës dhe ujembledhesit të tij. <b>Objektivi global mjedisor</b> i projektit është reduktimi i ndotjeve dhe konservimi i liqenit dhe i biodiversitetit të tij si një habitat natyror me rëndësi ndërkombëtare për specie të ndryshme të faunës dhe florës. Produktet dhe aktivitetet e projektit: <b>A)</b> Kuadri i menaxhimit ndërkufitar i liqenit të Shkodrës. Kjo komponente do të përmbaje kuadrin ligjor dhe institucional për menaxhimin e përbashkët të liqenit të Shkodrës. <b>B)</b> Promovimi i menaxhimit të integruar të burimeve natyrore dhe konservimi i biodiversitetit. Kjo komponente do të prezantoje grante të vogla konkurruese që do të financoje demonstrimet e praktikave të menaxhimit të burimeve natyrore të përmirësuara. <b>C)</b> Ndërgjegjësimi publik. Kjo komponente do të fokusohet në ndërtimin e ndërgjegjësimit dhe edukimit për liqenin dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve të tij. Për shkak të karakterit të problemeve komplekse të liqenit, projekti do të ndjek në mënyre të integruar ceshtjet e tokës dhe ujit, nëpërmjet promovimit të bashkëpunimit ndërsektorial brenda të gjithë basenit të liqenit. Projekti do të asistojë Qeveritë e Shqipërisë dhe të Malit të Zi për të zbatuar një Strategji Plan Veprimi për liqenin e Shkodrës me një theks të veçantë ne: Promovimi i menaxhimit të integruar të burimeve natyrore dhe konservimi i biodiversitetit; Forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e përbashkët të liqenit; Investime për parandalimin e ndotjes. Ndërgjegjësimi publik për shpërndarjen e përfitimeve e aktiviteteve të projektit të propozuar dhe zhvillimi i një strategjie për promovimin e aktiviteteve në zona të tjera të ngjashme.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Zhvillimi i kuadrit ligjor institucional Hartimi dhe zbatimi i planeve lokale dhe rajonale Përmirësimi i politikave të menaxhimit të pyjeve, kullotave dhe peshkimit Mbrotjtja dhe ruajtja e biodiversitetit liqenit	<b>Grupet e synuara</b> Qytetarët e Shkodrës, Koplikut dhe zonave rurale përreth liqenit (Shq.) Qytetarët e Podgoricës, Virpazarit dhe zonave rurale përreth liqenit (MiZ.)	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveritë e Shqipërisë, Malit të Zi Banka Botërore Bashkitë	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Banka Botërore Bashkëfinancim i donatorëve të tjerë Qeveria qendrore	
<b>Para kushtet</b> Memorandumi i mirëkuptimit mes Shqipërisë dhe Malit të Zi (Maj 2003) Memorandumi i mirëkuptimit mes Shqipërisë dhe Bankën Botërore	<b>Faktorë rrezikues</b> Financimi i mjaftueshëm Bashkëpunimi me Malin e Zi	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b> <b>500,000,000 Lekë</b>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Ministria e Mjedisit		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2005–2010	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> 2007 dhe në vazhdim	

<b>Nr 19</b>	<b>Projekti Q1:O3:PG1:p6:</b> Vënia në punë e shërbimit të transportit liqenor Shkodër–Virpazar, Mal i Zi	<b>Tipi i programit Q1:O3:PG1:</b> Ngritja e strukturave për inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërkufitare
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit:</b> Transporti uJOR në liqenin e Shkodrës ka qene gjithmonë një element shume i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të qytetit, me ane të cilit është bere i mundur komunikimi për transportin e mallrave dhe pasagjereve me të gjithë zonat e banuara përreth liqenit dhe në të njëjtën kohe nëpërmjet lumit Buna sigurohej lidhja e këtij transporti me detin Adriatik. Gjate periudhës 1945–1990 transporti uJOR në liqenin e Shkodrës pësoi një rënie të konsiderueshme. Një faktor që ndikoi negativisht në këtë drejtim ishte mbyllja e kufijve me ish-Jugosllavinë (Malin e Zi). Transporti uJOR në përgjithësi funksionoi për gjuetinë e peshkut, ndërsa për transportin e pasagjereve pas viteve 1980 u ndërpre për shkak të mjeteve lundruese teje të amortizuara. Për riaktivizimin e këtij transporti, si element shume i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit dhe mjet komunikimi me Malin e Zi, ky projekt parashikon realizimin e këtyre aktivitete: Riaktivizimin e transportit uJOR ditor vajtje ardhje të linjës Shkodër–Shirokë–Zogaj–Kraje–Virpazar; Rikonstruksionin e molove pranë urës së Bunës dhe në fshatin Zogaj; Menaxhimi i këtij aktiviteti me sipërmarrje nga ana e një subjekti të specializuar.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rritja e numrit të vizitorëve në Shkodër Zhvillimi ekonomik i Shirokës dhe Zogajt		<b>Grupet e synuara</b> Sektori i turizmit Turistët Komuniteti i biznesit në Shirokë dhe Zogaj I gjithë komuniteti
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Qeveria qendrore Komuna e Venecias UNOPS-PASARP		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Qeveria qendrore Komuna e Venecia UNOPS-PASARP
<b>Para kushtet</b> Marrëveshja mes Shqipërisë dhe Malit të Zi për transportin uJOR në liqenin e Shkodrës Dhurate nga Komuna e Venecias e dy varkave lumore ose liqenore		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e aprovimit të marrëveshjes specifike në parlamentet përkatëse
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>3,000,000 Lekë</b></span>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Ridvan Sokoli, Drejtor i Sektorit të Planifikimit, Koordinimit dhe Informimit të Publikut		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit



<b>Nr 20</b>	<b>Projekti Q1:O4:PG1:p1:</b> Ndërtimi i tregut të shitjes me shumicë të fruta perimeve	<b>Tipi i programit Q1:O4:PG1:</b> Forcimi i sistemit të tregjeve publike ekzistuese shitjes me shumicë dhe pakicë
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Objektivat e këtij projekti janë të nxisë dhe të zhvilloje marketingun e produkteve bujqësore duke nxitur prodhimet fermerë të rrethit të Shkodrës. Te përmirësoje funksionimin e shitjes me shumice të produkteve bujqësore dhe rritjen e kapaciteteve planifikuese për furnizimin e popullatës me këto produkte. Aktualisht tregu i shitjes me shumice fruta perime ndodhet në hyrje të qytetit në një vend krejtësisht të papërshtatshëm. Ndërtimi i tregut të shitjes me shumicë të fruta-perimeve në Shkodër shihet si një nevojë imediate dhe pritet të ketë një sërë ndikimesh dhe impakti i tij do të jetë i gjerë. Ndër arsyet më kryesore për ngritjen e këtij tregu mund të veçojmë. Sepse tregjet ekzistuese nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të përballuar gjithë nevojat e tregtarëve, fermerëve dhe të blerësve (hallkave të ndërmjetme për konsumatorin). Kjo dëshmohet nga përdorimi i ambienteve të tjera të papërshtatshme si trotuare apo vende (sheshe) të tjera të pa miratuara nga Bashkia; Tregjet ekzistuese nuk plotësojnë kushtet e një lëvizje të rregullt dhe funksionim normal të trafikut të brendshëm. Nga njëra anë nuk ka rrugëkalime të mjaftueshme dhe nga ana tjetër vendet e caktuara për shitje nuk respektohen nga tregtarët. Tregu i ri do të përmblihdhte në një vend gjithë tregtarët e fruta-perimeve duke shmangur kështu shitjen në trotuare apo në vende të tjera të papërshtatshme; Situata higjieno-sanitare nuk është në parametrat e duhur, ndërkohë që mungojnë edhe facilitete të tjera të nevojshme. Ndërtimi i Tregut me shumice fruta perime parashikohet të ndërtohet në një sipërfaqe prej 17,200 m <sup>2</sup> . Do të ndërtohen 22 magazina, 64 vende tregtimi, 108 vende parkingu për automjete me tonazh 1–7 ton. Zyra dhe ambiente të tjera ndihmese. Për menaxhimin e tregut nga ana e bashkisë do të krijohet një shoqëri e formës juridike aksionere me kapital 100 % të saj.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rritja e prodhimit vendas bujqësor Shitja e prodhimit të freskët e me cilësi të lartë në kushte higjienike Rregullimi i tregjeve me pakicë dhe shumicë Rritja e buxhetit	<b>Grupet e synuara</b> Qytetarët Fermerët Shitësit me shumicë dhe pakicë Industria përpunuese Bashkia	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit Banka Botërore	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit Banka Botërore	
<b>Para kushtet</b> Marrëveshja e qeverise qendrore me BB Studimi i fizibilitetit dhe miratimi nga këshilli	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë financimi	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> Trualli Ndërtime dhe infrastruktura Pajisje Shpenzime parapërgatitore /fillestare <b>Totali</b>	 49,500,000 Lekë 96,226,396 Lekë 1,640,000 Lekë 2,120,000 Lekë <b>149,486,396 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Ridvan Sokoli, Drejtori i Sektorit të Planifikimit, Koordinimit dhe Informimit Publik		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Tre muaj pas zbatimit të projektit	

<b>Nr 21</b>	<b>Projekti Q1:O4:PG1:p2:</b> Ndërtimi në qytet i tregjeve të reja për shitjen me pakicë të frutave, perimeve, peshkut dhe mishit	<b>Tipi i programit Q1:O4:PG1:</b> Forcimi i sistemit të tregjeve publike ekzistuese shitjes me shumicë dhe pakicë
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Ky projekt do të hartohet mbi bazën e kapacitetet tregtare që aktualisht ekzistojnë në zonën e Zdralej, duke parashikuar që tregtarët ambulante dhe bizneset të vendosin rregull për shitjen e mallrave të tyre. Në të njëjtën kohe projekti gjithashtu do të rrisë fluksin e blerësve të cilët do të rrisin të ardhurat për ato biznese të cilat shërbejnë më mire si dhe duke dhënë më shume mundësi për të zhvilluar njësi tregtare të reja. Aktualisht nuk janë bere përmirësime në infrastrukturën e kësaj zone sepse asnjëri nuk ka patur një përgatitje të duhur për të analizuar situatën urbane. Parashikimi dhe njohja e tregtareve dhe e blerësve me problemet e analizuar do t'u jepte atyre një mundësi dhe shprese për të ndihmuar në përmirësimin me infrastrukturën e duhur tregtare në këtë zone.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rritja e sensibilizimit vendas për shërbimet publike Rritja e numrit të konsumatorëve në një treg të ri fruta-perimesh Rregullimi i zonave me asistencë Rritja e rëndësisë për një treg si një element mbështetës për ZhEV Përmirësim i grumbullimit, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave në bashkëpunim me Zyrën e të ardhurave në bashki		<b>Grupet e synuara</b> Fermerët Banorët e zonës Bashkia
<b>Aktorët e mundshëm</b> Donatorë të ndryshëm Fermerë Bashkia		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Donatorët
<b>Para kushtet</b> Studimi dhe zhvillimi i planit teknik për tregun e fruta-perimeve të shitjes me pakicë në Zdralej		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë financimi
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>4,500,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Frederik Shiroka, Drejtor i Drejtorisë të Planifikimit Urban		
<b>Periudha e zbatimit</b> 2005		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> 2006



<b>Nr 22</b>	<b>Projekti Q1:O5:PG1:p1:</b> Zhvillimi i strategjisë të turizmit për qytetin e Shkodrës	<b>Tipi i programit Q1:O5:PG1:</b> Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së turizmit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi i një strategjie për zhvillimin e turizmit në Shkodër. Projekti do të analizojë strategjinë e ZhEV të përgatitur nga bashkia në bashkëpunim me programin DELTA, në veçanti analiza SWOT e zhvillimit të potencialeve të turizmit të qytetit dhe do të përcaktojë prioritetet për investime dhe përlogarisë numrin e synuar dhe të mundshëm të vizitorëve të qytetit. Kjo do shërbejë si një guidë për të investime në këtë industri.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Strategjia e zhvillimit të turizmit për Shkodrën Përmirësimi i imazhit të qytetit	<b>Grupet e synuara</b> Turistët e huaj dhe vendas Investues	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Universiteti Bashkia	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia GTZ	
<b>Para kushtet</b> Gatishmëria e instruktorëve dhe studentëve të trajnuar në Departamentin e Turizmit të Universitetit	<b>Faktorë rrezikues</b> Konkurrenca e fqinjëve Mungesa e donatorëve	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b> <b>500,000 Lekë</b>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Arjeta Troshani, Shefe e Departamentit të Marketingut dhe Turizmit në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Në vazhdim, sapo të fillojë zbatimi	

<b>Nr 23</b>	<b>Projekti Q1:O5:PG1:p2:</b> Hapja pranë bashkisë së Shkodrës e Zyrës për Mbështetjen e Turizmit	<b>Tipi i programit Q1:O5:PG1:</b> Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së turizmit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Qëllimi i këtij projekti është të ngrejë një zyrë për mbështetjen dhe koordinimin e aktiviteteve të turizmit në qytet. Ekziston një potencial i madh për zhvillimin e qëndrueshëm të tipeve të ndryshme të turizmit vendas duke konsideruar artefaktet e pasura të Shkodrës arkeologjike, muzeale dhe historike, natyrën që e rrethon, me klimën e shëndetshme tërheqëse të Shirokës dhe Zogajt, traditat sportive dhe ekzistenca në prag të derës të liqenit më të madh në Ballkan dhe tre lumenjve. Funksionet e zyrës do të jenë: Ndjekja pranë zyrave të tjera të problematikave emergjente të turizmit; Ndjekjen e ecurisë së projekteve të veçanta që lidhen me zhvillimin e turizmit; Pjesëmarrje në aktivitetet kombëtare dhe nderbashkiake për turizmin; Krijimi i lidhjeve të reja me projekte dhe organizma të interesuara për zhvillimin e turizmit; Inicim dhe ndjekje e procesit të krijimit të produkteve promovuese të turizmit.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Forcimi i bizneseve ekzistuese të turizmit Ngritja e bizneseve të reja Përmirësimi i standardeve të shërbimit		<b>Grupet e synuara</b> Bizneset e turizmit
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Universiteti Bizneset e turizmit		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia GTZ
<b>Para kushtet</b> Potencial i madh për zhvillimin e turizmit Ekzistenca e bizneseve vendase të turizmit		<b>Faktorë rrezikues</b> Burime të kufizuara financiare Vullnet i kufizuar politik i anëtarëve të këshillit të qytetit
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>1,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Ridvan Sokoli, Drejtori i Sektorit të Planifikimit, Koordinimit dhe Informimit Publik		
<b>Periudha e zbatimit</b> Dy muaj		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit





<b>Nr 24</b>	<b>Projekti Q1:O5:PG1:p3:</b> Krijimi i një rrjeti hotelesh dhe restorantesh në qytet që të përmirësohen standardet e tyre dhe të bëjnë të larmishëm shërbimet e tyre	<b>Tipi i programit Q1:O5:PG1:</b> Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së turizmit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Ky projekt synon të krijojë një shoqatë të hoteleve, bareve, restoranteve dhe agjencive të udhëtimit në qytetin e Shkodrës me qëllim stimulimin dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit. Qëllimi i shoqatës do jetë promovimi i vlerave turistike të qytetit asetet e turizmit, organizimi i programeve të ndryshme të trajnimit në fushën e turizmit, përgatitja dhe publikimi i një game të gjerë literature turistike që nga guidat turistike deri tek librat shkencorë apo librat që lidhen me turizmin. Qëllimi i shoqatës do të jetë transmetimi dhe shkëmbimi i eksperiencave më të mira midis strukturave turistike të qytetit të Shkodrës.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Krijimi i rrjetit të strukturave turistike vendase Nxitje e zhvillimit të turizmit Shkëmbim i eksperiencave më të mira ndërmjet strukturave turistike	<b>Grupet e synuara</b> Agjencitë turistike Hotelet Baret dhe restorantet Universiteti	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Agjencitë turistike Hotelet Baret dhe restorantet Universiteti	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia GTZ	
<b>Para kushtet</b> Ekzistenca e shoqatave në qytet	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e mbështetjes financiare Mungesë e burimeve njerëzore për menaxhimin e shoqatës	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b> <b>100,000 Lekë</b>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Arjeta Troshani, Shefe e Departamentit të Marketingut dhe Turizmit në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Viti 2005	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Viti 2005 e në vazhdim	



<b>Nr 25</b>	<b>Projekti Q1:O5:PG1:p4:</b> Hapja e një qendre tregtare të artizanatit	<b>Tipi i programit Q1:O5:PG1:</b> Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së turizmit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<p>Shkodra, përveç se një qendër e hershme tregtare me tradita të pasura, që nga rrëzimi i komunizmit, duhet ende të përmbushë kushtet e kërkuara për lulëzimin e një tregu të specializuar të produkteve artizanale. Tregu dhe kërkesa për treg ekziston ende, por nuk janë të organizuara dhe të konsoliduara. Kështu, studimet dhe projektet për ngritjen e tij përbëjnë kusht të kusht të nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ndryshimin e këtij aspekti të vjetër të Shkodrës.</p> <p>Zona që do të studiohet, përveç pozicionit tepër të favorshëm gjeografik, ka edhe një tipar të rëndësishëm që ndodhet pranë Pazarit të Vjetër të qytetit.</p> <p>Është me rëndësi që projekti përfshin ofrimin e shërbimeve të rëndësishme si hapësira të përshtatshme për parkim, bare, restorante, banka, etj.</p> <p>Elemente të tjera të rëndësishme janë krijimi i një ekspozite dhe panairi.</p>		
<b>Rezultatet e pritshme</b>	Ngritja dhe zhvillimi i tregut të produkteve artizanale Zhvillimi ekonomik i zonës Tërheqja e turistëve të huaj dhe vendas Rritja e numrit të shërbimeve dhe bizneseve	<b>Grupet e synuara</b> Gjithë komuniteti Turistët vendas dhe të huaj Bizneset
<b>Aktorët e mundshëm</b>	Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullim Territorit Bizneset vendase Donatorë OJF	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullim Territorit Bizneset vendase Donatorë OJF
<b>Para kushtet</b>	Ekzistenca e projekteve të detajuara urbanistike dhe arkitekturore Përgatitja e programeve ekonomike dhe turistike	<b>Faktorë rrezikues</b> Burime të kufizuara financiare
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>	<b>50,000,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b>		
Ismail Beka, Programi i Zhvillimit Ekonomik, GTZ		
<b>Periudha e zbatimit</b>	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b>	
Një vit	Pas zbatimit të projektit	



<b>Nr 26</b>	<b>Projekti Q1:O5:PG1:p5:</b> Organizimi periodik i trajnimeve për ngritje kapacitetesh të agjencive turistike dhe bizneseve	<b>Tipi i programit Q1:O5:PG1:</b> Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së turizmit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Qëllimi i këtij projekti është të rritë ndërgjegjësimin mbi konceptet bashkëkohore të menaxhimit të biznesit, zhvillimit të një plan biznesi, marketingun dhe komunikimin me turistët e huaj, rezervimin dhe akomodimin e bërë me sistemet dhe programet kompjuterike. Do të organizohen sesione trajnimi me pjesëmarrjen e agjencive turistike, bareve, hoteleve, zyra të zhvillimit, bizneset e turizmit, dhe me një fokus të veçantë në përfshirjen e grave dhe të rinjve. Një qëllim për mbajtjen e këtyre sesioneve trajnimi do të jetë përmirësimi i cilësisë së shërbimit, dhe në to do të përfshihen kurse për përgatitjen e ushqimeve (të standardeve të KE) dhe për shkëmbimin e eksperiencave të huaja. Gjatë seancave të trajnimit do të shpërndahen materiale didaktike dhe promovuese si audio-video, kompjutera, etj.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Zhvillimi afatgjatë i turizmit Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit në strukturat turistike	<b>Grupet e synuara</b> Turistët vendas dhe të huaj Agjencitë turistike Hotelet, baret dhe restorantet	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Universiteti Trajnerë të huaj Specialistët e turizmit	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Universiteti	
<b>Para kushtet</b> Gatishmëria e trajnerëve me eksperiencë në Universitet	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e burimeve financiare Mungesa e trajnerëve	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>	<b>200,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Arjeta Troshani, Shefe e Departamentit të Marketingut dhe Turizmit në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një herë në gjashtë muaj	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Menjëherë pas trajnimit të parë	

<b>Nr 27</b>	<b>Projekti Q1:O5:PG1:p6:</b> Nxitja e turizmit familjar dhe agro-turizmit në Shirokë dhe Zogaj	<b>Tipi i programit Q1:O5:PG1:</b> Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së turizmit
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Turizmi familjar është një industri shumë e zhvilluar në shumë vende të Evropës perëndimore. Ky projekt synon përshtatjen e idesë me industrinë e turizmit në Shkodër. Ai do të përqendrohet në dy zona pilot, në Zogaj dhe Shirokë do të përgatisë disa shtëpi për të genë si model lidhur me akomodimin dhe nevoja të veçanta shërbimi për turistët, si dhe do të përkrahë traditat dhe kulturën e shquar të mikpritjes së rajonit.</p> <p>Qëllimi i projektit do të jetë përkrahja e aspekteve unike të qytetit që do të mbështesin zhvillimin e këtij lloj turizmi, duke përfshirë kuzhinën karakteristike të rajonit, stilin e jetës, zonës, të stilit të jetës, veshjen, punët bujqësore dhe industrinë shtëpiake tradicionale të punës me bagëtinë e aktivitete shtëpiake, punimet artizanale të zonës si prodhimi i qilimave në Zogaj, etj.</p> <p>Shumë turistë të huaj parashikojnë të kenë eksperiencë të tilla pushimesh dhe në Shkodër, ku traditat janë të rrënjosura mirë, ky zhvillim i turizmit nuk do të kërkojë ndonjë investim relativisht të madh.</p> <p>Ky projekt do të ketë në shenjë shkëmbimin e eksperiencave me vendet fqinjë si Ulqini, Mal i Zi, ku turizmi familjar është forma kryesore e turizmit.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Zhvillimi i turizmit familjar Ndërtimi i imazhit pozitiv për qytetin nëpërmjet zhvillimit të aspekteve unike të rajonit</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Gratë që menaxhojnë turizmin familjar Komuniteti vendas Komuniteti i biznesit Turistët</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Universiteti Trajnerët vendas Përfaqësues të zyrës së zhvillimit të turizmit në bashki</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Banka Botërore</p>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Drejtorja e Planifikimit Urban në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Dhjetë vjet		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas miratimit të vendeve të ndërtimit

<b>Nr 61</b>	<b>Projekti Q4:O1:PG1:p3:</b> Zhvillimi planeve të pjesshme urbane për zonat Mark Lulaj, Hardhijat e Egra dhe Zooteknikë	<b>Tipi i programit Q4:O1:PG1:</b> Përmirësimi dhe rritja e instrumenteve planifikues për zhvillimin dhe menaxhimin urban të qytetit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Zonat e Mark Lulaj, Hardhijat e Egra, Zooteknike janë zona periferike të qytetit të Shkodrës në të cilat janë përqendruar një numër i madh i banoresh që migruan nga zonat rurale dhe të pazhvilluara të rajonit. Vendbanimet në këto zona janë ndërtuar pa rregull, pa iu referuar një studimi apo plani, dhe janë të shpërndara në mënyre të çrregullt. Në fakt, zona nuk ka as infrastrukturë urbane as shërbime sociale. Ky projekt parashikon ndërtimin e infrastrukturës urbane dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për popullsinë e këtyre zonave.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Ndërtimi i infrastrukturës urbane dhe shërbimeve sociale Përmirësimi i cilësisë së jetesës për banorët		<b>Grupet e synuara</b> Banorët e zonave periferike të qytetit
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia
<b>Para kushtet</b> Të dhënat e duhura për të gjitha aktivitetet që zhvillohen në zonë		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e burimeve financiare
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>9,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Drejtoria e Planifikimit Urban në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Dhjetë vjet		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas miratimit të vendeve të ndërtimit



<b>Nr 62</b>	<b>Projekti Q4:O1:PG1:p4:</b> Hartimi i planit të veprimit për detajimin e Planit Rregullues të Qytetit	<b>Tipi i programit Q4:O1:PG1:</b> Përmirësimi dhe rritja e instrumenteve planifikues për zhvillimin dhe menaxhimin urban të qytetit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Zbatimi i ndryshimeve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Rregullator mund të kryhet në disa mënyra të ndryshme. Një nga mënyrat më të mira është me anë të një Plani të Pjeshtë të zbatimit, me anë të të cilit mund të ushtrohet disiplinë më e mirë në ndërtimin e banesave dhe objekteve të tjera, në përputhje me Planin Rregullator. Funkcioni i Planit të Pjeshtë është të specifikojë kufizimet e përcaktuara në Planin Rregullator dhe në të njëjtën kohë nuk duhet të jetë në konflikt me atë plan. Ky projekt synon të përcaktojë një plan të tillë në përgatitjen për një zhvillim normal të qytetit.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Standartizimi i zonave të veçanta	<b>Grupet e synuara</b> Komuniteti në zonat e veçanta të qytetit	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia	
<b>Para kushtet</b> Të dhënat e duhura për të gjitha aktivitetet që zhvillohen në zonë, si dhe përcaktimet e bëra nga Plani i Përgjithshëm Rregullator	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>	<b>3,000,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Drejtorja e Planifikimit Urban në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Dhjetë vjet	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas aprovimit të vendeve të ndërtimit	

<b>Nr 63</b>	<b>Projekti Q4:O2:PG1:p1:</b> Rikonstruktimi i 15 rrugëve të qytetit (Aneksi 4)	<b>Tipi i programit Q4:O2:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit rrugor të qytetit
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Rikonstruksioni i rrugëve të Shkodrës është një nga projektet më prioritare të qytetit. Ky projekt synon rikonstruktimin e rrugëve të qytetit në cilësinë më të lartë për të përmirësuar rrjedhën e trafikut brenda qytetit dhe për të rritur sigurinë e qytetarëve. I gjithë komuniteti do të përfitojë nga një rrjedhë trafiku më e rregullt dhe më e përmirësuar, nga siguria e rritur për këmbësorët dhe cilësia e përmirësuar e mjedisit.</p> <p>Shumica e rrugëve në Shkodër, janë dëmtuar shumë keq ka gropa, çarje dhe deformime dhe shumë prej tyre nuk aspak të asfaltuara. Në këto kushte të dobëta është planifikuar të shtrohen rrugët me asfalt pasi të sigurohet që ato kanë bazament të fortë.</p> <p>Është planifikuar të rikonstruktohen dhe të riasfaltohen rrugët e mëposhtme:</p> <p>Unaza nga Tophanë–Kiras–Rus, rruga “Skënderbeg”, rruga nga hyrja jugore e qytetit deri poshtë Kështjellës së Rozafës deri në Xhabije, rruga “Alqi Kondi”, dhe rrugët “Ali Kelmendi &amp; Lekë Dukagjini”, “Tregu i Ri”, rruga nga “Ura e Thive deri të nënkalimi hekurudhor, rruga nga ish ndërmarrja e artizanatit deri tek ish ndërmarrja e mëndafshit, rruga “Guerile”, rruga “Revolucioni Antikomunist Hungarez 1956”, rruga “Justin Godard”, rruga “Bajram Curri”, rruga “Halit Bajraktari”, rruga “Tahsim Bërdica”, rruga “Daut Boriçi”.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Përmirësimi i qarkullimit në sistemin rrugor Rritja e sigurisë për qytetarët Përmirësimi i cilësisë së mjedisit</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Banorët dhe bizneset të vendosura në këto rrugë I gjithë qyteti</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Bashkia Bizneset vendase</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Studimi urban i zonave Miratimi nga këshilli bashkiak i Shkodrës</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Mungesë e burimeve të mjaftueshme financiare</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b></p>		<p><b>1,151,063,000 Lekë</b></p>
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Pesë vjet</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Pas zbatimit të projektit</p>



<b>Nr 64</b>	<b>Projekti Q4:O2:PG1:p2:</b> Rikonstruktimin i 12 trotuareve të rrugëve urbane (Aneksi 4)	<b>Tipi i programit Q4:O2:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit rrugor të qytetit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Një nga mënyrat më efektive të përmirësimit të cilësisë së jetës për banorët e Shkodrës do të ishte përmirësimi i cilësisë së rrugëve të qytetit. Rrugë të tilla si “Bujar Bishanaku”, “Daut Boriçi” dhe “Muhamet Gjollësja” janë në kushte të mjerueshme, por gjithsesi ato janë rrugë kryesore të qytetit. Ky projekt synon rikonstruksionin e trotuareve të këtyre rrugëve si dhe të tjerave, duke çuar në përmirësimin e sigurisë së qytetarëve të Shkodrës. Trotualet janë të gjitha në kushte të këqija, me gropa dhe asfalt të thyer dhe në disa raste nuk janë fare të shtruara ose janë të papërdorshme, dhe shpesh nuk kanë ndriçim rrugor, etj. Në këto kushte, është planifikuar që trotualet të rehabilitohen me pllaka ose asfalt. Në disa zona trotualet do të rikonstruktohen tërësisht, duke përmirësuar sistemet e kanaleve shkarkuese age dhe të ndriçimit të instaluar. Nisur nga gjendja ekzistuese është përcaktuar shtrimi i rrugëve me pllaka ose me shtrese bitumi. Në disa zona do të përmirësohet ose të ribëhet ndërtimi i trotuareve, kanalizimi i ujërave të bardha, ndriçimi. Nga ky projekt do të përfitojë i gjithë komuniteti duke rritur sigurinë e kalimtarëve, përmirësuar ndriçimin rrugor dhe cilësinë e mjedisit duke reduktuar ndotjen.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i trafikut dhe qarkullimit të këmbësorëve Përmirësimi i nivelit të sigurisë për qytetarët Përmirësimi i cilësisë së mjedisit	<b>Grupet e synuara</b> Banorët dhe bizneset që ndodhen në këto rrugë Gjithë qyteti	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Bizneset vendase	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit	
<b>Para kushtet</b> Studimi urban i zonave Miratimi nga këshilli bashkiak	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>	<b>Duhet përlllogaritur</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periodha e zbatimit</b> Dy vjet	<b>Periodha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	

<b>Nr 65</b>	<b>Projekti Q4:O2:PG1:p3:</b> Rikonstrukcion i ndriçimit publik të 8 rrugëve urbane (Aneksi 4)	<b>Tipi i programit Q4:O2:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit rrugor të qytetit
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Rrugët kryesore të Shkodrës nuk përdoren vetëm nga makinat, por edhe nga këmbësorët. Aktualisht, shëtitjet gjatë mbrëmjes janë të rrezikshme sepse ndriçimi rrugor nuk funksionon. Ato ndriçohen vetëm nga drita e ambienteve të banimit dhe të dyqaneve që shtrihen përgjatë rrugës. Ky projekt synon të kryejë instalimin e ndriçuesve përgjatë tetë rrugëve në zona të banuara duke rritur kështu, nivelin e sigurisë publike. Ndriçimi i përmirësuar do të ndriçojë qytetin gjatë natës dhe do të lehtësojë zgjatjen e orëve të punës. Propozimi i projektit është të parashikojë mbulimin me dritë gjatë rrugëve kryesore, me qëllim që të rrisë sigurinë publike dhe të gjallërojë qytetin dhe bizneset gjatë orëve të natës.</p> <p>Do të shtrohen kablllo të rinj elektrikë dhe do të riparohen dritat ekzistuese të rrugëve duke instaluar aty ku kërkohet edhe drita të reja.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Ndriçimi i qytetit gjatë natës Zgjatja e orëve të punës Përmirësimi i cilësisë së jetës</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Komuniteti Biznesi Qeveria vendore</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Donatorë të ndryshëm Komuniteti Biznesi që ushtron aktivitetin në këtë zonë</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Bashkia KESH (Korporata Energjetike Shqiptare)</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Krijimi i kushteve të partneritetit ndërmjet qeverisë vendore, biznesit dhe komunitetit Ndërgjegjësimi i komunitetit për ruajtjen dhe mos dëmtimin e investimeve në shërbim të tyre Krijimi i besimit tek donatorët</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Bashkëpunim i dobët mes palëve të interesuara dhe qeverisë vendore Mungesa e donatorëve Buxhet i kufizuar</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>52,040,000 Lekë</b></span></p>		
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Viti 2006</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Viti 2006 dhe më pas</p>



<b>Nr 66</b>	<b>Projekti Q4:O2:PG2:p1:</b> Rehabilitimi i 5 daljeve të ujërave të bardha të qytetit (Aneksi 4)	<b>Tipi i programit Q4:O2:PG2:</b> Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha të qytetit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Në përgjithësi, sistemi kryesor i shkarkimit të ujërave të qytetit është sipas projektimit të vjetër dhe kolektorët janë të zbuluar. Zgjerimi dhe zhvillimi i fundit informal urban nuk është paraprirë nga një studim urban për shkarkimin e ujërave sipërfaqësorë. Sistemi tashmë ekzistues është kështu i mbingarkuar dhe madje, as nuk është ruajtur, duke shkaktuar probleme serioze për tërë qytetin. Në vitin 1997, në kuadër të projektit “Rehabilitimi i grumbullimit dhe furnizimit me ujë” në Shkodër, financuar nga Qeveria Austriake, ishte përcaktuar se do të ndërtoheshin 33 km kolektorëve kryesorë, me një kosto 10 milion Euro. Sipas këtij projekti ndërhyrjet më prioritare (gjithsej 5.36 km) duhet të bëhen si më poshtë: Kolektori në rrugën “Ali Kelmendi”, me gjatësi 1.4 km, që fillon në derdhje të kolektorit austriak deri tek teatri “Migjeni”; Kolektori në rrugën “Mujo Ulqinaku”, me gjatësi 1.2 km, që fillon në lagjen “Tophane” deri në lagjen “Ndocej”, pranë shkollës “Salo Halili”; Kolektori i daljes në Kiras, pranë daljes së parë të segmentit të unazës, me gjatësi 0.7 km, që fillon në rrugën “Karvane” me derdhje në fushën të Bunës; Kolektori i Fermës, me gjatësi 1 km, që fillon nga ish fabrika e mëndafshit tek shkolla e ndërtimit, poshtë urës “Kercile” me dalje tek ura e Pazarit.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rehabilitimi i sistemit të kullimit të ujërave të Shkodrës	<b>Grupet e synuara</b> Te gjithë (110,000) banorët e qytetit	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Qeveria qendrore	
<b>Para kushtet</b> Studimi urban i zonës Miratimi nga këshilli i bashkiak i Shkodrës	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>	<b>181,040,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	



<b>Nr 67</b>	<b>Projekti Q4:O3:PG1:p1:</b> Rehabilitimi i stacionit të pompimit të ujerave të zeza	<b>Tipi i programit Q4:O3:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit të ujerave të zeza të qytetit										
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Rrjeti i kanalizimeve të ujerave të zeza të Shkodrës është projektuar në mënyrë të tillë që shkarkimi i ujerave të zeza të kryhet nga stacioni i pompave që ndodhen në hyrjen jugore të qytetit (në lagjen “Liria”) në lumin Drin 300 m nga Ura Bahçallëkut.</p> <p>Në Shkodër ekziston një linjë që kryen furnizimin me energji elektrike si të stacionit të pompave dhe të zonës së banimit rrotull. Kështu që edhe kur ka energji elektrike, nga konsumi i lartë shtëpiak furnizimi tek stacioni është shumë i dobët për pompat që të punojnë (3.5 kW; 380 V). Si rezultat, ujërat e zeza të qytetit rrjedhin direkt në liqenin e Shkodrës, në zonën pranë skelës.</p> <p>Është llogaritur që 9 milion m<sup>3</sup> ujëra të zeza të patrajtuara që derdhen në liqenin e Shkodrës çdo vit duke shkaktuar dëmtime serioze të mjedisit dhe duke krijuar një rrezik serioz për shëndetin në bulevardin kryesor të qytetit që shtrihet përgjatë skelës.</p> <p>Ky projekt parashikon ndërhyrje në sistemin e ujerave të zeza si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i linjës së re të furnizimit me energji elektrike për stacionin e pompave;</li> <li>Rehabilitimi i pompave të ujerave të zeza;</li> <li>Blerje e pajisjeve ndihmëse për stacionin;</li> <li>Riparime të bëra në vetë stacionin e pompave.</li> </ul>												
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Funksionimi normal i stacionit të pompave të ujerave të zeza</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Banorët e qytetit Bizneset Bashkia</p>										
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit Donatorë të huaj</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit KfW</p>										
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Disponueshmëria e projektit teknik</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Mungesë e burimeve financiare</p>										
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td>Transformatorë 500 kV / 20 kV</td> <td style="text-align: right;">900,000 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Rehabilitimi i pompës</td> <td style="text-align: right;">400,000 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Gjenerator 2.5 kW, 380 V, 1.5 ton</td> <td style="text-align: right;">500,000 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Pjesë dhe punime</td> <td style="text-align: right;">10,600,000 Lekë</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td style="text-align: right;"><b>12,400,000 Lekë</b></td> </tr> </table>			Transformatorë 500 kV / 20 kV	900,000 Lekë	Rehabilitimi i pompës	400,000 Lekë	Gjenerator 2.5 kW, 380 V, 1.5 ton	500,000 Lekë	Pjesë dhe punime	10,600,000 Lekë	<b>Totali</b>	<b>12,400,000 Lekë</b>
Transformatorë 500 kV / 20 kV	900,000 Lekë											
Rehabilitimi i pompës	400,000 Lekë											
Gjenerator 2.5 kW, 380 V, 1.5 ton	500,000 Lekë											
Pjesë dhe punime	10,600,000 Lekë											
<b>Totali</b>	<b>12,400,000 Lekë</b>											
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike</p>												
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Pese muaj</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Pas zbatimit të projektit</p>										



<b>Nr 68</b>	<b>Projekti Q4:O3:PG1:p2:</b> Ndërtimi dhe rehabilitimi i tubave të daljes së shkarkimeve të ujërave të zeza	<b>Tipi i programit Q4:O3:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit të ujërave të zeza të qytetit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Një pjesë e tubit kryesor të shkarkimit të ujërave të zeza (Ø1000), me gjatësi rreth 40 m, që hyn në lumin Drin është dëmtuar shumë dhe nuk funksionon, ashtu si dhe porta e shkarkimit në liqen, që në mungesë të elektricitetit hapet (d.m.th. virtualisht hapet gjithmonë) dhe gjatë dimrit kur niveli i liqenit dhe i lumit Buna ngrihet. Ky projekt synon rehabilitimin e përgjithshëm të sistemit të ujërave të zeza të Shkodrës, reduktimin e dëmtimit mjedisor dhe përmirësimin e kushteve higjienike në qytet.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Funksionim normal i stacionit të pompave	<b>Grupet e synuara</b> Banorët e qytetit Bizneset Bashkia	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit Donatorë të Huaj	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit KfW	
<b>Para kushtet</b> Disponueshmëria e projektit teknik	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> Instalimi i tubave të betonit Ø1000 Instalimi i portës metalike 1 x 2 m <b>Totali</b>	400,000 Lekë 200,000 Lekë <b>600,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një muaj	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	

<b>Nr 69</b>	<b>Projekti Q4:O3:PG1:p3:</b> Përmirësimi i teknologjisë së mirëmbajtjes së sistemit të ujërave të zeza	<b>Tipi i programit Q4:O3:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit të ujërave të zeza të qytetit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Të gjitha sistemet e ujërave të zeza primare, sekondare dhe terciare në Shkodër janë të mbushura me mbeturina. Ndërkohë, makineria aktuale e mirëmbajtjes disponibël në qytet është e papërshtatshme dhe e dëmtuar. Me qëllim pastrimin ashtu siç duhet të rrjetit të ujërave të zeza dhe për ta mirëmbajtur atë në të ardhmen nevojiten dy makina thithëse, dy kamionë zhblllokuese dhe dy makina transporti. Ky projekt synon t'i sigurojë qytetit mjetet për të rivënë në punë dhe të mirëmbajë sistemin e tij të ujërave të zeza. Ky projekt do të lehtësojë situatën shumë të rrezikshme të krijuar për banorët e Shkodrës.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza Përmirësimi i mjedisit në qytet Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve të qytetit		<b>Grupet e synuara</b> I gjithë komuniteti Bizneset Bashkia
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit Donatorë të Huaj		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit KfW
<b>Para kushtet</b> Ekzistenca e studimit të fizibilitetit		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
Makinë zhblllokuese (5 milion Lekë) x 2		10,000,000 Lekë
Makina thithëse (5 milion Lekë) x 2		10,000,000 Lekë
Makina transporti (500,000 Lekë) x 2		1,000,000 Lekë
<b>Totali</b>		<b>21,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas blerjes së kamionëve



<b>Nr 70</b>	<b>Projekti Q4:O3:PG1:p4:</b> Ndërtimi i linjave të reja të sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza	<b>Tipi i programit Q4:O2:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit të ujërave të zeza të qytetit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Rehabilitimi i sistem kanalizimit të ujërave të zeza të Shkodrës është absolutisht i nevojshëm për të përmirësuar kushtet aktuale higjienike për banorët e qytetit. Situata për mjedisin dhe përhapjen e sëmundjeve infektive është tani kritike dhe kërkon veprim të menjëhershëm mbrojtës. Ky projekt synon të përmirësojë, rehabilitojë dhe zëvendësojë disa pjesë të sistemit ekzistues, rikonstruksionin total të disa pjesëve të sistemit sekondar dhe rikonstruksionin e sistemit në disa zona banimi.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza duke ndikuar direkt në mjedis dhe cilësinë e jetesës		<b>Grupet e synuara</b> Banorët e qytetit Bizneset Bashkia
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit Donatorë të hua		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit KfW
<b>Para kushtet</b> Ekzistenca e studimit të fizibilitetit për rehabilitimin e kryer nga specialistet austriakë		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
Zgjerimet		39,500,000 Lekë
Rikonstruksion i rrjetit sekondar		29,700,000 Lekë
Rikonstruksion në zonat e banimit		4,200,000 Lekë
<b>Totali</b>		<b>73,400,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Pesë vjet		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit

<b>Nr 71</b>	<b>Projekti Q4:O4:PG1:p1:</b> Përfundimi i ndërtimit të kompleksit të rezervuarëve të ujit të pijshëm në Kodrat e Tepes	<b>Tipi i programit Q4:O4:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Ky projekt synon të mundësojë lidhjen e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm të Shkodrës me rezervuarët me një vëllim të përgjithshëm të ujit prej 15,800 m <sup>3</sup> . Menaxhimi i katër rezervuarëve do të bëhet nga një dhomë qendrore kontrolli, që do të jetë e automatizuar. Projekti parashikon përmirësimin furnizimin me ujë të pijshëm për qytetin dhe për të krijuar kushtet më të mira shërbimi për konsumatorin.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rritja e sasisë dhe e kohëzgjatjes për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të Shkodrës	<b>Grupet e synuara</b> Banorët e qytetit	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveria austriake Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Qeveria austriake Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit	
<b>Para kushtet</b> Ekzistenca e projektit dhe studimi i fizibilitetit për rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm të Shkodrës	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> Grant i qeverisë së austriake <b>Totali</b>	<b>700,000 Euro</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Gjashtë muaj	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	



<b>Nr 72</b>	<b>Projekti Q4:O4:PG1:p2:</b> Instalimi i saraçineskave të reja në sistemin shpërndarës të ujit të pijshëm	<b>Tipi i programit Q4:O4:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Rrjeti shpërndarës i ujit të pijshëm i Shkodrës ka në sistem një numër saraçineskash që shërbejnë për të menaxhuar shpërndarjen dhe sasinë e ujit, kapacitetin e rrjedhjes dhe shpërndarjen në zona të ndryshme të qytetit në çdo kohë, duke përfshirë edhe pajisjet frenuese në raste urgjente. Rehabilitimi i rrjetit shpërndarës kërkon zëvendësimin e saraçineskave të vjetra. Ky projekt parashikon përmirësime të bëra në furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit dhe krijimin e një shërbimi më të mirë për konsumatorin.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i sistemit shpërndarës të ujit të pijshëm Kursimi i ujit		<b>Grupet e synuara</b> Banorët e qytetit
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveria austriake Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Qeveria austriake Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit
<b>Para kushtet</b> Ekzistenca e projektit dhe studimi i fizibilitetit për rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm të Shkodrës		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e burimeve financiare
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> Grant i qeverisë austriake <b>Totali</b> <b>200,000 Euro</b>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Pese vjet		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit

<b>Nr 73</b>	<b>Projekti Q4:O4:PG1:p3:</b> Rehabilitimi i rrjetit shpërndarës të ujit të pijshëm	<b>Tipi i programit Q4:O4:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Rrjeti shpërndarës dhe furnizues me ujë të pijshëm në Shkodër është i vjetër dhe i amortizuar. Rritja e popullsisë së qytetit gjatë kësaj dekade e gjysëm e bën të domosdoshëm ndërtimin e një sistemi të ri shpërndarës.</p> <p>Ky projekt parashikon përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin dhe krijimin e një shërbimi më të mirë për konsumatorin.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe minimizimi i humbjeve në rrjet</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Banorët e qytetit</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Qeveria austriake Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Qeveria austriake Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Ekzistenca e projektit dhe studimi i fizibilitetit për rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm të Shkodrës</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Mungesa e burimeve financiare</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>30,000,000 Euro</b></span></p>		
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Tre vjet</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Pas zbatimit të projektit</p>



<b>Nr 74</b>	<b>Projekti Q4:O4:PG1:p4:</b> Instalimin e pajisjeve ndihmese për menaxhimin e shpërndarjes të ujit të pijshëm	<b>Tipi i programit Q4:O4:PG1:</b> Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe sigurimin e një shpërndarje sa më efektive të ujit të pijshëm është e nevojshme të vendosen matësa uji që të monitorojnë konsumin. Ky projekt synon të vendosë matësa në burime të furnizimit me ujë dhe stacione pompimi, si edhe në shtëpi, biznese dhe institucione publike. Projekti parashikon përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin me qëllim krijimin e një shërbimi më të mirë për konsumatorin.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm Ruajtja e burimeve të ujit		<b>Grupet e synuara</b> Banorët e qytetit
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveria austriake Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Qeveria austriake Bashkia Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit
<b>Para kushtet</b> Ekzistenca e projektit dhe studimi i fizibilitetit për rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm të Shkodrës		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e burimeve financiare
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>		<b>2,500,000 Euro</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit



<b>Nr 75</b>	<b>Projekti Q4:O5:PG1:p1:</b> Rehabilitimi i gjelbërimit në rrugët kryesore të qytetit	<b>Tipi i programit Q4:O5:PG1:</b> Përmirësimi i gjelbërimit të rrugëve të qytetit
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Ky projekt synon të zëvendësojë më shumë se 1,200 drurë dekorativë përgjatë tetë rrugëve kryesore të qytetit si rruga nga Parruca në Xhabiej, rruga “M. Barleti”, rruga “Skënderbeg”, rruga e Teatrit, rruga “Kiras Mehmet”, rruga “Pashë Plaku”, etj.</p> <p>Drurët që do të mbillen do të jenë likustra, blin, rrap dhe gështenjë. Fidanët do të jenë të shëndetshëm dhe rezistent ndaj sëmundjeve.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Rritja e cilësisë së jetesës së qytetarëve Përmirësimi i mjedisit Përmirësimi estetik i rrugëve në qytet</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Komuniteti Qeveria vendore</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Qeveria vendore Komuniteti Donatorë</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Bashkia Komuniteti</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Interesi i qeverisë vendore dhe komunitetit për të mbështetur këtë ide Miratimi nga këshilli bashkiak për hapësirat e gjelbërta si prioritet investimi Gatishmëria e donatorëve për mbështetje financiare dhe teknike</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Buxhet i kufizuar</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>8,500,000 Lekë</b></span></p>		
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Vitet 2005–2007</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Pas 2005</p>



<b>Nr 76</b>	<b>Projekti Q4:O5:PG2:p1:</b> Rehabilitimi i lulishtes pranë Pazarit	<b>Tipi i programit Q4:O5:PG2:</b> Rehabilitimi i lulishteve kryesore publike
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Parku pranë zonës së Pazarit është një nga hapësirat e gjelbërta më të vjetra në qytet. Ai ndodhet midis rrugës kryesore të hyrjes jugore të qytetit dhe shëtitorës buzë molos të lumit Buna. Aktualisht, ka shumë ndërtime pa leje në këtë vend, që ka filluar të përdoret si depozitim mbeturinash nga një komunitet që tradicionalisht e ka përdorur parkun për aktivitete argëtuese dhe për të kaluar kohën e lirë. Ky projekt parashikon pastrimin e 17,000 m <sup>2</sup> lulishte, vendosjen e stolave dekorativë si dhe mbjelljen e gardheve, drurëve dhe shkurreve dekorative për të rikrijuar një mjedis të këndshëm për qytetarët që do të përmirësojë cilësinë e jetës së tyre.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i cilësisë së jetesës së qytetarëve Përmirësimi i mjedisit	<b>Grupet e synuara</b> Komuniteti Qeveria vendore	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Komuniteti Qeveria vendore Donatorë	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Komuniteti vendas	
<b>Para kushtet</b> Interesi i qeverisë vendore dhe komunitetit për të mbështetur këtë ide Miratimi nga këshilli bashkiak për hapësirat e gjelbërta si prioritet investimi Gatishmëria e donatorëve për mbështetje financiare dhe teknike	<b>Faktorë rrezikues</b> Buxhet i kufizuar	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>	<b>3,000,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Vitet 2005–2007	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas 2006	

<i>Nr 77</i>	<b>Projekti Q4:O5:PG2:p2:</b> Rehabilitimi i lulishtes “Luigji Gurakuqi”	<b>Tipi i programit Q4:O5:PG2:</b> Rehabilitimi i lulishteve kryesore publike
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Parku “Luigji Gurakuqi” është një nga zonat e gjelbra më të vjetra në qytetin e Shkodrës. Aktualisht në park janë disa kioska të ndërtuara pa leje. Ky projekt planifikon rikthimin e parkut në kushtet dhe gjendjen e tij të mëparshme si vend për argëtimin e banorëve, veçanërisht për studentët e universitetit.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i cilësisë së jetesës së qytetarëve shkodranë Përmirësimi i mjedisit Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta		<b>Grupet e synuara</b> Banorët Studentet
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Donatorë		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Rajoni i Emilia Romano, Itali
<b>Para kushtet</b> Studimi urban i zonës Projekti teknik		<b>Faktorë rrezikues</b> Financimi i mjaftueshëm
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>13,640,000 Lekë</b></span>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Gjashtë muaj		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit



<b>Nr 78</b>	<b>Projekti Q4:O5:PG3:p1:</b> Ndërtimi i lulishtes brenda bllokut të banimit “Xhabije”	<b>Tipi i programit Q4:O5:PG3:</b> Ndërtimi zonave të reja të gjelbra në zonat e banimit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Zonat e banimit të qytetit të Shkodrës janë të pajisura nga bashkia me zona të gjelbra për argëtim. Fatkeqësisht, shumë nga këto hapësira të gjelbra janë shkatërruar dhe përdoren shpesh si vende depozitimi mbeturinash. Ato tani janë të pakëndshme, të pista dhe të ndotura, duke përbërë kërcënim për shëndetin e banorëve vendas. Në këto kushte bashkia i ka dhënë prioritet përmirësimit të parqeve të gjelbra të qytetit dhe veçanërisht pranë zonës Xhabije sepse ajo ndodhet në hyrjen jugore të qytetit ku një paraqitje e këndshme estetikisht do të vlerësohej si nga banorët dhe nga turistët.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Krijimi i mjediseve zbavitëse për rreth 10 mijë banorë Përmirësimi i mjedisit Përmirësimi estetik i zonës në hyrje të qytetit		<b>Grupet e synuara</b> Komuniteti i lagjes Xhabiej prej 10 mijë banorësh Komunitetet e tjera në qytet
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Banorët e zonës Bizneset vendase OJF mjedisore		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia OJF mjedisore
<b>Para kushtet</b> Studimi urban i zonës		<b>Faktorë rrezikues</b> Disponueshmëria e fondeve
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>1,244,840 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periodha e zbatimit</b> Tre muaj		<b>Periodha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit

<b>Nr 79</b>	<b>Projekti Q4:O5:PG3:p2:</b> Ndërtimi i lulishtes së rrugës “Isuf Sokoli” në bllokun e banimit “Baçja e Çakajve”	<b>Tipi i programit Q4:O5:PG3:</b> Ndërtimi zonave të reja të gjelbra në zonat e banimit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Ky projekt parashikon ndërtimin e një lulishte 1,000 m <sup>2</sup> në zonën midis pallateve në rrugën “Isuf Sokoli”. Në vend do të ndërtohet një lulishte ku do të mbillen drurë dhe shkurre dekorative, barë natyral si dhe do të pajiset me stola dekorativë. Kjo lulishte do tu shërbejë të gjithë banorëve të zonës.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve Përmirësimi i mjedisit	<b>Grupet e synuara</b> Komuniteti Qeveria vendore	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Komuniteti Qeveria vendore Donatorë	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Donatorë Bashkia Komuniteti	
<b>Para kushtet</b> Interesi i qeverisë vendore Miratimi i këshillit bashkiak për hapësirat e gjelbërta si prioritet investimi Mbështetja e komunitetit	<b>Faktorë rrezikues</b> Buxhet i kufizuar	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>2,000,000 Lekë</b></span>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	



<b>Nr 80</b>	<b>Projekti Q4:O5:PG3:p3:</b> Ndërtimi i lulishtes në lagjen “Zdrale”	<b>Tipi i programit Q4:O5:PG3:</b> Ndërtimi zonave të reja të gjelbra në zonat e banimit
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Zdrale është një nga zonat shumë të rëndësishme të qytetit ku ndodhen zona banimi, stadiumi i qytetit dhe tregu industrial i shitjes me pakicë. Ky projekt parashikon ndërtimin e një parku në lagjen të dekoruar me pemë, shkurre barë natyral dhe stola dekorativ.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i cilësisë së jetesës të banorëve Përmirësimi i mjedisit të zonës		<b>Grupet e synuara</b> Komuniteti Qeveria vendore
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveria vendore Komuniteti Donatorë		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Komuniteti
<b>Para kushtet</b> Interesi i qeverisë vendore Miratimi i këshillit bashkiak për hapësirat e gjelbërta si prioritet investimesh Interesi i komunitetit		<b>Faktorë rrezikues</b> Buxhet i kufizuar
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>		<b>3,700,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Gjashtë muaj		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit

<b>Nr 81</b>	<b>Projekti Q4:O6:PG1:p1:</b> Ndërtimi i vend-depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane	<b>Tipi i programit Q4:O6:PG1:</b> Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta bashkiake
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Aktualisht, vlerësohet që qyteti i Shkodrës prodhon rreth 40,000 ton mbeturina të ngurta urbane në vit. Mbledhja e mbeturinave akoma kryhet me metoda primitive, dhe mbeturinat depozitohen në mënyrë të papërshtatshme në një vend pranë lumit Kir, krejtësisht jashtë kushteve teknike. Kur niveli i ujit në lumë rritet, një pjesë e madhe e mbeturinave shpërndahet ose bartet duke krijuar një ndotje të madhe të mjedisit përreth dhe gjatë gjithë rrjedhjes së lumit Kir, që vazhdon më pas në lumenjtë Drin dhe Bunë. Në veçanti, shëndeti i banorëve të zonës verilindore të qytetit është i rrezikuar seriozisht nga djegia lokale e mbeturinave në vend-depozitimin ekzistues.</p> <p>Qëllimi i këtij projekti është ndërtimi i një vend-depozitimi të ri të mbeturinave të ngurta urbane, që do të plotësojë nevojat e qytetit për një periudhë 10–vjeçare. Vëllimi i mbetjeve që do të përballohet nga ky vend-depozitim do të jetë rreth 400,000 m<sup>3</sup> i ndarë në katër pjesë të barabarta.</p> <p>Puna e planifikuar përfshin: gërmime, përgatitja dhe izolimi i terrenit, ndërtimi i sistemit të kanaleve kulluese dhe izolimi i acideve dhe alkaleve, përmirësimi dhe menaxhimi i burimeve ujore, nxjerrja e biogazit, rregullimi i hyrjes në dhe zonës së shërbimit, rregullimi i katër gypave për monitorimin e niveleve të ujërave nëntokësorë dhe rregullimi i zonës së gjelbër, grumbullimi i ujërave sipërfaqësorë.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Grumbullimi i mbetjeve urbane Transporti i mbetjeve larg zonave të banuara Ndërtimi i vend-depozitimit</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Të gjithë banorët e qytetit</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Bashkia</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>SEENET, Itali Bashkia</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Studimi urbanistik i zonës Miratimi nga këshilli bashkiak</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Buxhet i kufizuar</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b> <b>62,500,000 Lekë</b></p>		
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Një vit</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Pas zbatimit të projektit</p>



<b>Nr 82</b>	<b>Projekti Q4:O6:PG1:p2:</b> Përmirësimi i teknologjisë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve të ngurta urbane	<b>Tipi i programit Q4:O6:PG1:</b> Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta bashkiake
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Shkodra prodhon rreth 250 m <sup>3</sup> mbeturina në ditë nga një qytet me sipërfaqe afro 1,600 ha dhe popullsi prej 110,000 banorë. Qëllimi i këtij projekti është të pastrojë dhe ta mbajë qytetin sa më pastër që të jetë e mundur. Objektivat specifike janë: furnizimi me kontenierë për grumbullimin e mbetjeve urbane dhe blerjen e automjeteve teknologjike për mbledhjen e tyre. Që të përmirësohet shërbimi i pastrimit të qytetit një studim i mëparshëm ka parashikuar se nevojiten: 600 kontenierë secili me kapacitet 1,100 litra dhe dy automjete me kapacitet 1,100 litra; 50 kontenierë 5 m <sup>3</sup> me dy automjete të këtij kapaciteti.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Heqja e mbeturinave nga pikat e grumbullimit çdo dite Qytet i pastër, jo i ndotur Rritja e sigurisë dhe e shëndetit të qytetarëve	<b>Grupet e synuara</b> Bashkia Banorët Bizneset	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Bizneset vendase	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia	
<b>Para kushtet</b> Përgatitja e një projekti teknik urban për shpërndarjen sipas ndarjes së qendrave të pikave të grumbullimit të mbetjeve	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e ndërgjegjësimit të popullatës dhe ushtrimi i ligjeve	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> Kontenier (1,100 litra) x 600 Kontenier (5 m <sup>3</sup> ) x 50 Automjete (për 1,100 litra kontenier) x 2 Automjete (për 5 m <sup>3</sup> kontenier) x 2 <b>Totali</b>	18,000,000 Lekë 6,000,000 Lekë 22,000,000 Lekë 10,000,000 Lekë <b>56,000,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike		
<b>Periudha e zbatimit</b> Tre muaj	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	



<b>Nr 83</b>	<b>Projekti Q4:O6:PG1:p3:</b> Fushatë sensibilizuese për një qytet të pastër	<b>Tipi i programit Q4:O6:PG1:</b> Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta bashkiake
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Në vitet e fundit, ka një rritje të sasive të mbeturinave të prodhuara në qytetin e Shkodrës jo vetëm si rezultat i rritjes së popullsisë, zhvillimit industrial dhe rritjes së konsumimit të mallrave, por edhe si rezultat i veprimeve të papërgjegjshme nga ana e qytetarëve dhe të bizneseve. Kjo gjë ka ndikuar ndjeshëm në nivelin e ndotjes në qytet dhe ka dëmtuar mjedisin, rezultat i sistemit të dobët të kanaleve kulluese dhe të ujërave të zeza, si dhe të mosfunksionimit të koshave të hedhjes së mbeturinave.</p> <p>Është parashikuar që ky projekt do të zbatohet në 4 faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Fotografimi dhe filmimi i vendeve publike të dëmtuara ose të ndotura (parqe, rrugë, trotuare), të kazanëve të hedhjes së mbeturinave, të sistemeve të kanaleve kulluese dhe të ujërave të zeza;</li> <li>2) Dizenjimi dhe shtypja e posterave dhe fletëpalosjeve;</li> <li>3) Prodhimi i një spoti publicitar me një kohëzgjatje prej 4 min;</li> <li>4) Realizimi në shkollë i një fushate sensibilizuese për problemin.</li> </ol>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mjedis më i pastër Kosha mbeturinash të ripërdorshme Qytetarë më të ndërgjegjësuar Biznese më të ndërgjegjësuar</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Qytetarët Bizneset (të vogla, të mëdha) Institucionet Shoqatat</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Drejtoria Informimit dhe Zhvillimit Drejtoria e Shërbimeve Publike Agjencia Rajonale e Mjedisit Ndërmarrja publike e pastrimit të qytetit</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Bashkia Ndërmarrja publike e pastrimit të qytetit</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Iniciativa e bashkisë për një qytet të pastër Legjislacioni në fuqi Ekzistenca e Shoqatave Mjedisore</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Ndërgjegjësimi i pakët i banorëve dhe mungesa e detyrimeve</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b></p>		<p><b>384,600 Lekë</b></p>
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Gjergj Kurti, Departamenti i Informimi të Publikut</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Gjashtë muaj</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Pas zbatimit të projektit</p>



<b>Nr 84</b>	<b>Projekti Q5:O1:PG1:p1:</b> Ngritja në qytet e një qendre për të rinjtë	<b>Tipi i programit Q5:O1:PG1:</b> Ndërtimi i mjediseve të reja publike argëtuese dhe për aktivitete sportive, si dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Ky projekt synon në ndërtimin e një qendre me mjedise moderne që do t'i japë mundësi rinisë së qytetit të kryejë aktivitete edukuese, sociale dhe kulturore, duke i rikthyer qytetit një traditë të vjetër të munguar në vite që i kushtonte më shumë vëmendje fëmijëve të tij. Ndërtesa do të shërbejë për të identifikuar dhe krijuar talentet e reja në qytet. Është planifikuar që ndërtesa të ndërtohet Qendra e Fëmijëve dhe do të ketë shumë funksione: si qendër fëmijësh, qendër kulturore, qendër përkujtimore "P. Gaci", galeri artesh figurative, qendër rinore dhe për organizimin e konferencave.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Ndërtimi i një qendre moderne shumëfunktionale për qytetin Zgjerimi i mundësive për të rinjtë Zgjerimi i mundësive për qytetin	<b>Grupet e synuara</b> Rinia e qytetit Grupet artistike Artistët	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveria vendore Donatorë të huaj	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Shoqata "St Gallen Hilft Albanien"	
<b>Para kushtet</b> Disponueshmëria e projektit Kërkesat në vazhdim të të rinjve	<b>Faktorë rrezikues</b> Buxhet lokal i kufizuar	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>	<b>30,000,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Alfred Luleta, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në bashki Elena Zorba, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Vitet 2006–2009	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> 2009 e në vazhdim	

<b>Nr 85</b>	<b>Projekti Q5:O1:PG1:p2:</b> Rehabilitimi i mjediseve sportive në shkollat e qytetit	<b>Tipi i programit Q5:O1:PG1:</b> Ndërtimi i mjediseve të reja publike argëtuese dhe për aktivitete sportive, si dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<p>Qellimi i përgjithshëm i këtij projekti është krijimi i kushteve të përshtatshme për rritjen e numrit të aktiviteteve sportive dhe numrit të pjesëmarrjes së nxënësve të sistemit të shkollave publike të qytetit.</p> <p>Objektivi specifik i këtij projekti është ndërtimi 6 fushave sportive në 6 shkolla si vijon: Shkolla 9-vjeçare “Ndoc Mazi” Rajoni 5, Shkolla 9-vjeçare “Branko Kadia” Rajoni 3, Shkolla 9-vjeçare “Azem Hajdari” Rajoni 2, Shkolla 9-vjeçare “Ismail Qemali” Rajoni 1, Shkolla 9-vjeçare “Ndre Mjeda” Rajoni 1, Shkolla e mesme e përgjithshme “28 Nëntori” Rajoni 4.</p> <p>Aktualisht infrastruktura e terreneve sportive të shkollave nuk është në gjendje të mire dhe në mjaft prej tyre rezulton plotësisht e shkatërruar. Ky projekt parashikon përmirësimin e kësaj situate dhe është i shtrire në të gjithë territorin e qytetit.</p>		
<b>Rezultatet e pritshme</b>	Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive Shtimi i numrit të aktiviteteve sportive Shtimi i numrit të pjesëmarrësve në aktivitetet sportive	<b>Grupet e synuara</b> Nxënësit e shkollës
<b>Aktorët e mundshëm</b>	Bashkia Federata Shqiptare e Futbollit Drejtoria Arsimore Rajonale	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Federata Shqiptare e Futbollit
<b>Para kushtet</b>	Disponueshmëria e tokës	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë financimi
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>		<b>1,800,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b>		
Elena Zorba, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore		
<b>Periudha e zbatimit</b>	Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit



<b>Nr 86</b>	<b>Projekti Q5:O1:PG1:p3:</b> Ndërtimi i këndeve publike dhe private të lojrave	<b>Tipi i programit Q5:O1:PG1:</b> Ndërtimi i mjediseve të reja publike argëtuese dhe për aktivitete sportive, si dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Ky projekt synon të rritë hapësirën për argëtim në dispozicion të banorëve në zona të veçanta të qytetit. Ai do të zhvillohet në bazë të studimeve të veçanta urbane për zona specifike. Plani parashikon krijimin dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbra, si dhe ndërtimin e mjediseve të reja për banorët e atyre zonave. Studimet, lidhur me nevojat për mjediset e lojës, duhet të planifikohen sipas standardeve normale të aprovuara.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Shtimi i numrit të hapësirave të gjelbra Shtimi i sipërfaqeve të hapësirave argëtuese		<b>Grupet e synuara</b> Banorët e qytetit Bashkia
<b>Aktorët e mundshëm</b> Donatorë të ndryshëm Banorët e zonave përreth Bashkia		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Donatorë
<b>Para kushtet</b> Studimi dhe zhvillimi i Planeve të Pjesshme Urbane		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë financimi
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>		<b>5,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Inspektori i Sporteve në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Gjashtë muaj		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Menjëherë

<b>Nr 87</b>	<b>Projekti Q5:O1:PG1:p4:</b> Ndërtimi i sallës së mbyllur të atletikës	<b>Tipi i programit Q5:O1:PG1:</b> Ndërtimi i mjediseve të reja publike argëtuese dhe për aktivitete sportive, si dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Përmirësimi i cilësisë sportive të atletëve të rrethit të Shkodrës dhe krijimi i premisave për vazhdimësinë e rezultateve të shkëlqyera kërkon përmirësimin e infrastrukturës aktuale sportive. Ndërtimi i një salle atletike të mbyllur, brenda stadiumit ekzistues të futbollit me 6 krosi 110 m të gjata dhe do të lehtësojë stërvitjen në të gjitha tipet e motit dhe do të përmirësojë rendimentet individuale dhe të ekipit.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Rritja e rendimentit sportiv të atleteve të qytetit Rritja e numrit të atletëve amatorë		<b>Grupet e synuara</b> Klubet sportive Komuniteti i zonës Studentët
<b>Aktorët e mundshëm</b> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Donatorë të ndryshëm		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Donatorë
<b>Para kushtet</b> Përgatitja e projektit teknik Angazhimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve		<b>Faktorë rrezikues</b> Buxheti i vogël Mungesë donacionesh
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>20,000,000 Lekë</b></span>		
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Inspektori sportive në bashki Menaxheri i klubit të futbollit “Vllaznia”		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit



<b>Nr 88</b>	<b>Projekti Q5:O1:PG1:p5:</b> Ndërtimi i palestrës së mundjes	<b>Tipi i programit Q5:O1:PG1:</b> Ndërtimi i mjediseve të reja publike argëtuese dhe për aktivitete sportive, si dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Mundja është një nga sportet më popullore në qytet. Ekipi i qytetit tradicionalisht ka qenë shumë mirë në konkurset vendase, kombëtare dhe ndërkombëtare. Megjithatë, nuk ka një mjedis stërvitor për ekipet dhe ndërtimi i një mjedisi të tillë do të ishte i domosdoshëm për sukseset e ardhshme në këtë sport. Projekti do të kërkojë heqjen e dheut, ndërtimin e palestrës, kryerjen e hidro-izolimit, vendosjen e dritareve, dyerve, etj.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Ofrimi i kushteve të stërvitjes Arritja e rezultateve të larta sportive	<b>Grupet e synuara</b> Ekipi i mundjes Sportistë amatorë	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Donatorë të ndryshëm	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	
<b>Para kushtet</b> Disponueshmëria e projektit teknik	<b>Faktorë rrezikues</b> Buxhet i pamjaftueshëm lokal Mbështetje e pakët nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Mungese donacionesh	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>		<b>5,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Inspektori i sporteve në bashki Drejtori i klubit të sportiv “Vllaznia”		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit	

<b>Nr 89</b>	<b>Projekti Q5:O2:PG1:p1:</b> Zhvillimi i kampionateve amatore sportive mes shkollave 9-vjeçare, atyre të mesme dhe për të rritur në stinët e Pranverës dhe të Vjeshtës	<b>Tipi i programit Q5:O2:PG1:</b> Stimulimi dhe promovimi i aktiviteteve sportive në qytet
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do të zhvillojnë kampionatet sportive të pranverës dhe të vjeshtës ku do të marrin pjesë të 32 shkollat publike të qytetit. Kampionatet do të jenë konstruktive, aktivitete të shëndetshme dhe do të përmirësojnë shëndetin e fëmijëve të qytetit. Çdo sezon do të zgjasë rreth 3 ose 4 muaj duke përfunduar kampionatin në një natë finale.</p> <p>Është planifikuar të ketë ndeshje basketbolli, futbollit dhe volejbollit. Gjatë sezonit çdo ekip do të luajë të paktën një ndeshje në javë kundër një shkolle tjetër. Skuadrat do të drejtohen nga një vullnetar ose mësues dhe kur të jetë e mundur, ekipi do të ketë një sponsor që do të sigurojë mjete dhe pajisje sportive, si dhe do të paguajë taksat e fushës në këmbim të reklamës.</p> <p>Kampionatet do të jenë mbikëqyren nga një komision i formuar nga prindër, mësues, drejtuesit e shkollave dhe përfaqësues nga Ministria Arsimit dhe Bashkia.</p>		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Zvogëlimi i aktivitetit kriminal dhe përdorimit të drogës në shkollat e qytetit Përmirësimi i shëndetit mendor dhe fizik për fëmijët e qytetit Shtimi i kulturës sportive në rininë e qytetit		<b>Grupet e synuara</b> Nxënësit vendas
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Bizneset vendase Ministria e Shëndetësisë		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Bizneset vendase Ministria e Shëndetësisë
<b>Para kushtet</b> Mbështetje nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Marrëveshje me pronarët e fushave sportive		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë sponsorësh
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
Shpenzime për fushat sportive		4,608,000 Lekë
Shpenzime për skuadrat		2,000,000 Lekë
Pagat për arbitrat		1,440,000 Lekë
Shpenzime administrative		1,500,000 Lekë
<b>Totali</b>		<b>9,548,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Beb Kurti, Specialist i Sektorit të Sportit		
<b>Periudha e zbatimit</b> Katër muaj		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas vjeshtës 2005



<b>Nr 90</b>	<b>Projekti Q5:O3:PG1:p1:</b> Informatizimi i Zyrës së Gjendjes Civile	<b>Tipi i programit Q5:O3:PG1:</b> Modernizimi i shërbimit të gjendjes civile
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Zyra e gjendjes civile e qytetit të Shkodrës i shërben rreth 110,000 mije qytetareve. I gjithë dokumentacioni baze i zyrës së gjendjes civile përbëhet nga 289 regjistra themeltare. I gjithë procesi i punës kryhet në mënyre manuale. Meqenëse kërkesat nga qytetaret për shërbime të ndryshme që ofron kjo zyre janë shume të mëdha, shërbimi i ofruar qytetareve nuk është në cilësinë e dëshiruar duke krijuar vonesa të tejzgjatura. Për zgjidhjen e këtij problemi ky projekt parashikon: Informatizimin i Zyrës së Gjendjes Civile. Kjo do të rriste cilësinë e shërbimit dhe futjen e një standarti të ri në shërbimet e kryera nga Zyra e Gjendjes civile.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve Reduktimi i vonesave	<b>Grupet e synuara</b> Banorët	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Ministria e Pushtetit vendor dhe e Decentralizimit Bashkia Donatorë të ndryshëm	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Punëve të Brendshme	
<b>Para kushtet</b> Ekzistenca e programit qeveritar për kompjuterizimin e gjithë zyrave të gjendjes civile në vend Ekzistenca e regjistrave themeltarë të zyrave zyra e gjendjes civile	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesë e standardeve të rezultatit Mungesë financimi	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
Server	300,000 Lekë	
Kompjuterat (10 x 80,000 Lekë)	800,000 Lekë	
Rrjeti kompjuterik	70,000 Lekë	
Printer rrjeti	100,000 Lekë	
Krijimi i bazës dhe futjes së të dhënave	1,000,000 Lekë	
<b>Totali</b>	<b>2,270,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Vera Gradeci, Shefe e Zyrës së Zyra e gjendjes civile		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	



<b>Nr 91</b>	<b>Projekti Q5:O3:PG1:p2:</b> Krijimi i sistemit të adresave të Bashkisë Shkodër	<b>Tipi i programit Q5:O3:PG1:</b> Modernizimi i shërbimit të gjendjes civile
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Sistemi aktual i adresave të qytetit të Shkodrës nuk funksionon, është i vjetër dhe nuk pasqyron ndryshimet e rëndësishme urbane që kanë ndodhur në qytet që prej vitit 1974. Zbatimi i këtij projekti do të qartësojë adresat e qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve. Aktivitetet e planifikuara për zbatimin e këtij projekti janë: Krijimi i një ekipi të përbërë nga punonjës të Zyrës së Gjendjes Civile, Drejtorisë Urbanistike, Juristë, Historianë; Hartimi i orientimeve vendosjen e emrave të rrugëve dhe numrave të ndërtesave të qytetit; Katologimi i situatës ekzistuese, banesave, bizneseve, institucioneve publike, etj; Krijimi i sistemit të ri të adresave për emërtimin e zonave të qarkullimit, për vendosjen e shenjave rrugore, për vendosjen e numrave të ndërtesave dhe pajisja e tyre me shenja të bëra me material rezistues ndaj çdo moti; Krijimi i një katalogu dixhital për adresat.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Krijimi i bazës së të dhënave dhe kompjuterizimi i zyrës së gjendjes civile Identifikimi i saktë i të gjithë taksapaguesve Krijimi i shërbimit postar eficient	<b>Grupet e synuara</b> Bashkia Shkodër Qytetarët Bizneset Institucionet publike	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia Ministria e Punëve të Brendshme	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia Ministria e Punëve të Brendshme	
<b>Para kushtet</b> Vendimi i qeverisë Shqiptare për krijimin e sistemit të adresave Harta dixhitale e qytetit Projekti i sinjalistikës së rrugëve të qytetit	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e financimit	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b>	<b>3,000,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Frederik Shiroka, Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës në bashki		
<b>Periudha e zbatimit</b> Një vit	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	



<b>Nr 92</b>	<b>Projekti Q5:O3:PG2:p1:</b> Kryerja e studimit për vlerësimin e situatës sociale për banorët Shkodrës	<b>Tipi i programit Q5:O3:PG2:</b> Përmirësimi dhe shtimi i numrit të shërbimeve sociale që ofrohen për komunitetin
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit:</b> Projekti “Vlerësimi i situatës sociale në qytetin e Shkodrës dhe zbatimi i shërbimeve të mundshme sociale” është një aktivitet parapërgatitor që i paraprin zbatimit të aktiviteteve për ofrimin e shërbimeve sociale ndaj grupeve në nevojë. Ky projekt do të vlerësojë dhe analizojë në detaje shkallën e varfërisë, numrin dhe shpërndarjen e grupeve në rrezik dhe nevojat e tyre, si dhe do të identifikojë mjetet dhe tipin e ndërhyrjeve të nevojshme. Projekti do të përcaktojë nivelet e ofertës dhe kërkesës të shërbimeve sociale dhe do të ofrojë zgjidhjet si të iniciojë ekuilibrin e këtij raporti.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Identifikimin i grupeve në nevojë, numri dhe shpërndarja Përcaktimi dhe vlerësimi i treguesve me të cilët përfaqësohet varfëria dhe përjashtimi social Përcaktimi dhe vlerësimi i shkaqeve kryesore të varfërisë dhe përjashtimit social Monitorimi dhe vlerësimi i nevojave të grupeve në risk dhe shkalla e plotësimit të tyre nga qeveria dhe OJF		<b>Grupet e synuara</b> Familjet e varfra Fëmijët në nevojë ose në rrezik Gratë në nevojë ose në rrezik Personat më aftësi të kufizuar në nevojë
<b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia OJF vendore OJF ndërkombëtare Universiteti		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Bashkia
<b>Para kushtet</b> Gatishmëria e qeverisë vendore dhe OJF partnere për të marre pjese aktive gjatë zbatimit të projektit		<b>Faktorë rrezikues</b> Vonesa në krijimin e sektorëve të shërbimeve sociale dhe të kujdesit shëndetësor pranë qeverisë vendore
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
Pagat		3,500,000 Lekë
Transportit		150,000 Lekë
Publikimi		350,000 Lekë
<b>Totali</b>		<b>4,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Voltana Ademi, Nënkryetare e bashkisë		
<b>Periudha e zbatimit</b> Gjashtë muaj		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Tre vjet

<b>Nr 93</b>	<p><b>Projekti Q5:O3:PG2:p2:</b> Rritja e kapaciteteve në administratën bashkiake dhe OJF vendore për ofrimin e shërbimeve sociale</p>	<p><b>Tipi i programit Q5:O3:PG2:</b> Përmirësimi dhe shtimi i numrit të shërbimeve sociale që ofrohen për komunitetin</p>
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> NET EUROPEO di WELFARE (N.E.W.) është një projekt që zhvillohet në kuadër të INTERREG IIIA Transfrontaliero Adriatico financiar nga Komisioni Evropian. Objektivi kryesor i këtij projekti është të mbështetë krijimin dhe forcimin e shërbimeve sociale në nivelin e qeverisë vendore në disa bashki të Shqipërisë, Bosnjës dhe Serbisë. Për të arritur këtë qëllim, programi synon forcimin e kapaciteteve të institucioneve vendore dhe kombëtare dhe të OJF, në zbatimin e legjislacionit të ri në fushën e shërbimeve sociale, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese të punonjësve sociale në programimin, zbatimin dhe administrimin e shërbimeve sociale gjatë procesit të decentralizimit. Ky projekt do të zbatohet gjatë një periudhe 3-vjeçare, nga 2004 deri 2006 dhe do të menaxhohet nga provinca e Forli-Cesenes, Itali.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b> Krijimi i qendrës për trajnim në fushën e shërbimeve sociale, të stafit të administratës publike dhe OJF-ve Krijimi i rrjetit për shkëmbime mes stafit të qeverisë vendore dhe qendrore, OJF, të informacioneve &amp; eksperiencave në çështjet e shërbimeve dhe politikave sociale, shëndetit, biznesit dhe çështjeve gjinore Organizimi i trajnimeve, grumbullimi e analizimi i të dhënave për studime sociale, sanitare dhe psikosociale, etj. Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve Organizimi i seminareve &amp; takimeve për shërbimet sociale, sanitare &amp; decentralizimin</p>		<p><b>Grupet e synuara</b> Qeveria qendrore Qeveria vendore OJF</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b> Bashkia MPÇSShB OJF vendore Provinca e Forli-Çezenes, Itali Drejtoria Arsimore Rajonale</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Komisioni Evropian Bashkia Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta</p>
<p><b>Para kushtet</b> Gatishmëria e qeverisë vendore &amp; OJF partnere për të marrë pjesë aktive në zbatimin e projektit</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b> Vonesa në krijimin e sektorit të shërbimeve sociale dhe të kujdesit shëndetësor lokal</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b> <b>Totali</b></p>		<p><b>113,500,000 Lekë</b></p>
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b> Voltana Ademi, Nënkryetare e bashkisë</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b> Qershor 2004 deri në qershor 2006</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Afat gjatë</p>



<b>Nr 94</b>	<b>Projekti Q5:O3:PG2:p3:</b> Ngritja e tre qendrave sociale për grupet e mënjanuara të komunitetit dhe ofrimi i shërbimeve sociale në bashkëpunim mes Bashkisë dhe OJF vendore	<b>Tipi i programit Q5:O3:PG2:</b> Përmirësimi dhe shtimi i numrit të shërbimeve sociale që ofrohen për komunitetin
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Projekti “Shpërndarja e Shërbimeve Sociale” për herë të parë në Shkodër do t’i japë mundësi qeverisë vendore të bashkëpunojë me disa OJF që të ofrojë shërbime sociale alternative për komunitetin. Rezultat i këtij projekti do të jetë ngritja e tri qendrave që do të ofrojnë shërbime sociale për grupet e pambrojtura dhe papërkrahje të shoqërisë, si fëmijët, gratë dhe të moshuarit. Banka Botërore në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ka përzgjedhur tri organizata jofitimprurëse që veprojnë në qytet për të bashkëpunuar dhe ndihmuar bashkinë për krijimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale. Qendrat e planifikuara janë: Qendër multi-disiplinare, ngritur në bashkëpunim me “The Door”; Qendër sociale për fëmijët dhe familjet në vështirësi, në bashkëpunim me “The Child”; Qendër ditore për të moshuarit, ngritur në bashkëpunim me “Human Dimension”.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Ndërtimi i tri qendrave sociale për komunitetin Ofrimi i shërbimeve sociale për komunitetin Trajnimi i stafit vendor për menaxhimin e qendrave Reduktimi i varfërisë Përfshirja e qeverisë vendore të decentralizuar	<b>Grupet e synuara</b> Fëmijët që përballen me vështirësi sociale dhe ekonomike, nënat e reja, nënat kryefamiljare, gratë e abuzuara ose të papuna, etj Te moshuarit e sëmurë ose të vetmuar, etj.	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Qeveria vendore MPÇSShB Banka Botërore OJF vendore The Door; Every Child; Human Dimension OJF ndërkombëtare Biznesi vendas	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Banka Botërore Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta	
<b>Para kushtet</b> Vullneti politik i MPÇSShB që të përgatisë ligjin për decentralizimin e shërbimeve sociale Gatishmëria e qeverisë vendore	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e ekspertizës në ofrimin e shërbimeve sociale për komunitetin Buxhet lokal i kufizuar	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b> Qendra e Shërbimeve Sociale për fëmijët dhe familjet Qendër ditore për të moshuarit <b>Total</b>	 13,569,000 Lekë 8,800,000 Lekë <b>22,369,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Voltana Ademi, Nënkryetare e bashkisë		
<b>Periudha e zbatimit</b> Janar 2005	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Afat gjatë	

<b>Nr 95</b>	<b>Projekti Q5:O4:PG1:p1:</b> Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore në lagjen “Tre Heronjtë”	<b>Tipi i programit Q5:O4:PG1:</b> Përmirësimi i shërbimit shëndetësor parësor në qytet
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Qendra e kujdesit shëndetësor e lagjes “Tre heronjtë” të Shkodrës, ofron vizita të përgjithshme dhe trajtime mjekësore për të rriturit. Kjo qendër aktualisht është shumë e shkatërruar. Suvatimet e brendshme, dyert dhe dritaret duhet të zëvendësohen, dhe kushtet higjienike dhe sanitare janë të mjerueshme.</p> <p>Ky projekt planifikon ta korrigjojë këtë situatë të tmerrshme duke kryer risuvatimi e të gjitha mureve të brendshme, vendosjen e dyerve dhe dritareve të reja, si dhe instalimin e pajisjeve të reja të pastrimit.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Përmirësimi i kushteve higjeno-sanitare të qendrës</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Banorët e lagjes</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Zyra e Kujdesit të Shëndetit Parësor Ministria e Shëndetësisë</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Ministria e Shëndetësisë</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Prioritetet e përcaktuara nga Zyra e Kujdesit të Shëndetit Parësor</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Mungesa e financimit</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>3,000,000 Lekë</b></span></p>		
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Tahir Sadiku, Drejtor i Zyrës së Kujdesit të Shëndetit Parësor</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Pesë muaj</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Pas zbatimit të projektit</p>



<b>Nr 96</b>	<b>Projekti Q5:O4:PG1:p2:</b> Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore në lagjen “Partizani”	<b>Tipi i programit Q5:O4:PG1:</b> Përmirësimi i shërbimit shëndetësor parësor në qytet
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Qendra e kujdesit shëndetësor në lagjen “Partizani” ofron shërbim për një popullsi prej 15,000 banorësh. Qendra ofron shërbime të kujdesit shëndetësor për gratë dhe fëmijët. Fatkeqësisht, qendra është shkatërruar keq dhe pajisjet e pastrimit nuk funksionojnë. Dritaret janë të thyera, ndërkohë që pjesa më e madhe e mureve të brendshëm ka nevojë të risuvatohen. Është e papranueshme për një qendër shëndetësore të mos ketë tualete. Ky projekt parashikon të kryejë risuvatin dhe lyerjen e mureve të brendshme, zëvendësimin e dritareve dhe krijimin e kushteve të pranueshme higjieno–sanitare për personelin dhe konsumatorët.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare në qendrën e kujdesit shëndetësor dhe përmirësimi i shërbimeve	<b>Grupet e synuara</b> Gratë dhe fëmijët e lagjes Partizani	
<b>Aktorët e mundshëm</b> Zyra e Kujdesit të Shëndetit Parësor Ministria e Shëndetësisë	<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Ministria e Shëndetësisë	
<b>Para kushtet</b> Prioritetet e përcaktuara nga Zyra e Kujdesit të Shëndetit Parësor	<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e financimit	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>	<b>1,500,000 Lekë</b>	
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Tahir Sadiku, Drejtor i Zyrës së Kujdesit të Shëndetit Parësor		
<b>Periudha e zbatimit</b> Pesë muaj	<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit	

<b>Nr 97</b>	<b>Projekti Q5:O4:PG1:p3:</b> Rikonstruksion i qendrave shëndetësore në Zogaj dhe Shirokë	<b>Tipi i programit Q5:O4:PG1:</b> Përmirësimi i shërbimit shëndetësor parësor në qytet
<p><b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p> <p>Shiroka dhe Zogaj janë dy fshatra pushimi klimaterike buzë liqenit që ndodhen pak larg nga qyteti i Shkodrës. Gjithsesi, ato janë nën juridiksionin e qytetit (në njësinë administrative Nr. 1). Shiroka ndodhet rreth 3 km nga qendra e qytetit, ndërsa ajo e Zogaj është rreth 5 km. Mjediset në qendrat e kujdesit shëndetësor në këto dy lagje janë shkatërruar keq si brenda ashtu edhe jashtë: dyert dhe dritaret duhet të zëvendësohen, ndërsa pajisjet e pastrimit janë jashtë përdorimit.</p> <p>Ky projekt planifikon të rehabilitojë qendrat e kujdesit shëndetësor dhe të vendosë pajisje të reja të pastrimit.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Përmirësimi i kujdesit shëndetësor të ofruar për banorët dhe vizitorët e zonave</p>		<p><b>Grupet e synuara</b></p> <p>Banorët Shkollat në Shirokë dhe Zogaj</p>
<p><b>Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Drejtoria e Kujdesit të Shëndetit Parësor Ministria e Shëndetësisë</p>		<p><b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b></p> <p>Ministria e Shëndetësisë</p>
<p><b>Para kushtet</b></p> <p>Ekzistenca e projektit teknik gati për zbatim</p>		<p><b>Faktorë rrezikues</b></p> <p>Mungesa e financimit</p>
<p><b>Shpenzimet e llogaritura</b></p> <p><b>Totali</b> <span style="float: right;"><b>2,500,000 Lekë</b></span></p>		
<p><b>Personi i kontaktit për projektin</b></p> <p>Tahir Sadiku, Drejtor i Zyrës së Kujdesit të Shëndetit Parësor</p>		
<p><b>Periudha e zbatimit</b></p> <p>Gjashtë muaj</p>		<p><b>Periudha e pritjes së rezultatit</b></p> <p>Pas zbatimit të projektit</p>



<b>Nr 98</b>	<b>Projekti Q5:O4:PG1:p4:</b> Ndërtimi i një qendre shëndetësore në lagjen “Vojo Kushi”	<b>Tipi i programit Q5:O4:PG1:</b> Përmirësimi i shërbimit shëndetësor parësor në qytet
<b>Përshkrim i shkurtër i projektit</b> Qendra e kujdesit shëndetësor e lagjes “Vojo Kushi” ofron vizita të përgjithshme dhe trajtime mjekësore për të rriturit. Qendra tani është shkatërruar shumë keq. Pjesa më e madhe e suvatimeve ka rënë, dyert dhe dritaret kanë nevojë të zëvendësohen, ndërkohë që pajisjet e pastrimit janë jashtë përdorimit. Ky projekt planifikon të realizojë suvatimin e të gjitha mureve të brendshme, të vendosë dyert dhe dritaret e reja, si dhe të vendosë pajisjet e reja të pastrimit.		
<b>Rezultatet e pritshme</b> Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare të qendrës		<b>Grupet e synuara</b> Banorët e lagjeve
<b>Aktorët e mundshëm</b> Zyra e Kujdesit të Shëndetit Parësor Ministria e Shëndetësisë		<b>Kontribuesit e mundshëm në projekt</b> Ministria e Shëndetësisë
<b>Para kushtet</b> Prioritetet e përcaktuara nga Zyra e Kujdesit të Shëndetit Parësor		<b>Faktorë rrezikues</b> Mungesa e financimit
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Totali</b>		<b>3,000,000 Lekë</b>
<b>Personi i kontaktit për projektin</b> Tahir Sadiku, Drejtor i Zyrës së Kujdesit të Shëndetit Parësor		
<b>Periudha e zbatimit</b> Pesë muaj		<b>Periudha e pritjes së rezultatit</b> Pas zbatimit të projektit



## **Aneksi 1: Shkurtime e përdorura në Matricën e Zbatimit**

<b>AQ</b>	Artistët e Qytetit	<b>KB</b>	Komuniteti i Biznesit
<b>AR</b>	Agjencitë e Reklamave	<b>KESh</b>	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a
<b>ARM</b>	Agjencia Rajonale e Mjedisit	<b>KL</b>	Komuniteti lokal
<b>ASh</b>	Arkivi i Shtetit	<b>KM</b>	Komuniteti Muzikor i Shkodrës
<b>AT</b>	Agjencitë Turistike	<b>KV</b>	Komuna e Venecias
<b>B</b>	Bashkia	<b>KS</b>	Klubet Sportive
<b>BA</b>	Biznesi Artizanal	<b>KShk</b>	Komuniteti Shkencor
<b>BB</b>	Banka Botërore	<b>KSV</b>	Klubi Sportiv Vllaznia
<b>BBSH</b>	Bashkimi i Bizneseve Shkodrane	<b>LRA</b>	Laboratori i Restaurimit dhe Arkiometrisë
<b>BH</b>	Bizneset e huaja	<b>MASh</b>	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
<b>BL</b>	Banorët pranë liqenit	<b>MBU</b>	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
<b>BR</b>	Bizneset e rajonit	<b>ME</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>BT</b>	Bizneset e turizmit	<b>MH</b>	Muzeu Historik Shkodër
<b>BZI</b>	Bizneset e Zonës Industriale	<b>MK</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
<b>D</b>	Donatorë	<b>MP</b>	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
<b>DhT</b>	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë	<b>MPV</b>	Ministria e Pushtetit Vendor
<b>DAR</b>	Drejtoria Arsimore Rajonale	<b>MTRr</b>	Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit
<b>DRPo</b>	Drejtoria Rajonale e Policisë	<b>MSh</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>DRPu</b>	Drejtoria Rajonale e Punësimit	<b>N</b>	Nxënësit
<b>DRSh</b>	Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë	<b>NP</b>	Ndërmarrja e Pastrimit të Qytetit
<b>EM</b>	Ekipi i mundjes	<b>OJF</b>	Organizatë Joqeveritare
<b>F</b>	Fermerët	<b>P</b>	Punëtorët
<b>FASh</b>	Filial i Albtelekomit Shqiptar, Shkodër	<b>PNUD</b>	Programme des Nations Unies pour le Développement
<b>FQ</b>	Fëmijët e qytetit	<b>QA</b>	Qeveria Austriake
<b>FShF</b>	Federata Shqiptare e Futbollit	<b>QEZh</b>	Qendra Ekonomike për Zhvillim
<b>GiA</b>	Grupet Artistike	<b>QK</b>	Qyteti i Koplikut
<b>GA</b>	Grupi i Arkeologëve	<b>QM</b>	Qeveria e Mali të Zi
<b>GE</b>	Grupi i Etnografëve	<b>QN</b>	Qytetet Ndërkufitare
<b>GH</b>	Grupi i Historianëve	<b>QQ</b>	Qeveria Qendrore
<b>GIA</b>	Grupi i Artistëve	<b>R</b>	Restorantet dhe Bare
<b>GTZ</b>	Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit	<b>RSh</b>	Rajoni i Shkodrës
<b>H</b>	Hotelet	<b>S</b>	Studentët
<b>I</b>	Interpretuese	<b>SA</b>	Sportistët Amatorë
<b>IA</b>	Institucionet Artistike	<b>ShMP</b>	Shkollat e Mesme Profesionale
<b>IK</b>	Instituti i Kulturës		
<b>IKA</b>	Instituti i Kërkimeve Arkeologjike		
<b>IP</b>	Industria Përpunuese		
<b>IPu</b>	Institute Publike		
<b>K</b>	Komuniteti		



<b>ShPJ</b>	Shoqata “Preng Jakova”	<b>TR</b>	Të rinjtë e qytetit
<b>T</b>	Turistët dhe vizitoret	<b>TFP</b>	Tregtarët me shumicë të fruta- perimeve
<b>TEU</b>	Teuleda, Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Vendor	<b>U</b>	Universiteti i Shkodrës
<b>TP</b>	Të papunët	<b>UNOPS</b>	United Nations Office for Project Services

## **Aneksi 2: Raporti mbi “Anketimin e mjedisit vendor në të cilin kryhet biznesi”**

### **Hyrje**

Anketimi i Biznesit për të cilin bën fjalë ky raport u krye në periudhën Mars–Prill 2004. Qëllimi i anketimit ishte që të ofronte një burim informacioni për procesin e planifikimit të zhvillimit ekonomik vendor në Bashkinë e Shkodrës. Në të njëjtën kohë, mënyra me të cilën u krye studimi do të përbente një eksperiencë më tepër për Bashkinë dhe veçanërisht për zyrën e zhvillimit.

Raporti paraqet një përmbledhje konçize të gjetjeve kryesore të dala nga studimi. Bashkë me këtë raport është përpiluar dhe një raport më i gjerë, në të cilin krahasohet performanca e të pesta bashkive subjekt i programit DELTA. Po ashtu dhe të dhënat e mbledhura nga studimi janë vënë në dispozicion të bashkive në një dokument elektronik. Kjo krijon mundësi për të bërë analiza të tjera më të detajuara sipas nevojës përkatëse.

Ky anketim, i cili u analizua nga Z. Gent Dakoli, u krye në bashkëpunim me zyrën e zhvillimit ekonomik pranë Bashkisë së Shkodrës ku një ndihmesë të veçantë dha shefi i kësaj zyre Z. Ridvan Sokoli, me asistencën e Z. Fatlum Nurja dhe Z. Artan Rroji.

### **Përshkrimi statistikor i grupit të bizneseve të intervistuar**

- U intervistuan 79 biznese, të cilët përbëjnë rreth 3.3 për qind të bizneseve të regjistruara në bashki (2,397 biznese të regjistruara, sipas listës që ofroi bashkia).
- Personat e intervistuar kishin pozicionet që vijon: pronarët në 73 biznese; drejtorët të përgjithshëm në 2 biznese; menaxherë të rëndësishëm në 4 biznese.
- 14 nga bizneset e intervistuar kishin një pronar; 65 kishin më shumë se një pronar.
- 13 nga bizneset e intervistuar ushtronin aktivitet prodhues; 36 aktivitet tregëtar; 23 në fushën e shërbimeve dhe 7 në fushën e ndërtimit.
- Hapësira kohore gjatë së cilës bizneset kishin ushtruar aktivitet varion nga 2 deri në 12 vjet. Shumica dërmuese e bizneseve të intervistuar kanë ushtruar aktivitetin nga 6 deri në 10 vjet.
- 57 nga bizneset kishin më pak se 5 të punësuar; 6 kishin 6 deri 10 të punësuar; 13 kishin 11 deri në 50 të punësuar; 3 kishin më shumë se 50 të punësuar.



## Përfundimet kryesore

### *Opinionet mbi klimën e biznesit në Shkodër*

- 52% e bizneseve deklarojnë se është e vështirë për të gjetur fuqi punëtore të kualifikuar; ndërsa 42% deklarojnë të kundërtën. (Pyetja 9.)
- 24% e bizneseve deklarojnë se kanë mangësi në fushën e marketimit dhe shitjeve; 22% kanë mangësi në fushën e aftësive teknike dhe 17% kanë mangësi në fushën e menaxhimit. (Pyetja 10.)
- 71% e bizneseve deklarojnë se konkurrenca kryesore iu vjen nga bizneset vendore. (Pyetja 11.)
- Në bashki një numër shoqatash biznesi, por ato nuk kanë njohje të madhe në komunitetin e biznesit. (Pyetja 13.) 68% e bizneseve deklarojnë se nuk dinë për mbështetjen që këto shoqata i japin biznesit. (Pyetja 22.)
- Tre faktorët kryesorë që e pengojnë biznesin të zgjerohet janë: energjia elektrike 64.4%; konkurrenca informale 39.7%; dhe infrastruktura. Por ka dhe faktorë të tjerë që janë përmendur shpesh nga bizneset. (Pyetja 15.)
- 50% e bizneseve deklarojnë se iu nevojiten më pak se 10 ditë për të rinovuar licencat për vitin pasardhës. (Pyetja 16.)
- Dy problemet më të mëdha që lidhen me marrëdhëniet e biznesit me qeverisjen vendor janë: konkurrenca nga sektori informal dhe korrupsioni si dhe praktikat ilegale. (Pyetja 17.)
- Mbi 70% e bizneseve deklarojnë se janë inspektuar më pak se 5 herë nga autoriteti i tatim taksave. 10% deklarojnë se i janë vënë gjoba dhe 4% kanë paguar ryshfet për autoritetin e tatim taksave. (Pyetja 20.)
- 11,4% e bizneseve deklarojnë se departamenti i tatim taksave e pengon zgjerimin e biznesit, ndërsa 1.3% deklarojnë të njëjtën gjë për departamentin e shërbimeve. (Pyetja 25.)
- 52% e bizneseve deklarojnë se ambienti në të cilin kryhet biznesi në Shkodër është keqësuar gjatë tre vjetëve të fundit. (Pyetja 33.)

### *Pritshmëritë e bizneseve*

- 33% e bizneseve deklarojnë se planifikojnë të zgjerohen brenda bashkisë. 44% nuk planifikojnë ta zgjerojnë aktivitetin e tyre. (Pyetja 8.)

- Tre pritshmëritë më të përmendura janë: të përmirësohet furnizimi me energji elektrike; të rregullohet infrastruktura dhe të pastrohet qyteti e të grumbullohen mbeturinat. (Pyetja 18.)
- Mbi 90% e bizneseve do të ishin të lumtur të rinovonin liçensat brenda 10 ditëve. (Pyetja 16.)

#### ***Njohuritë e biznesit lidhur me funksionet e bashkisë***

- 70% dhe 84% e bizneseve deklarojnë se nuk kanë dijeni për rolin e ZZhE Bashkisë dhe ZZhE Qarkut respektivisht. (Pyetja 22.)
- Në përgjithësi njohja për funksionet e bashkisë është e vogël. Përgjigjet “nuk e di” në Pyetjen 22 janë shumë të larta për të gjitha aspektet që trajtohen aty.
- Megjithëse 84% deklarojnë se nuk e njohin ZZhE Qarkut, kjo zyrë është përmendur 17 herë si departamenti që merret me zhvillimin ekonomik vendor. (Pyetja 26.)

#### **SWOT (ashtu siç del nga përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit)**

##### ***Pikat e forta***

- Pozita gjeografike. Kjo ka lidhje me të qënurit qytet pranë detit dhe liqenit, me toka të pasura bujqësore, me vende turistike etj.;
- Burimet natyrore dhe turistike;
- Tradita artizanale;
- Kosto e ulët e fuqisë punëtore.

##### ***Mundësitë***

- Një pjesë e mirë e pritshmërive të mëdha që ka komuniteti i biznesit mund të zgjidhen pjesërisht me rrugë politike;
- Ka aq shumë gjëra për të bërë sa që çdo gjë do të dukej një progres i konsiderueshëm.

##### ***Pikat e dobëta***

- Infrastruktura;



- Mungesa e energjisë elektrike;
- Mungesa e rendit dhe e ligjit;
- Kosto e lartë e financimit.

***Kërcënimet***

- Ekonomia informale. Ky është një nga faktorët që ndikojnë më shumë për keq në bizneset e regjistruara;
- Një numër i konsiderueshëm biznesesh nuk mendojnë ta zgjerojnë aktivitetin;
- Korrupsioni. Në pyetësor ky faktor është përmendur shumë herë si një pengesë e madhe;
- Niveli i ulët i bashkëpunimit që ofron biznesi. Kjo lidhet me imazhin e varfër për qeverisjen vendore.

### **Aneksi 3: Metodologjia e përdorur në prioritarizimin e projekteve**

Projektet e Strategjisë u prioritarizuan në bazë të dy kritereve të veçanta, por njëlloj të rëndësishme: nevoja e komunitetit dhe fizibiliteti i projektit. Çdo projekt u vlerësua me pike duke u bazuar në këto dy kritere.

Rezultati i nevojës së komunitetit u realizua nëpërmjet plotësimit të një formulari për renditjen e projekteve, nga grupi i punës dhe qytetare. Në formular, projektet ishin të grupuara sipas qëllimeve të strategjisë dhe sipas llojit të tyre, projekte të forta ose të buta. Pjesëmarrësve në vlerësimin e projekteve ju kërkua vlerësimi i secilit projekt përkundrejt projekteve të tjera brenda secilit grupim sipas ndarjes: shumë i nevojshëm, i nevojshëm dhe më pak i nevojshëm. Projektet e vlerësuara si më të nevojshme u vlerësuan me rezultatin 3, ato të nevojshme me 2, dhe ato më pak të nevojshme me rezultatin 1. Duhet vënë re fakti që disa projekte nuk u renditën nga të anketuarit dhe u vlerësuan me 0. Shuma e përgjithshme e krijoi Rezultatit përfundimtar të Nevojës për çdo projekt.

Rezultati i Fizibilitetit u përpunua nga një grup teknikësh të bashkisë. Grupi i vlerësoi projektet me pikë sipas 7 kritereve të mëposhtme:

1. Nëse projekti e kishte siguruar financimin ose jo;
2. Numri i burimeve të mundshme të identifikuar për financim;
3. Nëse Bashkia e kishte ekspertizën për të zbatuar projektin;
4. Nëse Bashkia kishte zbatuar më parë me sukses një projekt të ngjashëm;
5. Numri i rreziqeve të përfshira në zbatim;
6. Grupet e synuara prej projektit;
7. Numri i Qëllimeve/Objektivave të adresuara nga projekti.

Në krahasim me Rezultatit e Nevojës, në të cilin një numër më i madh përfaqësonte një nivel më të lartë pëlqimi, një rezultat më i ulët Fizibiliteti tregonte që projekti kishte një nivel më të lartë fizibiliteti. Çdo kriter është vlerësuar me rezultate të ndryshme pikësh (shih instruksionet më poshtë), dhe shuma e mbledhur plus 1, jep Rezultatit e përgjithshëm të Fizibilitetit për çdo projekt.

Lista përfundimtare e projekteve të prioritarizuara u hartua duke pjesëtuar Rezultatit e Nevojës me Rezultatit e Fizibilitetit dhe duke i renditur projektet. Lista është përpunuar më tej duke i ndarë projektet në tre kategori të veçanta: projekte aktive, projekte joaktive, dhe projekte pa vlerësim(pa pike).



Metodologjia e prioritarizimit e përdorur nga bashkia e Shkodrës është zhvilluar nga Nathan Borgford-Parnell, vullnetar i Peace Corps për zhvillimin e komunitetit vendor, në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Shkodrës si dhe nën kujdesin e vazhdueshëm të SOROS-it, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur dhe Bankës Botërore. Një falënderim special i jepet vullnetarit të Peace Corps, Jon Owen dhe Peter Gambil për kontributin e tyre në këtë proces.

## **Instruksione mbi metodologjinë e prioritarizimit të projekteve**

### **Koeficient i Nevojës**

**Hapi 1:** Grupimi i projekteve sipas qëllimeve;

**Hapi 2:** Kategorizimi i projekteve, brenda çdo grupi sipas qëllimeve, si të (F)orta apo të (B)uta;

**Hapi 3:** Listo të gjithë projektet në **Formularin e Nevojës** sipas numrit të grupit dhe kategorisë F apo B (duke renditur të parët projektet e Qëllimit 1 në fillim, të ndjekur nga projektet e Qëllimit 2, e kështu me radhë);

**Hapi 4:** Pajisja e çdo pjesëmarrësi me një Formular Nevojash të veçantë.

**Hapi 5:** Pjesëmarrësve u kërkohet të vlerësojnë projektet, brenda secilit grup, si më të nevojshëm, të nevojshëm ose pak të nevojshëm. Pjesëmarrësit në vlerësim mund të përzgjedhin vetëm *tre* projekte brenda çdo grupimi si më të dëshirueshmin/nevojshmin (për projektet F dhe B). Në rastin kur janë vetëm pak projekte brenda një grupimi, numri maksimal i lejuar për “më të dëshirueshmin/nevojshmin” mund të ulet në 2 ose 1.

**Hapi 6:** Mblidh pikët për çdo projekt nga secili Formular Nevoje për të përfutur **Koeficientin e Nevojës** dhe vendose atë në **Pasqyrën e Prioritarizimit të Projektit**.

### **Koeficient i Fizibilitetit**

**Hapi 1:** Renditja e projekteve sipas grupit në **Formularin e Fizibilitetit**.

**Hapi 2:** Diskutimi dhe vlerësimi i çdo projekti sipas kriterëve të përcaktuara në formular (vini re që kjo është e kundërta e radhitjes së formatit në Formularin e Palëve të interesuara).

**Kriteri 1:** Fondi i siguruar ? (Po 0, Jo 0.1);

**Kriteri 2:** Identifikimi i numrit të burimeve financiare të mundshme ( $\geq 2$ , 0; një, 0.1; zero, 0.2);

**Kriteri 3:** A e ka bashkia ekspertizën e duhur për të zbatuar projektin dhe a janë ekspertët të gatshëm? (po, 0; ndoshta, 0.1; jo, 0.2);



**Kriteri 4:** A ka zbatuar bashkia, në mënyre të suksesshme, një projekt të tillë më parë? (po, 0; jo, 0.2);

**Kriteri 5:** Numri i rreziqeve (0, 0; 1 ose 2, 0.1; >2, 0.2);

**Kriteri 6:** Grupet e popullatës të synuara nga projekti (gjithë popullata, 0; disa segmente të popullatës të përcaktuara në mënyre specifike, 0.1; një popullatë e veçantë joprioritare, 0.2);

**Kriteri 7:** Numri i Qëllimeve/Objektivave të adresuara prej projektit ( $\geq 3$ , 0;  $< 3$ , 0.1).

**Hapi 3:** Mblidh rezultatet në çdo rresht për të krijuar **Koeficientin e Fizibilitetit** për çdo projekt;

**Hapi 4:** Vendos Koeficientin të Fizibilitetit në Pasqyrën e Prioritarizimit të Projekteve.

### **Prioritarizimi i Projektit**

**Hapi 1:** Përcakto çdo projekt si i (F)ortë ose i (B)utë;

**Hapi 2:** Përcakto çdo projekt si afat (Gj)atë, (M)esëm ose (Sh)kurtër duke u bazuar në kohëzgjatjen e zbatimit. (Sh, <1 vit; M, 1–3 vite; Gj, >3 vite);

**Hapi 3:** Për çdo projekt, pjesëtohet **Koeficienti i Nevojës** me **Koeficientin e Fizibilitetit** për të përfituar **Rezultatit e Prioritetit**;

**Hapi 4:** Riorganizimi i projekteve sipas **Rezultatit të Prioritetit** nga më i larti tek më i ulti;

**Hapi 5:** Renditja e projekteve në radhën e re të prioritetit duke përfshirë shkurtimet e nevojshme të përcaktuara për kategorinë i fortë dhe i butë, si dhe kohës së zbatimit.



## Aneksi 4: Grup projektesh

### a. Projekti Nr. 63 (Q4:O2:PG1:p1: Rikonstruksioni i rrugëve të qytetit)

Nënprojekti	Vlera e përafërt (000 Lekë)
Rruga e “Tregut të Ri”	70,000
Rruga në hyrje të qytetit	235,486
Rruga nga “Ali Kelmendi” tek “Lek Dukagjini”	114,427
Rruga e unazës: Tophane deri tek Rus	309,071
Rruga “Skenderbeg”	204,476
Rruga nga “Ura Thive” deri tek Mbikalimi i Trenave	47,461
Udhëkryqi “Alqi Kondi”	11,353
Rruga “Guerile”	22,000
Rruga “Justin Godard”	9,286
Rruga “Bajram Curri”	3,753
Rruga “Halit Bajraktari”	33,300
Rruga e Liceut Artistik deri tek ish Fabrika e Mëndafshit	46,000
Rruga “Daut Borici”	2,300
Rruga nga “Ura Thive” tek Stacioni i Trenit	24,400
Rruga “Tahsim Berdica”	17,750
<b>Totali</b>	<b>1,151,063</b>

### b. Projekti Nr. 64 (Q4:O2:PG1:p2: Rikonstruksioni i trotuareve të qytetit)

Projekti
Rruga “Zogu i Parë”
Rruga “Vasil Shanto”
Rruga “Çlirimi”
Rruga “13 Dhjetori”
Rruga “Marin Barleti”
Rruga “Bujar Bishanaku”
Rruga “Alqi Kondi”
Rruga “Daut Borici”
Rruga “Oso Kuka”
Rruga “Daniel Matlia”
Rruga e Spitalit
Rruga “Muhamet Gjollesha”

**c. Projekti Nr. 65 (Q4:O2:PG1:p3: Rikonstruksioni i ndriçimit të rrugëve të qytetit)**

Projekti	Vlera e përafërt (000 Lekë)
Rruga “Zogu i Parë”	17,000
Rruga “Çlirimi”	14,520
Rruga “13 Dhjetori”	5,820
Rruga “Marin Barleti”	6,500
Rruga “Daniel Matlia”	3,000
Rruga Qendra Shëndetësore	2,000
Rruga “Osa Kuka”	2,000
Rruga përpara kampusit të universitetit	1,200
<b>Totali</b>	<b>52,040</b>

**d. Projekti Nr. 66 (Q4:O2:PG1:p4: Rikonstruksioni i kanalizimeve të ujit)**

Projekti
Dalje në Liqen i e Unazës deri Rr. Myfit Kopliku
Dalje në Liqen II, Rr. e Unazës deri Rr. Selim Golemi
Dalje në lumin Kir, Fusha e Druve, OUT 2
Dalje në lumin Kir, Tepe, OUT 3
Dalje në lumin Bunë, Ish Ferma, OUT 3
Dalje në liqen Zooteknikës,(shtëpia e bujqve), OUT 8



